



# **RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**“Mbi auditim financiar dhe  
përputhshmërisë” në subjektin  
Bashkia Pustec**

**Tiranë, 2023**

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
<b>I</b>	<b>PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE</b>	<b>4 - 15</b>
<b>1.</b>	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	<b>4 - 5</b>
<b>2.</b>	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeve.....	<b>5 - 12</b>
<b>3.</b>	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni I Auditimit.....	<b>12 - 15</b>
<b>II</b>	<b>HYRJA</b>	<b>15 - 20</b>
	a. Objektivat e auditimit.....	
	b. Qëllimi i auditimit.....	
	c. Identifikim i çështjes.....	
	d. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	
	e. Përgjegjësitë e Audituesve.....	
	f. Kriteret e vlerësimit .....	
	g. Standardet e auditimit.....	
	h. Metodatat e auditimi .....	
	i. Dokumenti i auditimit.....	
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.</b>	<b>20 - 104</b>
<b>1.</b>	<b>Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.</b>	<b>20 - 22</b>
<b>2.</b>	<b>Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.</b>	<b>22 - 87</b>
2.1	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm	22 - 27
2.1.2	Mbi funksionimin e Auditit të Brendshëm	27 - 28
2.2.	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", ligjet ojetore "Për buxhetin e shtetit" , si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.....	28 - 32
2.2.6	Mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi i tyre.	32 - 34
2.3	Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2019-2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe udhëzimi MFE nr.08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare ojetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme".....	34 - 49
2.4	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik,.....	49-65
2.4.4	Mbi zbatimin e kontratave të punëve publike	65-77
2.5	Zbatimi i rekomandimeve	77-87
<b>IV.</b>	<b>GJETJE DHE REKOMANDIME.</b>	<b>88-104</b>

## **SHKURTIME**

<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>NA</b>	Nëpunës Autorizues
<b>NZ</b>	Nëpunës Zbatues
<b>FZHR</b>	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
<b>AQT</b>	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
<b>UMF</b>	Udhëzim i Ministrisë së Financave
<b>Vendim i KM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>Vendim i KB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak
<b>ISSAI</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>INOTSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>ISA</b>	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
<b>IFAC</b>	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
<b>IPSAS</b>	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
<b>IT</b>	Teknologjia e Informacionit
<b>NJA</b>	Njësi Administrative
<b>SHA</b>	Shoqëri Anonimë
<b>Bashkim i OE</b>	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
<b>OE</b>	Operatori Ekonomik

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

### I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e vijim KLSH*), në periudhën nga data 5.10.2022 deri në datë 25.11.2022, realizoi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të veprimtarisë ekonomike dhe financiare të subjektit Bashkisë Pustec, të periudhës nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021, duke u përqendruar kryesisht në organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese, planifikimin, hartimin dhe realizimin e buxhetit; realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat e tarifave vendore; auditimin me zgjedhje i transaksioneve financiare, hartimin e pasqyrave financiare viti 2021, si dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike dhe menaxhimit të të ardhurave, etj.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti (me zgjedhje), për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë periudhës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit financiar dhe i përputhshmërisë në KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase, si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi janë të karakterit organizativ, shpërblim të dëmit, mungesë së të ardhurave dhe të përdorimit jo me efektivitet të fondeve publike (3-E), i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të Audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të Bashkisë Pustec për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datë 31.12.2021, grupi i auditimit konkludon në një opinion të **kundërt** për aspektin financiar (pasqyrat financiare viti 2021), ndërsa për aspektin e përputhshmërisë për të ardhurat dhe shpenzimet ka dalë me opinion të **kualifikuar**.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 5 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

## I.1. Përshkrim i shkurtër i Raport Auditimit

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
1.	Nga auditimi u konstatua se Sektori i Financës, Bashkia Pustec deri më datë 31.12.2021, nuk ka likuiduar detyrime për fatura të mbërritura dhe vendime gjykate, që ju ka kaluar afati 60 ditorë për likuidim në 15 raste në vlerën gjithsej 2,339,662 lekë, detyrime që i përkasin llogarive (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe (467) “Kreditorë të ndryshëm”. Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253,354, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 40, 48 dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat Standard të zbatimit të buxhetit" neni 101, sipas të dhënave të Aneksit nr. 8, bashkëlidhur Raport Auditimit.	E lartë	Trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit	Sektori i Financës, për gjendjen e faturave të pa likuiduara, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave për vlerën 2,339,662 lekë, sipas nivelit të realizimit të të ardhurave.
2.	Nga auditimi ka rezultuar se për vitin 2021, shpenzimet buxhetore sipas aktrakordimit me thesarin të planifikuara në vlerën 218,317 mijë lekë janë realizuar në vlerën 188,096 mijë lekë ose në masën 86 %, u konstatua se ka diferenca të dukshme midis planit dhe realizimit të shpenzimeve korrente të cilat nga 25,801 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në fakt në vlerën 12,298 mijë lekë ose 48 %, me mosrealizim në vlerën 13,503 mijë lekë, kryesisht në mos kryerjen e shpenzimeve për disa shërbime të planifikuara. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë, sipas zërave Aneksin nr. 7, bashkëlidhur Raport Auditimit.	I lartë	Trajtuar Në Pikën 2.2, faqe 28-32 Të Raportit Përfundimtar Të Auditimit	Bashkia Pustec të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit.
3.	Nga auditimi rezultoi se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 129,768 lekë. Nga verifikimi i kryer rezultoi që në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk janë përfshirë debitorët për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën gjithsej në vlerën 17,853,280 lekë (për 11	I lartë	Trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar	Sektori i Financës, të marrë masa për kontabilizimin në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, të debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën 17,853,280 lekë.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>subjekte në vlerën 261,452 lekë dhe 1336 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 17,591,828 lekë), në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.</p>		tar të Auditimit	
4.	<p>Në pasqyrat financiare të vitit 2021, konstatohet se llogaria 202 “Studime dhe projekte”, është mbajtur në bilanc si llogari më vete e analizuar për 22 projekte në vlerën 18,399,892 lekë, pavarësisht faktit që 20 prej këtyre projekteve në vlerën 2,865,892 lekë i përkasin investimeve për objekte të përfunduara. Vlera e këtyre projekteve, duhej të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit që i përket, kjo ka sjellë paraqitjen e Aktiveve Afatgjata Materiale më pak për vlerën 2,865,892 lekë për vitin 2021, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Aneksi 1 Pika 2.</p>	I lartë	<p>Trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundim tar të Auditimit</p>	<p>Sektori i Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë kreditimin e saj në debi të Aktiveve Afatgjata Materiale si pjesë e kostos së tyre, në vlerën 2,865,892 lekë.</p>
5.	<p>Nga auditimi u konstatua se për llogarinë 212 “Ndërtesa konstruksione” e analizuar në kontabilitet për 45 objekte (aktive) në vlerën 50,552,353 lekë, nga verifikimi i analitikëve të kësaj llogarie rezulton se për 25 raste, shesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të aktivitetit por janë trajtuar si aktive më vete. Trajtimi i tyre si aktive më vete ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30, sipas Aneksit nr. 12, bashkëlidhur Raport Auditimit.</p>	I lartë	<p>Trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundim tar të Auditimit</p>	<p>Sektori i Financës, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksione”, të vlerave të këtyre objekteve duke shtuar shpenzime për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre.</p>
6.	<p>Nga auditimi u konstatua se për llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” e analizuar në kontabilitet për 44 objekte (aktive) në vlerën 231,600,561 lekë, nga verifikimi i analitikëve të</p>	I lartë	<p>Trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të</p>	<p>Sektori i Financës, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, të vlerave të këtyre objekteve duke shtuar shpenzime</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>kësaj llogarie rezulton se për 30 raste, shtesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të aktivitetit por janë trajtuar si aktive më vete. Trajtimi i tyre si aktive më vete ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30, sipas Aneksit nr. 12, bashkëlidhur Raport Auditimit.</p>		<p><i>Raportit Përfundimtar të Auditimit</i></p>	<p>për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre.</p>
7.	<p>Nga auditimi u konstatua se gjendja kontabël (kosto historike) për vitin 2021 e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” është e analizuar për 17 objekte inventari në vlerën 8,715,343 lekë. Nga verifikimi i analitikëve të kësaj llogarie rezulton se nuk është zbritur vlera e investimeve të kryera në ujësjellës që duhej të transferohej tek Ujësjellës Kanalizime SHA Pustec, për objektin në vlerën 1,750,944 lekë (<i>objekti “Furnizim, vendosje sahat uji” në vlerën 1,709,906 lekë dhe “Mbikëqyrje punimesh për vendosje sahat uji” në vlerën 41,038 lekë</i>), me ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.</p>	I lartë	<p><i>Trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</i></p>	<p>Sektori i Financë të kryej transferimin e aseteve që i përkasin Ujësjellës Kanalizime SHA Pustec me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët dhe të kryhen veprimet kontabël duke zbritur nga llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” vlerën për investimet e kryera në shumën 1,750,944 lekë.</p>
8.	<p>Nga auditimi rezulton se gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,980,524 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar të cilat janë raportuar për vlerën 6,124,305 lekë dhe nuk kuadron me këto llogari për vlerën 1,143,781 lekë, veprim në kundërshtim me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për</p>	I lartë	<p><i>Trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</i></p>	<p>Sektori i Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarive të Klasës së 4 të Pasivit të bilancit për diferencën në vlerën 1,143,781 lekë.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32.			
9.	Nga auditimi ka rezultuar se, nga 90 objekte inventari të analizuar në kontabilitet të pasurive të paluajtshme me kosto historike që i përkasin llogarisë 211 “Pyje plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në vlerën 283,946,750 lekë, Bashkia Pustec nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35.	I lartë	<i>Trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</i>	Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Drejtoria Korçë dhe nëpërmjet Sektorit të Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.
10.	Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2021, rezulton se llogaria 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se, për vitin 2021 ka kontratë që nuk ka përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilën është kryer pagesë, për vlerën 108,199,198 lekë, që i përket llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” për kontratën me objekt “Furnizim me ujë Bashkia Pustec” me vlerë 547,692,661 lekë me afat shlyerje deri në vitin 2024. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0, kur ka investime në proces, pra vlera e kësaj llogarie duhej pasqyruar në vlerën 108,199,198 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Klasa 23.	I lartë	<i>Trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</i>	Sektori i Financës në Bashkinë Pustec, në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.
11.	Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2021, rezulton se llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 6,328,772 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesari, kjo llogari për vitin 2021 është kredituar për 1 objekt për vlerën 5,409,960 lekë dhe është debituar në 1 rast për vlerën 1,124,245 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde për vlerën	I lartë	<i>Trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</i>	Sektori i Financës në Bashkinë Pustec, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e më parë (vlera 918,857 lekë), për të cilat ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Korçë, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes public.



Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>918,857 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e para, të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Pustec nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për ç'bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për interes publik, veprime në kundërshtim me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.</p>			
12.	<p>Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës me objekt “Furnizimi me ujë Bashkia Pustec”, konstatohet se lidhja dhe zbatimi i kontratës është bërë pa marrë miratim nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, pasi zona e Bashkisë Pustec në të cilën do shtrihet investimi hyn në zonat e mbrojtura si PK “Prespë”, shpallur me VKM nr. 80, datë 18.2.199, kategori e II e zonave të mbrojtura, sipas IUCN-së, si dhe pa miratim të lejes së ndërtimit të lëshuar nga Sektori i Planifikim Territorit dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Pustec, duke u mjaftuar vetëm me lejen e zhvillimit nr. 5, datë 26.5.2021.</p> <p>Veprimet e mësipërm janë në kundërshtim me nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe neneve 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, ligjin nr. 81/2017, datë 4.5.2017 “Për zonat e mbrojtura” i ndryshuar, ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar (shtojca I dhe II), ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” i ndryshuar.</p>	I lartë	<p><i>Trajtuar në pikën 2.4, faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</i></p>	<p>Kryetari i Bashkisë Pustec të mos lidhë kontrata me subjektet sipërmarrëse dhe fituese të procedurave të prokurimit për investime pa marrë më parë lejen e ndërtimit të infrastrukturës nga Sektori i Planifikim Zhvillim Territorit, si dhe pa u pajisur me Nipt sekondarë.</p> <p>Gjithashtu duke qenë se Bashkia Pustec bën pjesë në zonat e mbrojtura, përpara hapjes së ndonjë procedure prokurimi në investime e cilat prekin zonat e mbrojtura të merret paraprakisht miratimi nga instancat përkatëse për zhvillimin ose jo të zonës ku do shtrihet projekti.</p>
13.	<p>Në auditimin e procedurës me objekt “Furnizimi me ujë i Bashkisë Pustec”, rezulton se disa nga kriteret nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës. Aplikimi i kriterëve jo në përputhje me tipologjinë e procedurës kanë çuar në uljen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë (gjithsej 2 OE), duke ulur konkurrencën dhe krijimin e kushteve për një përdorim jo me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, duke përfutur kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.</p> <p>Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me <b>nenin 46</b>, të LPP, “kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe</p>	I lartë	<p><i>Trajtuar në pikën 2.4, faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</i></p>	<p>Bashkia Pustec (<i>grupi i punës apo komisioni përkatës</i>), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të parashikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.</p> <p>Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitetit, bazuar në kriteret</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”, si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 5 përcaktohet: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.</p>			<p>të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.</p>
14.	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Pustec, mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi e mëparshme paraqitur me shkresën nr. 870/9,prot, datë 23.12.2021, <i>rezulton se:</i>  Bashkia Pustec për zbatimin e rekomandimeve të <b>KLSH nuk ka</b> kthyer përgjigje, <b>brenda afatit 20 ditore</b>, si dhe nuk ka raportuar në KLSH <b>brenda 6 muajve</b> për masat e marra në zbatimin e rekomandimeve.  Bashkia Pustec ka hartuar “<i>Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve</i>” me shkresën nr. 90, datë 18.01.2022, në të cilën janë përcaktuar strukturat dhe personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete, <b>por nuk ka raportuar në këshillin e njësisë bashkiake.</b>  Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:  <b>a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 10 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat është zbatuar 1 (një) masë, në proces zbatimi 2 masa dhe pa zbatuar akoma 7 masa.</b>  <b>b. Për masa shpërblim dëmi, është rekomanduar 1 (një) masë me vlerë 300,000 lekë, e cila është pranuar dhe zbatuar.</b>  <b>c. Për masa mungesë të ardhurash është rekomanduar 1 (një) masë me vlerë 15,039 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi, ku nga vlera e rekomanduar prej 15,039 mijë lekë është arkëtuar vlera 1,414 mijë lekë, duke mbetur për arkëtim vlera 13,625 mijë lekë.</b>  <b>d. Për masa disiplinore, janë rekomanduar gjithsej 7 masa të cilat janë pranuar dhe zbatuar nga subjekti.</b>  Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 15 dhe 30 të Ligji nr. 154/2021, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni</p>	I mesëm	<p>Trajtuar në pikën 2.5, faqe 77-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</p>	<p>Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa për përsheptimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve në proces zbatimi, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 870/9,prot, datë 23.12.2021 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Pustec”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	15, "Të drejtat e KLSH", si dhe neni 50-Auditimi i jashtëm, të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".			
15.	<b>Gjetje nga auditimi:</b> Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt " <u><b>Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec</b></u> ", fituar nga B. G.SH., rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 847,620 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, pika I.17, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", pika 8.2 dhe 8.3, si dhe kushtet e kontratës së sipërmartjes së punimeve nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pustec dhe B. G. & SH.	I lartë	<i>Trajtuar në pikën 2.4.5, faqe 65-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</i>	Nga Bashkia Pustec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>847,620 lekë pa tvsh</b> nga BOE G.SH., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021, me objekt "Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
16	Nga verifikimi i dokumentacionit të objektit "Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec", Bashkia Pustec, rezultoi se zëri i punimeve "Mbushje me zhavorr në rrugë" me vlerë të situacionuar 5,602,560 lekë, është librezuar si volum i kryer si shtresë për mbushjen e kanaleve pas shtrimit të tubacioneve, me sipërfaqe mesatare të shtresës 0.36-0.42 m <sup>2</sup> . Në fakt, nga verifikimi me zgjedhje në terren, ky zë pune nuk është realizuar në mbushjen e kanaleve, pasi mbushja e kanalit është bërë me materialin e gërmuar. Në dosjen teknike nuk administrohet librezja e punimeve që të vërtetojë punimin e kryer sipas faktit.	I lartë	<i>Trajtuar në pikën 2.4.5, faqe 65-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</i>	Bashkia Pustec të ngrëjë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të vlerësojnë e të analizojnë zërin e punimeve "Mbushje me zhavorr në rrugë", i cili nuk është i situacionuar sipas librezës së masave në vlerën <b>5,602,560 lekë</b> nga sipërmarrësi i punimeve, për të përcaktuar volumet sipas punimeve të kryera në fakt, duke bërë rakordimin në situacionin përfundimtar dhe në rast difference në volume, të merren masa për arkëtimin e kësaj vlere nga BOE G.SH., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021, me objekt "Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec".
17.	Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pustec, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë 11 subjekte në vlerën 261,452 lekë dhe 1336 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 17,591,828 lekë edhe pse vazhdojnë procedurat mbledhjes me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 11 subjekte debitorë në vlerën 261,452 lekë, janë aktiv 2 subjekte ose 18 % e totalit të cilët nuk paguajnë detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore. -Nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimin të debitorëve, në kundërshtim me Kreun XI "Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në	I lartë	<i>Trajtuar në pikën 2.2.4, faqe 32-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</i>	Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Pustec, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të periudhës në vlerën <b>17,853,280 lekë</b> .

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.			
18.	<p>Në procedurën me objekt “Furnizimi me ujë i Bashkisë Pustec” me fond limit 456,525,537 lekë dhe ku fitues është shpallur bashkimi i OE G. &amp; SH. shpk me vlerë oferte 456,410,511 lekë ose 0.025% e fondit limit, rezulton se:</p> <p>Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, bashkimi OE G. &amp; SH., i shpallur fitues nga KVO nuk plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK.</p> <p>Përfundimisht në kushtet kur në garë nuk ka OE të tjerë, KVO duhet t’i propozonte titullarit të AK anulimin e procedurës, analizimin e shkaqeve dhe marrjen në analizë për ndryshimin e kushteve të procedurës (kriteret) me qëllim rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë, duke rritur konkurrencën për një përdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondit të prokuruar prej 456,525 mijë lekë.</p> <p>Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 28, “Anulimi i një procedure”, neni 76, “S’kualifikimi i ofertuesve”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, neni 97, “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”, pika 1, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 5, Neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 69, “Njoftimi i fituesit”.</p>	I lartë	Trajtuar në pikën 2.4, faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit	<p>Kryetari i Bashkisë Pustec në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertës ekonomike e cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondit të prokuruar.</p> <p>Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.</p>

## I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare (balance) të vitit 2021, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një **“Opinion të kundërt”**, pasi ka llogari të Aktiveve të krijuara në viteve paraardhëse për të cilat, mungon dokumentacioni i nevojshme kontabël e ligjor mbi krijimin dhe përmbajtjen ekonomike të tyre, ndërkohë që konstatohet se nga bashkia nuk është bërë inventarizim fizik i Aktiveve të Qëndrueshme për të saktësuar vlerat në pasqyrë.

- Në auditimin e përputhshmërisë në fushën e shpenzimeve operative (602), investimeve (231), të fondit të pagave (601) dhe menaxhimit e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregullore, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkia Pustec bazuar në analizën e riskut, janë konstatuar disa anomali materiale por jo të përhapura, që janë baza për dhënien e një **“Opinion të kualifikuar”**, pasi kriteret nuk janë vendosur në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe se O./B. të shpallur fitues nuk plotësojnë të gjitha kriteret e DST miratuara nga AK, në mos zbatimin e plotë

të procedurave ligjore në arkëtimin e debitorëve me vlerë 17,853 mijë lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë Pustec, si dhe mos zbatimi i punimeve të kontratave për investimeve/ dhe shërbime, si dhe duke evidentuar një vlerë prej 6,450 mijë lekë, me dëm ekonomik në Bashkinë Pustec.

## **- OPINIONI I AUDITIMIT**

### **. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA<sup>-të</sup>). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Pustec, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700).

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Pustec për vitin e ushtrimor 01.01.2021 - 31.12.2021, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 është 3,762 mijë lekë.

*“Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Pustec, duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2021”, të shprehura në bazën për opinion (trajtuar më poshtë).*

### **Baza për opinion e kundërt .**

Opinionin e dhënë e mbështesim në vlerën e materialitetit prej 3,762 mijë lekë, si dhe në faktin se pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705), konkretisht:

*-Ka llogari të aktiveve të krijuara gjatë viteve paraardhëse për të cilat mungon dokumentacioni i nevojshme kontabël e ligjor mbi krijimin dhe përmbajtjen ekonomike të tyre, ndërkohë që mungon materiali për kryerjen e inventarizimit fizik i Aktiveve të Qëndrueshme për të saktësuar vlerat në pasqyrë.*

*-Nga testimi i llogarive, konstatohet se sipas inventarit kontabël përfshihen vlera të pa analizuar për të cilat mungon inventari fizik e regjistri i aktiveve, si: në llogarinë 212 “Ndërtesa Konstrukione” me vlerë 50,552,353 lekë dhe llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, me vlerë 231,400,561 lekë.*

*-Ka rezultuar se llogaria 202 “Studime dhe projekte”, është mbajtur në bilanc si llogari më vete e analizuar për 22 projekte në vlerën 18,399,892 lekë, pavarësisht*

faktit që 20 prej këtyre projekteve në vlerën 2,865,892 lekë i përkasin investimeve për objekte të përfunduara.

- Për kontratat e investimeve me shtrirje kohore më të gjatë se 1 vit, rezulton se llogaria 230-231 "Shpenzime për investime në proces" është mbyllur në mënyrë të gabuar (gjendje 0) në debi të llogarive të klasës 20-21, sipas llojit të aktivitetit për vlera pjesore të paguara, pa u kapitalizuar aktivitetet deri në vlerë të plotë. Kështu për 1 kontratë të lidhur, janë paguar pjesërisht deri me datë 31.12.2021 vlera prej 108,199,198 lekë, vlerë e cila në fakt i përket gjendjes debitorë të llogarisë 231 "Shpenzime për Aktive Afatgjata Materiale (investime në proces)".

-Në llogarinë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje", vlera prej 918,857 lekë, janë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2020, të cilave u ka kaluar afati i garancisë, por që nuk është ndërmarrë asnjë veprim për sistemimin e kësaj llogarie.

-Ka rezultuar se për aktivitetet që i përkasin llogarisë 211 "Pyje plantacione", 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", për kosto historike në vlerën 283,946,750 lekë, Bashkia nuk posedon titull pronësie.

-Ka rezultuar se në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm", nuk janë përfshirë debitorët për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën gjithsej në vlerën 17,853,280 lekë.

-Ka rezultuar se në llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" është përfshirë vlera prej 1,750,944 lekë që duhej të transferohej tek Ujësjellës Kanalizime ShA Pustec.

## **II. Opinioni mbi përputhshmërinë.**

Auditimi u krye në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), të cilat janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin përkatës të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Pustec, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe kodeve të vendosura apo termave, mbi të cilat është rënë dakord, bazuar në analizën e riskut<sup>1</sup> dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Pustec, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

"Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Pustec, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një "**Opinionit të kualifikuar**" të përputhshmërisë.

### **Baza për opinion të kualifikuar:**

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se:

- Në 1 (një) procedurë prokurimi nga 3 procedura të zhvilluara dhe audituara nuk ka vepruar në përputhje me aktet ligjore/ nënligjore në fuqi, veprime të cilat kanë sjellë anomali materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e opinionit të kualifikuar, pasi kriteret nuk janë vendosur në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe se O./B. të shpallur fitues nuk plotësojnë të gjitha kriteret e DST miratuara nga AK, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.

<sup>1</sup>Sipas ISSAI 1315 (ISA 315), objektivi i audituesit është të verifikojë dhe vlerësojë risqet e mospërputhshmërisë me ligjet dhe rregullat në fuqi, duke siguruar kështu bazën për hartimin dhe zbatimin e procedurave të auditimit.

- Në mos zbatimin e plotë të procedurave ligjore në arkëtimin e debitorëve me vlerë **17,853 mijë lekë**.

-Në procedurën e zbatimit të kontratave ku janë konstatuar diferenca në kryerjen e punimeve të ndërtimit me dëm ekonomik në vlerën **6,450 mijë lekë**.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Pustec:**

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Pustec, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me dhënien e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 884//1, datë 03.10.2022, i ndryshuar me nr. 884/2, datë 31.10.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 05.10.2022 deri në datë 25.11.2022, në subjektin Bashkia Pustec, për periudhën nga 01.01.2021 deri në 31.12.2021, u krye auditimi “Mbi Auditimin financiar dhe përputhshmërisë” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. P. Gj., *Përgjegjës Grupi*
2. K. Gj., *anëtarë*
3. S. D., *anëtarë*
4. A. Z., *anëtarë*

#### **a- Objektivat dhe qëllimi i auditimit:**

Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2021, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

- **Objektivat e auditimit** synojnë:

Për auditimin **financiar**, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Për auditimin e **përputhshmërisë**, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e Audituesve:

*-Nëse pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me rregullat dhe ligjet e kontabilitetit;*

*-Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;*

*-Nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;*

*-Verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare;*

*- Auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.*

**b- Procedura e ndjekur:** Raport Auditimi i dërgohet subjektit Bashkia Pustec, pasi nga subjekti i audituar me shkresën nr. 10, datë 4.01.2023 (*prot KLSH nr. 884/8, datë 6.01.2023*), janë paraqitur kundërshtitë mbi Projekt Raportin e Auditimit dërguar në subjekt me shkresën nr. 884/6, datë 13.12.2022. Mbas shqyrtimit me objektivitet dhe profesionalizim të kundërshtive të subjekti, janë marrë në konsideratë ato çështje të cilat kishin argument dhe të mbështetura me dokumentacion justifikues. Ndërsa për çështjet e tjera për të cilat argumentet nuk justifikojnë gjetjet e konstatuara nga grupi i KLSH, gjejnë pasqyrim në këtë Raport Auditim, i cili i përcillet subjekti për zbatim dhe përmisimin e gjendjes në të ardhmen, referuar kjo dhe rekomandimeve të KLSH të reflektuara në fund të raportit.

**c- Identifikimi i çështjes:** Ky Raport Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Pustec, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre. Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

**d- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim (në vartësi të llojit të auditimit).**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Pustec janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare



dhe në të njëjtën kohë janë përgjegjës për aktivitetin financiar të Bashkisë në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për planifikimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e territorit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditim e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

**e- Përgjegjësitë e Audituesve.** Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Pustec dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për prokurimin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

#### **f- Kriteret e vlerësimit.**

- ✓ Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit;
- ✓ Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- ✓ Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
- ✓ Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së ndryshuar me nr. 63, datë 22.6.2020;
- ✓ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- ✓ Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi “Auditimin e përputhshmërisë”, Manuali i Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë, të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit;
- ✓ Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”;
- ✓ Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe aktet normative që e ndryshojnë këto ligje;
- ✓ Udhëzimin i MF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 26, datë 27.12.2007, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006”;
- ✓ Udhëzimi i MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.
- ✓ Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017 Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”; etj. dhe kuadri rregullues i brendshëm i bashkisë.

#### **g- Standardet e auditimit:**

Auditimi është kryer sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga INTOSAI.

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik” që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

- ISSAI 400 “*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*“ që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.

**h- Dokumentimi i rezultateve të auditimit:** Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

**I- Praktikrat e ndjekura në kryerjen e auditimit.** Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me **ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450**, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga (600), shpenzimet operative (602) dhe shpenzimet për investime (231).

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticismit

profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon<sup>2</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektive* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektive fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/ procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

### **k- Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:**

#### 1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

#### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

#### 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

#### 4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

#### 5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

#### 6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e

<sup>2</sup> Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit

brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

8. Raporte dhe Informacione

9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.

- **Metoda e Auditimit:** Auditim mbi bazë risku.

### **III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT**

#### **1. Informacioni i Përgjithshëm:**

Auditimi në Bashkinë Pustec u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan disa të meta në mbylljen e pasqyrave financiare si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me shpenzime jo sipas 3-E në fushën e prokurimeve dhe menaxhimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e konkluzioneve. Dokumentacioni i marrë për auditimin është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Pustec është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregulloren e funksionimit të Bashkisë dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Pustec.

Bashkia e re e Pustecit ka si aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe blegtorinë, si dhe tregtinë ndërkufitare me Greqinë, Maqedoninë etj.

Bujqësia është e përqendruar të agrumet, dhe vreshtat ndërsa zona është e famshme edhe për kullota dimërore për bagëtinë e imët.

Bashkia Pustec ka një popullsi rreth 5,200 banorë. Si rezultat i reformës administrative-territoriale nuk ka përfshirë njësi të tjera administrative, pra është vazhdim i ish Komunës Pustec. Veprimtaria e njësisë vendore bazohet në një bazë të gjerë ligjore, por ligji bazë për të është ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” . Bashkia Pustec si njësi vendore kryen funksione të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit.



- **Parimet e auditimit financiar:**

Në punën tonë jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

- Etika dhe pavarësia
- Kontrolli i cilësisë
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

- **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:**

*Përkatësia:* Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

*Plotësia:* Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

*Saktësia:* Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

*Periudha:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

*Klasifikimi:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

*Ligjshmëria dhe rregullsia:* Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

- **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

*Ekzistenca:* asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

*Të drejtat dhe detyrimet:* Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

*Plotësia:* Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

*Vlerësimi dhe alokimi:* Aktivitet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

- **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese.**

*Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet:* Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

*Plotësia:* Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

*Klasifikimi dhe kuptueshmëria:* Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.

*Saktësia dhe vlerësimi:* Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

- **Objekti i këtij auditimi,** është raportimi financiar dhe paraqitja e drejtë dhe e sinqertë e pasqyrave financiare për vitin 2021. Gjithashtu, sipas programit të auditimit, objekt i

këtij auditimi është edhe vlerësimi i përputhshmërisë së aktivitetit të subjektit të audituar me kriteret e vlerësimit në procedurat e prokurimit.

- **Qëllimi i auditimit**, është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (**ISSAI 1315**)<sup>3</sup>.

Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të **ISSAI 1700**, ne synojmë të japim një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

- **Fushëveprimi i këtij auditimi**, përfshin të gjithë aktivitetin e Bashkisë Pustec. Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, duke vlerësuar evidencat e grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Pustec.

- **Misioni**, për njësinë që auditohet është kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (*të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin*).

- **Objektivat**, burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.

*Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni* ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.

Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.

Organi përfaqësues i Bashkisë është Këshilli Bashkiak.

Organi ekzekutiv i Bashkisë është Kryetari i Bashkisë

---

<sup>3</sup>Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor: krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre, vendos taksa e tarifa për shërbimet si dhe nivelin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesat e bashkësisë, harton, miraton dhe ndjek zbatimin e buxhetit tyre.

Bashkia kryen funksione të veta, të përbashkëta dhe funksione të deleguara.

## **2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të pikave të programit të auditimit nr. 884/1, datë 03.10.2022.**

### **2.1: Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.**

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Pustec , nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i kontrollit”, “Menaxhimi i riskut”, “Aktivitetet e kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime”, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri-tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

**Titulli i gjetjes 1:** Në Bashkinë Pustec ngritja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, nuk është në nivelin e kërkuar sipas dispozitave ligjore.

#### **Situata:**

***1-Mjedisi i kontrollit.*** (Në zbatim të kërkesave të nenin 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

-Bashkia e Pustec, me vendimin e Kryetarit të Bashkisë z. P.K. me Vendimin nr. 36 datë 24.12.2020, **ka përditësuar rregulloren** për nivelin menaxhues dhe për punonjësit e tjerë të njësisë.

**Për vitin 2021**, numri i punonjësve, është miratuar me Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr. 72 datë 24.12.2020. Miratuar në total numri 79 punonjës. *Struktura e miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë* Nr. 10 date 16.03.2021.

Bashkia Pustec nuk ka miratuar Kodin Etik duke mos u bazuar në Ligjin nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”, Ligjin nr. 10296, Kreu III, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2/a dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”.

Konstatohet se: Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme. - Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.- Nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit - Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.. Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhje as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm.

#### **-Struktura organizative e Bashkisë Pustec në vitin e fundit (2021)**

Numri i Personelit në Bashkinë Pustec referuar strukturave organizative, për vitin 2021 nuk ka rritje të numrit të pozicioneve të punës krahasuar me vitin 2020. Numri i miratuar me VKB nr. 72 datë 24.12.2020 “Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës dhe Agjencisë të Bashkisë Pustec për vitin 2021”. Numri total i miratuar i pozicioneve është 86. Situata me personelin për vitin 2021 sipas planit dhe faktit në Bashkinë Pustec paraqitet në tabelën e mëposhtme: **Sipas Aneksit nr. 1**  
Sipas strukturës së miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Nr. 10 datë 22.01.2021, i ndryshuar.

-Pozicionet pune ka të vlerësuara me status të Nëpunësit Civil, gjithsej 22 pozicione, nga të cilat:

**0**- pozicion i kategorisë së lartë

**0**- pozicione të kategorisë së mesme drejtues

**1**-pozicione të kategorisë së ulët drejtuese

**18**- Pozicione të kategorive ekzekutive.

- Pozicionet e lira (të paplotësuara)

**0**-pozicion i kategorisë së lartë

**0**-pozicione të kategorisë së mesme drejtues

**3**-pozicione të kategorisë së ulët drejtuese

**0**-pozicione të kategorive ekzekutive

-largimet dhe emërimet sipas periudhave sipas Anekseve **nr. 2 dhe nr. 3**

**Konstatohet:** Në Bashkinë Pustec, për periudhën deri më 31.12.2021, për arsye të ndryshme, kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 10 punonjës, dhe në asnjë rast nga punonjësit e larguar nuk kanë dorëzuar punën me procesverbal. Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen dhe transmetimin informacionit dhe bazës së të dhënave të krijuara në institucion, por ndërprerje të saj dhe rrjedhimisht ndikojnë në performancën e institucionit. Punonjësit e rinj të marrë rishitas në punë, përballen me vështirësinë e mungesës së informacionit të duhur, duke mos e njohur si duhet situatën e periudhës së paraardhësve të tyre. Në këtë mënyrë nuk krijohet një vazhdimësi kronologjike e transmetimit të punës së kryer nga një punonjës te tjetri, por ndërprerje e saj, në varësi të shpeshësisë së ndërrimit të stafit, e cila sjellë edhe pasojat reale në punën e sektorëve përkatës të njësisë vendore. Në institucion nuk ka rregulla të shkruara për veprimet e punonjësve përpara largimit dhe detyrat e strukturave përkatëse të financës dhe burimeve njerëzore në raste të tilla.

#### **➤ Mbi trajnimin e punonjësve në Bashkinë e Pustec.**

Gjatë vitit 2021 janë ndjekur 25 trajnime për njohuritë e tyre në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për Procedurat e Prokurimit Publik, etj. Por nga Bashkia e Pustec nuk rezulton të jenë hartuar Plane vjetore trajnimesh për punonjësit e saj, por përzgjedhja e personelit për trajnim është realizuar nga Drejtoria e burimeve njerëzore ose nga vet punonjësit. Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve të njësisë kuptohen dhe arrihen nga punonjësit.



Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për: • Caktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune; • Verifikimin e kualifikimeve të kandidatëve për vendet e punës; • Marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta; • Futjen e programeve të trajnimit që ndihmojnë punonjësit të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre. • Kryerjen e analizave periodike për njohuritë dhe aftësitë e kërkua për çdo pozicion pune dhe mbështetur në këto analiza, hartimin e planeve periodike për trajnimin e punonjësve; • Zhvillimin e profesionalizmit menaxherial nëpërmjet trajnimeve dhe marrjes në konsideratë të aftësive menaxhues gjatë procesit. Konstatohet se: Për vitin 2022 Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkinë Pustec nuk është hartuar plani vjetor i trajnimeve në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

**2- Menaxhimi i riskut** (Në zbatim të kërkesave të nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010). Nga Bashkia e Pustec nuk janë hartuar dhe miratuar Regjistrat e Riskut, ku identifikohen risqet që vijnë nga burime të brendshme dhe risqe që vijnë nga burime të jashtme në mos zbatim me ligjin 10296, datë 08.07.2010, Kreu III, neni 10 ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

**Për vitin 2021, Me urdhrin nr. 8 datë 10.01.2022, është miratuar GMS si dhe është emëruar koordinatori i riskut,** në Bashkinë Pustec Z.N., me shkresat përkatëse ju është kërkuar drejtorive hartimi i regjistrit të riskut sipas drejtorive, ***në përputhje me kërkesat e nenit 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.*** Me urdhrat e sipërcituar është ngritur Grupi i menaxhimit strategjik ku kryetar i GSM është Kryetari i Bashkisë, Koordinator z Z.N.si Koordinator të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. **Në lidhje me parimin 8:** “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”. Duke mos patur një vlerësim të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë riskut për veprimtarinë e Bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

**Strategjia e riskut** përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre.

Duhet theksuar se në procesin e miratimit të planeve vjetore të punës, duhet të merren parasysh risqet më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara. Gjithashtu e rëndësishme është që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike.

- Nga auditimi rezulton se në lidhje me *identifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut:* Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. -Mungon plani strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhet të përfshiheshin aktivitetet, plan veprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet

përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës. Përsa i përket PBA-ve është miratuar me VKB nr. 35 datë 27.10.2021 PBA për periudhën 2021-2023.

**-Konstatohet se:** Nga Bashkisë Pustec nuk është hartuar asnjë strategji për menaxhimin e riskut, në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ku citohet se; “Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut”.

Referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, politikat dhe procedurat që vendosen, si parandaluese apo zbuluese në adresimin e risqeve sjellin arritjen e objektivave të institucionit. Bashkia Pustec nuk ka patur në strukturën e saj Auditin e Brendshëm, e cila sjell mungesën e vlerësimeve specifike për sistemet e kontrollit të brendshëm. Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por vepohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

**3-Aktivitetet e kontrollit** (Në zbatim të kërkesave të nenin 22 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010). Sipas dokumentacioni që u disponua lidhur me takimet e detyrueshme vjetore të GMS, referuar Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit financiar dhe kontrollin” citohet se “*Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të mblihet të paktën katër herë në vit. Vendimet e Grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe në përputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhet të pasqyrohen në dokumente dhe t’i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë”.*

**Konstatohet se:** Bashkia Pustec nuk ka miratuar një plan pune vjetor të GMS lidhur me aktivitetet dhe çështjet që do të analizohen, si dhe grafikun e takimeve që do të zhvillohen nga ana e këtij grupi si dhe referuar procesverbaleve vendimeve të takimeve ka të dokumentuar takimet e GMS për vitin 2021 në përputhje me ligjit nr.10296/2010 “Për Menaxhimin financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të menaxhimit financiar dhe Kontrollin.”

**Në lidhje me parimin 11:**“Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”

- Bashkia Pustec nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up).

**Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit në pa pajtueshmëri me kërkesat e UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” pika 40 dhe ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19 “Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve” dhe neni 16 pika 2.**

**4- Informacioni dhe komunikimi** (Në zbatim të kërkesave të nenin 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Bashkia Pustec disponon faqen e saj zyrtare në web, ku pasqyrohet aktiviteti i saj. Komunikimi realizohet elektronikisht, verbalisht dhe në formë shkresore. Me subjektet komunikimi kryhet nëpërmjet telefonit, postës zyrtare apo elektronike. Grupi auditues konstaton se drejtorit kryesorë përdorin email-it zyrtar të institucionit duke qenë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i. Sistemi i raportimit ofron pjesërisht

informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit.

Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Në Bashkinë Pustec punonjësit punojnë me këto sisteme informatike Word dhe Excel. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë elektronike.

**Në lidhje me parimin 14:** Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm.

**Në lidhje me parimin 15:** Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.

**5-Monitorimi** (Në zbatim të kërkesave të nenin 24 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Bashkia Pustec i dërgon Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, për periudhat Janar-Prill, Janar- Gusht dhe Janar- Dhjetor, në total tre raporte vjetore për ecurinë dhe realizimin e produkteve, masën e realizimit të shpenzimeve për vitin 2021. Raportet e monitorimit për periudhën Janar- Prill 2021 nuk janë dërguar në MFE: Raporti për Funksionimin e Cilësisë së Kontrollit të Brendshëm dhe Planin e Veprimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit nuk janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2021: Raportimi mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë, përmban informacione dhe evidenca të ndryshme, ku bazohet dhe Raporti vjetor i monitorimit i cili i dërgohet Ministrisë së Financave. Monitorimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Bashkia Pustec e kryen bazuar në Rregulloren e Brendshme, dokumentin e PBA - ve si dhe raporteve të monitorimit. Nuk ka asnjë evidencë mbi çështjet e kontrollit të brendshëm në lidhje me raportimin. ka asnjë plan veprimi.

Në Bashkinë Pustec mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Në Bashkinë Pustec aktivitetet e vlerësimit të njësive janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit. - Një nga drejtimet e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm në kundërshtim me kërkesat e nenin 24 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin.”

### **2.1.2. Përsa i përket Auditit të brendshëm:**

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se *Organizimi i njësive së auditimit të brendshëm sipas përcaktimeve në VKM nr. 83, datë 03.02.2016” Për Miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” nuk ka gjetur zbatim në Bashkinë Pustec.*

Me Akt marrëveshje nr. 1545/1 datë 22.02.2017 ndërmjet Bashkisë Pustec dhe Bashkisë Pustec është arritur akt marrëveshje për kryerjen e auditimeve nga struktura e auditit të brendshëm së bashkisë Pustec në shërbim të bashkisë Pustec, deri në vitin 2020 janë kryer procedurat e auditimit nga struktura e Auditit të Brendshëm Bashkia Pustec.

Për periudhën objekt Auditimi 01.01.2021-31.12.2021, në Bashkinë Pustec nuk ka funksionuar Njësia e Auditimit të Brendshëm ashtu sikurse nuk është lidhur asnjë akt marrëveshje me asnjë strukturë të auditit të brendshëm të një njësie publike tjetër. Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikat 3 dhe 6 të, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, me emërtesën “Njësia e Auditimit të Brendshëm” dhe ka si funksion kryesor mbështetjen e menaxhimit të lartë në zbatimin e objektivave, për Bashkinë e Pustec, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015. “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni

10, germa "c" si dhe nenit 64, germa "a" të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

**Kriteri:** Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 4 pika 19 "Gjurma e auditimit", neni 21; Udhëzimin e ministrisë së financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 13. Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe pikat 3 dhe 6 të, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik.

**Shkaku:** Neglizhencë e drejtorive/sectorëve për hartimin e regjistrit të riskut, hartimin e strategjisë së riskut si dhe miratimin e gjurmëve të auditimit.

**Ndikimi/Efekti:** Mungon ndarja e qartë e detyrave sipas drejtorive/sectorëve, mos identifikim i shkallës së riskut, mos trajnim efektiv për rritjet profesionale të stafit.

**Rëndësia:** *E mesme*

**Rekomandimi:** Nga Kryetari i Bashkisë Pustec, me atributet e Kryetarit të GMS, të merren masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.

Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit.

Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët të programeve realizimit e objektivave mbi bazë produkti dhe Ndikimi/Efektiviteti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

**Rekomandimi:** Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Pustec në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të merren masa për përmisimin e rregullorës së brendshme në drejtim të dorzimit të detyrës nga personat e larguar, duke përcaktuar detyrimin që ka punonjësi për dorëzimin e aktiveve që ka në inventar dhe të gjithë punës së kryer, dosjeve shkresore, dokumentacionit elektronik, e gjithçka të krijuar nga punonjësi gjatë qëndrimit të tij në detyrë, e cila duhet të konsiderohet "pronë e institucionit". Gjithashtu të përcaktohen edhe detyrimet e strukturave përkatëse të institucionit për këtë qëllim: sektori i shërbimeve, burimeve njerëzore, financës, etj.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec në bashkëpunim me menaxherët kryesor të marrin masa për hartimin e rregullave për ruajtjen e aktiveve, duke përfshirë edhe ruajtjen dhe sigurinë e informacionit elektronik, për shpeshësinë e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, llojet e raporteve që i përgatiten etj. Në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni të hartohet regjistri i riskut, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec, të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Pustec, Njësinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësimit të kësaj strukturë me personel të kualifikuar, të shikohet mundësi e lidhjes së aktmarrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, si Bashkisë Korçë, Maliq ose Devoll.

## **2.2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, për vitin 2021.**

*- Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2021-2023*

**Programimi i PBA 2021-2023.** Nga Bashkia Pustec, janë miratuar treguesit e buxhetit afatmesëm (PBA) për periudhën e viteve 2021-2023. Titullari i Bashkisë Pustec në

përputhje me kriteret dhe kërkesat e ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ka paraqitur në Këshillin e Bashkisë planin e punës për përgatitje e buxhetit afatmesëm 2021-2023 , i cili është miratuar me VKB nr. 63, datë 27.11.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr. 1041/3, datë 11.12.2020 për vitin 2021-2023. Projekt buxheti për vitin 2021-2023 janë hartuar konformë legjislacionit të mësipërm, në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore, janë mbajtur në konsideratë objektivat e politikave të programeve buxhetore dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave me relacionin shpjegues, si për fazën e parë dhe për fazën e dyte te PBA 2021-2023. Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2021-2023, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm e të huaj, si dhe raportet e projekteve të investimeve. Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 8 - programe buxhetore. Gjatë hartimit të PBA për vitet 2021-2023 janë përcaktuar “Përshkrimi” i çdo program, “Politika e programit”, “Qëllimi i Politikës së programit”, “Objektivat e politikës së programit”. Gjithashtu çdo program ka të përcaktuar produktet e programeve buxhetore, në të dy fazat e përgatitjes së tij, shpërndarja e fondeve sipas programeve, ndarja e shpenzimeve sipas natyrës dhe tendenca e të ardhurave sipas PBA paraqitet Aneksin **nr. 4,5 dhe 6**, bashkëlidhur.

Për vitin 2021,buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 71, datë 23.12.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr. 1102/1, datë 07.01.2021, i paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2021	
		Të Ardhurat	Shpenzime t
1	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	8,300	
2	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar	35,257	
4	Transferta specifike	26,679	
6	Transferta e pakushtezuar e trashëguar nga viti 2020	27,406	
8	Paga (600)		51,485
9	Sigurime shoqërore (601)		9,146
10	Shpenzime operative (602)		29,500
11	Transferta (604 - 609) Fondi Rezervë		4,596
12	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike		2,915
<b>Totali i buxhetit</b>		<b>97,642</b>	<b>97,642</b>

Duke u nisur nga burimi i financimit **për vitin 2021** shpenzimet buxhetore janë planifikuar për tu përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 8,300 mijë lekë ose në masën 9 %, nga transferta e pakushtëzuar në shumën 35,257 mijë lekë ose në masën 36 %, transferta specifike sektoriale në shumën 26,679 mijë lekë ose në masën 27 % dhe nga të ardhurat e trashëguara dhe grandit nga viti 2020 në shumën 27,406 mijë lekë ose në masën 28 %.

Për sa i përket shpenzimeve rezulton se për vitin 2021 shpenzimet për paga zënë 53 % ose në vlerën 51,485 mijë lekë, shpenzime korrente zënë 30 % ose për vlerën 29,500 mijë lekë dhe shpenzime për investime zënë 3 % ose në vlerën 2,915 mijë lekë.

- Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet, që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Korçë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare dhe ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit, për vitin 2021 buxheti shtesë gjithsej është në **vlerën 120,675 mijë lekë**. Peshën më të madhe në shtesën e buxhetit e zë investimi për objektin “Furnizimi me ujë Bashkia Pustec në vlerën 109,257 mijë lekë dhe ndihma dhe paafësi në vlerën 11,418 mijë lekë.

- Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Korçë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Korçë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv 2021, të miratuar me Vendim të KB, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara. Nga auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr	E M E R T I M I Sipas Artikujve Te shpenzimeve	Viti 2021		
		Plani Vjetor (me ndryshime)	Fakti progresiv viti 2021	%
1	Llog.600 - Paga	51,317	40,790	79
2	Llog 601 - Sig.shoq.Sh	8,984	6,962	77
3	Llog 602-Shpenz.opera	25,801	12,298	48
4	Llogaria 604, 606	19,299	19,270	100
5	Llog 230 -231	112,916	108,776	96
	<b>Totali</b>	<b>218,317</b>	<b>188,096</b>	<b>86</b>

**- Titulli i Gjetjes 1: Në Bashkinë Pustec u konstatua se ka diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve Operative .**

**Situata:** Për vitin 2021, shpenzimet buxhetore sipas aktrakordimit me thesarin të planifikuara në vlerën 218,317 mijë lekë janë realizuar në vlerën 188,096 mijë lekë ose në masën 86 %, sipas artikujve: paga në masën 79%, sigurime në masën 77 %, shpenzime operative në masën 48 %, dhe investime në masën 96% ).

Nga auditimi në lidhje me planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve korrente u konstatua se nga 25,801 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në fakt në vlerën 12,298 mijë lekë ose 48 % me mosrealizim në vlerën 13,503 mijë lekë, rezulton se ka diferenca të dukshme midis planit dhe realizimit kryesisht në mos kryerjen e shpenzimeve për disa shërbime të planifikuara, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë, sipas zërave Aneksin **nr. 7**, bashkëlidhur.

**-Kriteri:** Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

**-Ndikimi/Efektiviteti :** Mosrealizim i shpenzimeve të planifikuara, me pasojë mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

**-Shkaku:** Analizat e punës për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetet paraardhëse nuk janë bërë të plota, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve gjatë viteve.

**-Rëndësia: E lartë.**

**-Rekomandimi:** Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Pustec të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Nga auditimi në lidhje me planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve për investime u konstatua se nga 112,916 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në fakt në vlerën 108,776 mijë lekë ose 96 % me mosrealizim në vlerën 4,140 mijë lekë, sipas objekteve në pasqyrën si më poshtë:

Në 000/lekë

Nr	E M E R T I M I Sipas objekteve	Viti 2021		
		Plani Vjetor (me ndryshime)	Fakti progresiv viti 2021	%
1	Furnizim me ujë për Bashkinë Pustec me fonde të ministrisë së linjës me fond (540,996 mijë lekë)	109,257	108,199	
2	Blerje pajisje nga Projekti PNUD me fond i projektit	111	107	
3	Prodhim dhe instalim Gazepo druri me fonde të veta	2,715	470	
4	Blerje projekti nga fondet e veta	833	0	
	<b>Totali</b>	<b>112,916</b>	<b>108,776</b>	<b>96</b>

- *Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe i kontigjencës*

Fondi rezervë për vitin 2021 është në total në shumën 1,747 mijë lekë, i cili është miratuar sipas buxhetit fillestar e deri në fund të vitit buxhetor me VKB dhe konfirmuar nga Prefekti I Qarkut Korçë. Gjatë vitit 2021, nuk janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e

Shqipërisë” neni 65, si dhe me Udhëzimin nr. 22 datë 30.07.2018 “Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësive të Qeverisjes vendore” raporti i monitorimit të buxhetit për periudhën Janar-dhjetor 2021 është miratuar me VKB nr. 7, datë 26.01.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut, me shkresën nr. 92/1, datë 01.02.2022.

- Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli realizimit të të ardhurave.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

**- Titulli i Gjetjes 2:** Në Bashkinë Pustec u konstatua se, deri më datë 31.12.2021, nuk ka likuiduar detyrime në vlerën gjithsej 2,339,662 lekë.

### **Situata:**

Nga të dhënat e bilancit, konstatohet se totali i faturave të palikujduara në fund të vitit 2020 në janë për **vlerën 2,033,221 lekë** nga këto, Llog (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, paraqiten në vlerën 435,624 lekë dhe detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 1,597,597 lekë.

Nga auditimi në lidhje me likuidimin e tyre rezulton se me buxhetin e vitit 2021 janë likuiduar gjithsej 838,260 lekë, ngelen detyrime në fund të vitit që trashëgohen për vitin 2021 në **vlerën 1,194,961 lekë**.

Nga auditimi i rezultoi se me datë 31.12.2021, nuk janë likuiduar detyrimet për fatura të mbërritura dhe vendime gjykate, që ju ka kaluar afati 60 ditorë për likuidim në 15 raste në vlerën gjithsej **2,339,662 lekë**, perkasin llogarive (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe (467) “Kreditorë të ndryshëm”, sipas të dhënave të Aneksit **nr. 8**, bashkëlidhur.

**-Kriteri:** Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253,354, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 40, 48 dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat Standard të zbatimit të buxhetit" neni 101.

### **-Ndikimi/Efektiviteti:**

Nuk është respektuar radha e likuidimit të detyrimeve për faturat e periudhave të mëparshme me buxhetin e vitit pasardhës, nuk është bërë analizë nga titullari i institucionit si dhe nxjerrja e përgjegjesisë administrative për detyrimet e prapambetura.

### **-Shkaku:**

Nga mos realizimi i të ardhurave. Analizat e faturave të papaguara për mallrat, shërbimet dhe detyrimet e tjera të papaguara nuk janë bërë të plota në buxhetet paraardhëse, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për krijimin dhe akumulimin e detyrimeve të prapambetura dhe analizimin e të gjitha detyrimeve, **veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi Z.N. me detyrë Përgjegjës i Financës, për periudhën objekt auditimi.**

### **-Rëndësia: E lartë**



**-Rekomandimi:** Bashkia Pustec, Sektori Financës, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave sipas nivelit të realizimit të të ardhurave.

**2.2.6: Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi. Vlerësimi i mbledhjes të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.**

Për periudhën objekt auditimi, sipas strukturës organizative, për mbledhjen e të ardhurave ka funksionuar Sektori i Tatim Taksave, me 2 inspektorë.

Paketat fiskale për periudhën objekt auditimi janë miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr. 70, datë 24.12.2020 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Pustec, penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2021”, konfirmuar nga Prefekti I Qarkut Korçë me shkresën 1102/1 prot., datë 07.01.2021.

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për periudhën objekt auditimi, subjekte që kanë ushtruar aktivitet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Lloji Biznesit	Viti 2021			
	Gjendj a fillim	Biznese të reja	Biznese të mbyllur	Gjendja në fund
B. Vogël	19	2	1	20
B. Madh	1	0	0	1
<b>Gjithsej</b>	<b>20</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>21</b>

Për vitin 2021, kanë ushtruar aktivitet 21 subjekte (20 subjekte të biznesit të vogël dhe 1 subjekt i biznesit të madh).

Bashkia Pustec me VKB si më sipër ka miratuar treguesit e planit të të ardhurave, për vitin 2021.

Në mënyrë analitike planifikimi dhe realizmi i të ardhurat për taksat dhe tarifat vendore paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Viti 2021	
		Plan	Fakt
<b>I</b>	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE</b>	<b>3,914</b>	<b>1,943</b>
1	Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	1,087	537
2	Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	1,252	350
3	Të ardhura nga taksa mbi truallin	67	47
4	Taksë table	8	8
5	Taksa e ndik. në infr. nga ndërtimet pa leje (leg)	1,000	675
6	Taksë rruge mjete transporti	500	321
7	Tatimi thjeshtuar mbi fitimin	0	5
<b>II</b>	<b>TË ARDHURA JO TATIMORE</b>	<b>4,386</b>	<b>3,228</b>
1	Të ardhura nga tarifë pastrimi	1,700	839
2	Të ardhura nga tarifë ndriçimi	730	328
3	Të ardhura nga tarifë dru zjarri	500	0
4	Tarifa të ndryshme	626	174
5	Të ardhura nga qiratë	800	644
6	Kamatëvonesa	30	8
7	Tatim mbi të ardhurat personale	0	923
8	Sponsorizime	0	312
	<b>Totali</b>	<b>8,300</b>	<b>5,171</b>
			62 %

Për vitin 2021, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore gjithsej, nga 8,300 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 5,171 mijë lekë ose 62 %, **me një mosrealizim në vlerën 3,129 mijë lekë.**

Sa më sipër u konstatua se me mosrealizim të dukshëm janë të ardhurat nga taksat e tarifatat që mbledhen nga sektori I të ardhurave të cilat për vitin 2021, nga 7,800 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 3,116 mijë lekë ose 46 %, **me një mosrealizim në vlerën 4,684 mijë lekë.**

**-Titulli i gjetjes 1:** Mos ndjekje e plotë e procedurave ligjore për mbledhjen e detyrimeve debitorë.

**Situata:**

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore **në vlerën gjithsej 17,853,280 lekë**, janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh gjithsej 11 subjekte në vlerën 261,452 lekë dhe 1336 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 17,591,828 lekë, sipas të dhënave të pasqyrës si më poshtë:

Emërtimi	Gjendja në fund të vitit 2020		Gjendja në fund të vitit 2021	
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë
Biznese	10	225,921	11	261,452
Familjarë	1355	14,813,219	1336	17,591,828
<b>Totali</b>	<b>1365</b>	<b>15,039,140</b>	<b>1347</b>	<b>17,853,280</b>

Sa më sipër për periudhën objekt auditimi, përfshihen debitorët e biznesit të vogël e të madh **për 11 subjekte në vlerën 261,452 lekë.**

Sektori I Tatim Taksave, në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime.

Sipas të dhënave, edhe pse vazhdojnë procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 11 subjekte debitorë në vlerën 261,452 lekë, janë aktiv 2 subjekte ose 18 % e totalit të cilët nuk paguajnë detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore.

*Për veprimet dhe mosveprimet në përputhe me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjor mbahet ky akt konstatimi me z. Q.TH. dhe E.A. me detyrë inspektorë të Sektorit të tatim Taksave.*

**-Kriteri:** Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale, etj.

**-Ndikimi/Efektiviteti:** Mungesa e të ardhurave sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njesisë së Qeverisjes Vendore.

**-Shkaku:** Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinon taksat dhe tarifatat vendore nga strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

**-Rëndësia: E lartë**

**-Rekomandimi:** Bashkia Pustec, Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të periudhës në vlerën **17,853,280 lekë.**

**2.3. Vlerësimi mbi raportimin financiarë për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2021 japin një paraqitje të vërtetë të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë.**

**Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2021.**

Për vitin 2021, Në përputhje me kërkesat e UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Korçë me shkresën nr. 724/1 prot., datë 17.05.2021, jashtë afateve ligjore në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollit” germa “d”, pika 4, neni 9, germa “b”, pika 2, neni 12, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 118, të përbëra si vijon:

Format nr. 1 –Pasqyra e pozicionit financiar.

Format nr. 2 –Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Caush-Flou).

Format nr. 4 –Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Format nr. 5 –Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit.

Format nr. 7/a –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).

Format nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).

Format nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga Kryetari i Bashkisë si dhe hartuesi i llogarive C.N..

**Mbajtja e kontabilitetit viti 2021.**

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, ditari i arkës, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj.

**-Rakordimi i llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe llogarive të Aktiveve Qarkulluese me rezultatet e inventarizimit fizik viti 2021:**

**Për vitin 2021**, ka dalë urdhri i Kryetarit nr. 174, datë 01.11.2020 “Për inventarizimin e krijimin e komisioneve të inventarizimit të aktiveve”

Nga auditimi i procedurave të inventarizimit u konstatua se është kryer inventarizimi fizik vetëm për llogarinë 327- “Objekte inventar” që në bilanc paraqitet në vlerën 15,327,373 lekë dhe nuk rakordon me përmbledhësen e inventarit të kësaj llogarie për vlerën 2,977 lekë.

***Nuk është kryer inventarizimi për aktivet e tjera.***

Në këto kushte, llogaritë e pasqyrave financiare, nuk janë të rakorduar me gjendjen fizike gjë e cila nuk krijon besueshmëri mbi vërtetësinë e tyre.

Në këtë rast, nxjerrja e pasqyrave financiare pa kryer inventarizimin fizik të gjithë aseteve, është shkelje e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 4, pika 24, të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu IV, pika 73, ku citohet: *Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësive, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe*

sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe nga titullari i njësisë publike, pika 74, ku citohet: Çdo njësi publike duhet të kontrollojë te paktën një here në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës, të **UMF Nr. 8, datë 9.03.2018** “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” **Kreu III, pika 30 ku citohet:** “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konformë kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet.”

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2021, të pozicionit financiar Bashkia Pustec; Formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2021, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si në vijim;

**Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=321,970,883 lekë.**

Aktivet	334,669,441 lekë
Pasivet	12,698,558 lekë
Aktivet neto	321,970,883 lekë

#### **Aktivet afatshkurtra**

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2021 paraqiten në vlerën **67,343,822 lekë** dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 41,194,373 lekë;

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 21,039,157 lekë;

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 5,110,292 lekë.

#### **Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:**

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2021-2020
531	Mjete monetare në arkë	0	0	0
512	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	41,194,373	29,503,586	11,690,787
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akredeitiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizione zhvlerësimi	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>41,194,373</b>	<b>29,503,586</b>	<b>11,690,787</b>

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 41,194,373 lekë, sipas aktrakordimit me Thesarin datë 31.01.2022, përbëhet nga (të ardhura të trashëguara të paçelura 31,768,864, fond pagash i paçelur i ardhur nga buxheti i shtetit në vlerën 3,000,000 lekë, fond për detyrimet e prapambetura në vlerën 41,692 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 6,383,817 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr. 3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte” të paraqitur më poshtë:

Numër Rreshti	Numër Rubrike	Përmbajtja	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
(a)	(b)	(c)	(1)	(2)
1	I	<b>VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT</b>	39,280,300	10,415,096
2	1	<b>Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime korente (+)</b>	105,400,650	89,185,659
3	2	<b>Arkëtime e te hyra (Cash), gjate vitit ushtrimor</b>	10,600,721	6,353,902
4		Te hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)	2,874,008	4,523,494
5		Te hyra nga Kontributet e Sig. shoq. e shendets(+)	20,000	100,000
6		Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)	1,985,353	0
7		Te hyra, Sponsorizime nga te trete,(+)	311,400	0
8		Te hyra, nga kredi e huamarrje afatshkurtër(+)	0	0
9		Te hyra nga Mjetet ne ruajtje(+)	5,409,960	368,679
10		Te tjera, arkëtuar(+)	0	1,361,729
11	3	<b>Pagesa për Detyrime e Shpenzime korente</b>	-76,721,071	65,222,567
12		Për detyrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)	0	0
13		Për detyrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)	-75,596,826	-64,828,646
14		Pagesat për mjetet ne ruajtje(-)	-1,124,245	393,921
15		Interesi I paguar(-)	0	0
16		Tatime te paguara(-)	0	0
17		Te tjera te paguara (-)	0	0
18	II	<b>VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE</b>	4,140,441	7,200,939
19		<b>Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime Kapitale (+)</b>	112,916,293	34,676,023
20		Te hyra nga Kredi dhe e huamarrje afatgjata(+)	0	0
21		Te hyra nga shitja e Aktiveve Afatgjata (+)	0	0
22		Te hyra nga interesat e huadhënies dhe nen huadhënies(+)	0	0
23		Pagesa për detyrime e Investime nga vitet e kaluara(-)	0	0
24		Për detyrime e Investime te viti ushtrimor(-)	-108,775,852	-27,475,084
25		Huadhënie e Nen huadhënie(-)	0	0
26		Pjesëmarrje ne kapitalin e vet(-)	0	0
27		Dividendë te paguar(-)	0	0
28	III	<b>TRANSFERTA E TE TJERA</b>	-4,188,456	-8,747,575
29		Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)	-210,147	-1,800
30		Transferime ne buxhet te Fondeve te pa përdorura(-)	-1,378,309	-6,055,775
31		Lëvizje e brendshme e transferata te tjera(+/-)	-2,600,000	-2,690,000
32	IV	<b>Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare</b>	11,690,787	8,868,460
33	V	<b>Teprica ne fillim te vitit ushtrimor</b>	29,503,586	20,635,126
34	VI	<b>Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor</b>	41,194,373	29,503,586

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2021-2020
	<b>Gjendja inventar Qarkullues</b>			
31	Materiale	5,711,784	20,773,709	(15,061,925)
32	Inventar i imet	15,327,373	10,417,959	4,819,414
	<b>Totali</b>	<b>21,039,157</b>	<b>31,191,668</b>	<b>(10,152,511)</b>

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Pustec në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 21,039,157 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 5,711,784 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 15,327,373 lekë. Diferencat me vitin e mëparshëm përfaqësojnë lëvizjen e inventarit në shumën (10,152,511) lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 10,152,511 lekë.

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 5,711,784 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2021 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
<b>Gjendje në 01.01.2021</b>	<b>20,773,709</b>
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2021	11,779,411
Dalje nga magazina gjatë vitit 2021	26,841,336
<b>Gjendja në 31.12.2021</b>	<b>5,711,784</b>

Llogaria 32 “Inventarë i imët”, ka vlerën 15,327,373 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2021 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
<b>Gjendje në 01.01.2021</b>	<b>10,417,959</b>
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2021	4,909,414
Dalje nga magazina gjatë vitit 2021	0
<b>Gjendja në 31.12.2021</b>	<b>15,327,373</b>

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2021-2020
	<b>Llogari të arkëtueshme</b>	5,110,292	4,445,815	664,477
468	Debitorë të ndryshëm	129,768	129,768	0
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	4,980,524	4,316,047	664,474
	<b>Totali</b>	<b>5,110,292</b>	<b>4,445,815</b>	<b>664,477</b>
	<b>Të tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>1,437,029</b>	<b>-1,437,029</b>
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	1,437,029	-1,437,029

**-Titulli i gjetjes 1:** Në llogarinë 486 “Debitorë të ndryshëm”, nuk janë pasqyruar debitorët për taksa dhe tarifa vendore në vlerën 17,853,280 lekë.

**Situata:**

Llogaritë 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 129,768 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2021 në krahasim me vitin 2020 rezultojnë se nuk ka patur ndryshime. Analiza e gjendjes së llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqiten Aneksin nr. 9, bashkëlidhur.

Nga verifikimi i kryer rezultojnë që në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk janë përfshirë debitorët për taksat dhe tarifën vendore në vlerën gjithsej në **vlerën 17,853,280 lekë** (për 11 subjekte në vlerën 261,452 lekë dhe 1336 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 17,591,828 lekë).

**Kriteri:**

Udhëzimi i MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

**Ndikimi/Efektiviteti:** Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie

**Shkaku:**

Mos zbatim i Udhëzimi i MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu

III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

**Rëndësia: I Mesëm**

**Rekomandimi:** Sektori i Financës, të marrë masa për kontabilizimin në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, të debitorëve për taksa dhe tarifa vendore në vlerën 17,853,280 lekë.

**Titulli i gjetjes 2:** Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,980,524 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar dhe nuk kuadron me këto llogari për vlerën 1,143,781 lekë.

**Situata:**

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 4,980,524 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 4,980,524 lekë.

Në mënyrë analitike sipas Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare paraqitet:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”	2,179,094
Llogaria 467 “Kreditor të ndryshëm” fatura të muajit nëntor dhjetor.	0
Paga personeli llog. 42	2,804,280
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	136,115
Sigurime shoqërore llog.435	887,203
Sigurime shëndetësore llog.436	117,613
<b>Totali</b>	<b>6,124,305</b>

Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,980,524 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar të cilat janë raportuar për vlerën 6,124,305 lekë dhe nuk kuadron me këto llogari për vlerën 1,143,781 lekë.

**Kriteri:**

UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëzive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32.

**Ndikimi/Efektiviteti:** Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie

**Shkaku:** Mos zbatim i Udhëzimit i MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëzive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

**Rëndësia: I Mesëm**

**Rekomandimi:** Sektori i Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarive të Klasës së 4 të Pasivit të bilancit për vlerën 1,143,781 lekë.

Nga auditimi rezultoi se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur në vlerën 0 lekë, kjo në zbatim të Udhëzimit MFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” seksioni 3.1, për të cilën është kredituar llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në debi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

### **Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)**

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2020 dhe 2021 paraqitet në të njëjtën vlerë 18,399,892 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 18,399,892 lekë. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar sipas **Aneksit nr. 10**, bashkëlidhur.

**-Titulli i gjetjes 3:** *Aktivet Afatgjata Jo materiale, konkretisht llogaria 202 Studime dhe Kërkime në vlerën 18,399,892 lekë, nuk është pasqyruar saktë pasi në të përfshihet vlera prej 2,865,892 lekë, investimeve për objekte të përfunduara.*

### **Situata:**

Nga verifikimi i analitikëve, konstatohet se llogaria 202 “*Studime dhe projekttime*”, është mbajtur në bilanc si llogari më vete në vlerën 18,399,892 lekë, pavarësisht faktit që këto studime e projektme i përkasin investimeve për objekte të përfunduara. Vlera e këtyre objekteve, duhej të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e koston totale të objektit që i përket, kjo ka sjellë paraqitjen e Aktiveve Afatgjata Materiale më pak për vlerën 2,865,892 lekë për vitin 2021, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Aneksi 1 “*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*” Pika 2. Klasa 2, “*Aktivet afatgjata*” (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: “*Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivitetit, si dhe vlerësimin e mëposhëm: a) Njohja fillestare - AAGJM-ja, duhet të plotësojnë kriteret e njohjes në pasqyrën e pozicioni financiar, pra, duhet të vlerësohen me kosto që janë:- Kostoja e blerjes së bashku me taksat e importit;- Kosto të tjera të drejtpërdrejta deri në sjelljen e aktivitetit në vendndodhje apo dhe kosto të tjera që i shtohen nga prodhimi i elementeve të aktivitetit (**kosto projektimi**, paga dhe kontribute për prodhimin e elementeve të aktivitetit, materiale të përdorura për këto elemente, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi etj.).*

### **Kriteri:**

Udhëzimi i MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

**Ndikimi/Efektiviteti:** Pasqyrim jo i saktë i llogarive të aktiveve.

### **Shkaku:**

Mos zbatim i Udhëzimi i MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

### **Rëndësia: I Mesëm**

**Rekomandimi:** Sektori i Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë kreditimin e saj në debi të Aktiveve Afatgjata Materiale si pjesë e koston së tyre, në vlerën 2,865,892 lekë.

### **Aktivet e afatgjata materiale (AAM)**

Llog 210 “*Toka, troje Terrene*”, paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në shumën 0 lekë, po ashtu dhe në Formatin 7/b “Gjendja dhe



ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 0 lekë.

Llog 211 “Pyje, Plantacione”, paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,793,836 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr. 7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 1,793,836 lekë, kjo llogari është e analizuar për një objekt në vlerën 1,793,836 lekë.

Llog 212 “Ndërtesa konstruksione”, paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 42,044,173 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 50,552,353 lekë dhe në vitin 2020 në vlerën 50,082,499 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 469,854 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM si:

- Ndërtim Gazebo druri në vlerën 469,854 lekë, në mënyrë analitike paraqiten Aneksin nr. 11, bashkëlidhur.

**-Titulli i gjetjes 4:** *Aktivet Afatgjata Materiale, konkretisht llogaria 212 “Ndërtesa konstruksione”, shtesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të aktivit por janë trajtuar si aktive më vete.*

#### **Situata:**

Nga auditimi u konstatua se për llogarinë 212 “Ndërtesa konstruksione” e analizuar në kontabilitet për 45 objekte (aktive) në vlerën 50,552,353 lekë, nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, rezulton se shtesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të aktivitetit por janë trajtuar si aktive më vete, kjo llogari duhet analizuar në kontabilitet për 20 objekte (aktive), në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket kësaj llogarie për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30, sipas të dhënave të Aneksit nr. 12, bashkëlidhur.

#### **Kriteri:**

Udhëzimi i MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

**Ndikimi/Efektiviteti:** Regjistrim në kontabilitet i aktiveve pa u analizuar saktë.

#### **Shkaku:**

Mos zbatim i Udhëzimi i MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

#### **Rëndësia: I Mesëm**

**Rekomandimi:** Sektori i Financës, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksione”, të saktësojë vlerat e këtyre objekteve duke shtuar shpenzime për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Llog 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 193,599,245 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 231,600,561 lekë dhe në vitin 2020 në vlerën 123,401,363 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 108,199,198 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM si:

- Furnizimi me ujë Bashkia Pustec, në vlerën 108,199,198 lekë, në mënyrë analitike paraqiten Aneksin nr. 13, bashkëlidhur.

**Titulli i gjetjes 5:** *Aktivet Afatgjata Materiale, konkretisht llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, shtesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të aktivitetit por janë trajtuar si aktive më vete.*

**Situata:**

Nga auditimi u konstatua se për llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” e analizuar në kontabilitet për 44 objekte (aktive) në vlerën 231,600,561 lekë, nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, rezulton se shtesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të aktivitetit por janë trajtuar si aktive më vete, kjo llogari duhej analizuar në kontabilitet për 14 objekte (aktive), në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket kësaj llogarie për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30, të dhënat Aneksin nr. 14, bashkëlidhur.

**Kriteri:** Udhëzimi i MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

**Ndikimi/Efektiviteti:** Regjistrim në kontabilitet i aktiveve pa u analizuar saktë.

**Shkaku:**

Mos zbatim i Udhëzimi i MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

**Rëndësia: I Mesëm**

**Rekomandimi:** Sektori i Financës, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, të saktësojë vlerat e këtyre objekteve duke shtuar shpenzime për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Llog 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 4,058,708 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 8,527,462 lekë dhe në vitin 2020 në vlerën 8,527,462 lekë, në mënyrë analitike paraqiten Aneksin **nr. 15**, bashkëlidhur.

**Titulli i gjetjes 6:** *Paraqitje në kontabilitet Aktivet Afatgjata Materiale, konkretisht llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, investimet që i përkasin Ujësjellës Kanalizime SHA Pustec.*

**Situata:**

Nga auditimi u konstatua se gjendja kontabël (kosto historike) për vitin 2021 e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, është e analizuar për 17 objekte inventari në vlerën 8,715,343 lekë. Nga verifikimi i analitikëve të kësaj llogarie rezulton se nuk është zbritur vlera e investimeve të kryera në ujësjellës që duhej të transferohej tek Ujësjellës Kanalizime SHA Pustec, për 2 objekte në vlerën 1,750,944 lekë (*objekti “Furnizim, vendosje sahat uji” në vlerën 1,709,906 lekë dhe “Mbikëqyrje punimesh për vendosje sahat uji” në vlerën 41,038 lekë*), me ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

**Kriteri:**

Udhëzimi i MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”.

**Ndikimi/Efektiviteti:** Paraqitje në kontabilitet të aktive që i përkasin Ujësjellës Kanalizime SHA Pustec .

**Shkaku:**

Mos zbatim i Udhëzimi i MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”.

**Rëndësia: I Mesëm**

**Rekomandimi:** Bashkia Pustec, Sektori i Financë të kryej transferimin e aseteve që i përkasin Ujësjellës Kanalizime SHA Pustec me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët dhe të kryhen veprimet kontabël duke zbritur nga llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” vlerën për investimet e kryera në shumën 1,750,944 lekë.

Llogaria 215 “Mjete transporti”. Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë më datë 31.12.2021 në shumën 6,388,389 lekë, (në vlerë neto). Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 37,508,730 lekë dhe në vitin 2020 në vlerën 36,425,797 lekë, në mënyrë analitike paraqiten Aneksin **nr. 16**, bashkëlidhur.

Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”. Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, etj. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit

2020 në vlerën 468,791 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 40,741 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr. 7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 5,241,702 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën kontabël 5,348,502 lekë. Në këto gjendje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 106,800 lekë. Ndërsa vlera e amortizimit e përllogaritur është në shumën 5,307,761 lekë, në mënyrë analitike paraqiten Aneksin **17**, bashkëlidhur Raport Auditimit.

**Titulli i gjetjes 7:** *Paraqitja në pasqyrat financiare Aktivitet Afatgjata Materiale pa titull pronësie.*

**Situata:**

Nga auditimi ka rezultuar se, nga 90 objekte inventari të analizuar në kontabilitet të pasurive të paluajtshme me kosto historike që i përkasin llog. 211 “Pyje plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në vlerën 283,946,750 lekë, Bashkia Pustec **nuk posedon titull pronësie**, në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35.

**Kriteri:** VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35

**Ndikimi/Efektiviteti:** Paraqitje në kontabilitet të aktiveve Afatgjata Materiale pa titull pronësie.

**Shkaku:** Mos zbatim i VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35

**Rëndësia: I Mesëm**

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Drejtoria Korçë dhe nëpërmjet Sektorit të Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

**Titulli i gjetjes 8:** *Paraqitje në kontabilitet, konkretisht llogaria 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, në vlerën 0 lekë kur në fakt kemi kontrata për investime të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor.*

**Situata:**

Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se, për vitin 2021 ka kontrata që nuk ka përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilën është kryer pagesë, për vlerën 108,199,198 lekë, që i përket llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” për kontratën me objekt “Furnizim me ujë Bashkia Pustec” me vlerë 547,692,661 lekë me afat shlyerje deri në vitin 2024.

Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0, kur ka investime në proces, pra vlera e kësaj llogarie duhet pasqyruar në vlerën 108,199,198 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Klasa 23 në të cilën përcaktohet: “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik Për realizimin dhe krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ka një procedurë specifike:

- Fillimisht, për njësitë planifikohen dhe realizohen operacionet e investimeve për blerjen apo krijimin e AAGJ-ve.
- Për rrjedhim, aktivet afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23, “Investime”.
- Këto janë investime në proces, pra aktivi ende nuk është përfunduar dhe detyrimisht nuk është në funksionim dhe nuk është kapitalizuar. Grupi 23, “Investime” ndahet në dy llogari treshifrore që më tej klasifikohen në nivele shtatëshifrore, sipas karakteristikave të këtyre aktiveve.
- Llog.230, “Investime për aktive afatgjata jomateriale”, të analizuar në llogari shtatëshifrore; dhe
- Llog. 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, të analizuar në llogari shtatëshifrore.”

Me përfundimin e ciklit të blerjes apo ndërtimit të aktiveve, këto bëhen funksionale dhe kapitalizohen në grupet 20 e 21 të aktiveve të përfunduara.”

**Kriteri:** UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Klasa 23.

**Ndikimi/Efektiviteti:** Deformim i informacionit kontabël.

**Shkaku:** Mos zbatim i UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Klasa 23.

#### **Rëndësia: I Mesëm**

**Rekomandimi:** Sektori i Financës në Bashkinë Pustec, në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

### **PASIVET (DETYRIMET)**

#### **Pasivet Afatshkurtra**

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Pustec më 31.12.2021, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2021, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2021, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2021	Viti 2020	Diferenca/ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	2,179,094	435,624	1,743,470
42	Detyrime ndaj personelit	2,804,280	2,744,772	59,508

431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	136,115	120,437	15,678
435	Sigurime shoqërore	887,203	841,346	45,857
436	Sigurime shëndetësore	117,613	113,200	4,413
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	6,383,817	2,098,102	4,285,715
467	Kreditorë të ndryshëm	160,566	1,597,597	-1,437,031
	<b>Gjendja më fund të periudhës</b>	<b>12,668,688</b>	<b>7,951,078</b>	<b>4,717,610</b>

Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në fund të vitit 2021 është në vlerën 2,179,094 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Pustec më 31.12.2021. Lëvizja e llogarisë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", paraqitet në tabelën si me poshtë:

Llog. 401-408 "Furnitorë e llogari te lidhura me to"	
<b>Celje e vitit 2021</b>	<b>435,624</b>
Shtesa (K)	5,564,784
Pakësime (D)	3,821,314
<b>Gjendja në 31.12.2021 (K)</b>	<b>2,179,094</b>

Analiza e llogarisë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"

Nr	EMERTIMI	FATURA TATIMORE NUMER DHE DATE	SHUMA
1	Materiale shërbime	Date 20.07.2011	24,000
2	Shërbime interneti	Fat. Nr. 2429, datë 10.04.2011	249,600
3	Materiale	Datë 26.11.2013	19,200
4	Diferenca		29,280
5	Blerje hipoklorit	Fat. Nr. 107, datë 24.07.2015	10,800
6	Konsum uji i pijshëm	Viti 2017-2018	102,744
7	Shërbim postarë	Viti 2020	12,588
8	Uji i pijshëm	Viti 2020	104,355
9	Pagesë TVSH	Viti 2020	481,826
10	Pagesë kolaudatori	Faturë nr. 15, viti 2021	20,005
11	Përpilim akti	Faturë nr. 7, viti 2021	25,000
12	Vendim Gjykatës së Apelit Korçë ë nr.54, datë 25.05.2021 i për largim nga pune		386,800
13	Pagesë TVSH Net	Faturë 13, viti 2021	684,993
14	Shërbime postare	Viti 2021	27,903
	<b>SHUMA</b>		<b>2,179,094</b>

Llogaria 42, "Detyrime ndaj personelit", sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Pustec, paraqitet në vlerën 2,804,280 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llog. 42 "Detyrime ndaj personelit"	
<b>Celje e vitit 2021</b>	<b>2,744,772</b>
Shtesa (K)	34,486,344
Pakësime (D)	34,466,836
<b>Gjendja në 31.12.2021</b>	<b>2,804,280</b>

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2022, ka rezultuar:

Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	Datë	
1	10.01.2022	2,757,932
2	07.01.2022	46,348
Totali		2,804,280

Llogaria 431, "Detyrime ndaj shteti për tatim taksa", paraqitet në vlerën 136,115 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llog. 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
<b>Celje e vitit 2021</b>	<b>120,437</b>

Shtesa (K)	1,640,444
Pakësime (D)	1,624,766
<b>Gjendja në 31.12.2021 (K)</b>	<b>136,115</b>

Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2021 që paguhen në muajin janar 2022 dhe janë përkatësisht në vlerat 887,203 lekë dhe 117,613 lekë.

<b>Llog. 435 "Sigurime shoqërore"</b>	
<b>Celje e vitit 2021</b>	<b>841,346</b>
Shtesa	10,689,221
Pakësime	10,643,364
<b>Gjendja në 31.12.2021</b>	<b>887,203</b>
<b>Llog. 436 "Sigurime shëndetësore"</b>	
<b>Celje e vitit 2021</b>	<b>113,200</b>
Shtesa	1,416,352
Pakësime	1,411,939
<b>Gjendja në 31.12.2021</b>	<b>117,613</b>

Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 2,098,102 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 6,383,817 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit Korçë në mënyrë analitike e cila paraqitet Aneksin nr. 18, bashkëlidhur.

#### **Situata:**

Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 6,328,772 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesari, kjo llogari për vitin 2021 është kredituar për 1 objekt për vlerën 5,409,960 lekë dhe është debituar në 1 rast për vlerën 1,124,245 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde për vlerën 918,857 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e para, të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Pustec nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për ç’bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për interes publik, veprime në kundërshtim me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

**Kriteri:** UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

**Ndikimi/Efektiviteti:** Humbje e të drejtës së përfitimit dhe mos përdorim i fondeve të garancisë së punimeve.

**Shkaku:** Mos zbatim i UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kap. III, pikat 29,

30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

**Rëndësia: I Mesëm**

**Rekomandimi:** Sektori i Financës në Bashkinë Pustec, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e më parë (vlera 918,857 lekë), për të cilat ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Korçë, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqiten faturat e pa likuiduara shërbime të cilat për vitin 2021 paraqiten në shumën 160,568 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2021 paraqitet si më poshtë:

Llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm"	
<b>Celje e vitit 2021</b>	<b>1,597,597</b>
Shtesa	0
Pakësime	1,437,029
<b>Gjendja në 31.12.2021</b>	<b>160,568</b>

Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, paraqiten paraqitet si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 29,868 lekë, vlera të cilat nuk rakordon me gjendjen e llogarisë kundërpanti 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit e cila paraqitet në vlerën 129,768 lekë, veprim në me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32.

**Analizë: Format i nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”** paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2021, të cilat në total janë në vlerën 123,179,883 lekë, të cilat paraqiten si më poshtë:

- Të ardhura nga taksat e tatimet në vlerën 1,950,027 lekë,
- Të ardhura jo tatimore në vlerën 1,665,248 lekë,
- Grande korrent në vlerën 119,331,535 lekë,
- Të ardhura të tjera në vlerën 233,073 lekë.

Referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Korçë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë analitike 7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël” pasqyrohet në bilanc për vitin 2021 në **vlerën 5,000 lekë** e cila përfshin taksën mbi Biznesin e vogël dhe Tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë 7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme” pasqyrohet në bilanc për vitin 2021 në **vlerën 886,839 lekë** e cila përfshin (taksën mbi pasurinë në vlerën 536,591 lekë dhe taksë toke në vlerën 350,248 lekë) rakordon me të njëjtin zë në aktrakordin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë 7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie” pasqyrohet në bilanc për vitin 2021 në **vlerën 1,058,188 lekë** e cila përfshin (taksa e ndriçimit në vlerën 328,050 lekë, taksë e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja në vlerën 675,266 lekë, taksë trualli në vlerën 46,962 lekë dhe taksë tabele në vlerën 7,910 lekë)



- Gjendja e llogarisë 7109 “Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia” paraqitet në bilancin e 2021 në **vlerën 644,171 lekë**, i cila kuadron me Aktrakordin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë 711 “Tarifa administrative dhe rregullatore” paraqitet në bilancin e 2021 në **vlerën 1,013,132 lekë**, e cila përfshin (*tarifë dokumentesh në vlerën 173,800 lekë, dhe Taksë pastrimi në vlerën 839,332 lekë*) i cila kuadron me Aktrakordin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë 7115 “Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime” paraqitet në bilancin e 2021 në **vlerën 7,945 lekë**, e cila kuadron me Aktrakordin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë 7204 “Tarifa administrative dhe rregullatore” paraqitet në bilancin e 2021 në **vlerën 1,244,086 lekë**, e cila përfshin (*taksë regjistrimi automjetesh në vlerën 320,686 lekë, dhe Tatim mbi të ardhurat personale në vlerën 923,400 lekë*) i cila kuadron me Aktrakordin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë 7207 “Sponsorizime të brendshme” paraqitet në bilancin e 2021 në **vlerën 311,400 lekë**, e cila kuadron me Aktrakordin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Analiza e shpenzimeve në vitin 2021 , të cilat në total janë në vlerën 88,369,327 lekë paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë 600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’ për vitin 2021, paraqitet në bilanc në vlerën 41,958,324 lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin është në vlerën 41,958,324 lekë, diferenca nuk ka.

Gjendja e llogarisë 601 ‘Kontribute për sigurime’ për vitin 2021, paraqitet në bilanc në vlerën 6,963,571 lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin është në vlerën 6,963,571 lekë , diferenca nuk ka.

Gjendja e llogarisë 602 “Blerje mallra e shërbime” paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 12,395,401 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 12,395,401 lekë , diferenca nuk ka.

Gjendja e llogarisë së fondeve 604 “Transferime korente te brendshme” paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 2,600,000 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 2,600,000 lekë, diferenca nuk ka.

Gjendja e llogarisë së fondeve 606 “Transferime per Buxhetet familjare e Individe” paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 14,299,520 lekë, e cila rakordon me aktrakordin me Thesarin.

Për vitin 2021 totali i te ardhurave në vlerë është 123,179,883 lekë dhe totali shpenzimeve është 88,369,327 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 34,810,556 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

### Pasqyra e flukseve monetare (F3)

Pasqyra e Flukseve Monetare, paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjendjen më datë 31.12.2021.

Nr Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportues	Periudha Paraardhëse
(b)	(c)	(1)	(2)
I	Veprimtaritë e shfrytëzimit	39,280,300	10,415,096
II	Veprimtaritë e investimeve	4,140,441	7,200,939
III	Transferta e te tjera	-4,188,456	-8,747,575
VI	Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor	<b>41,194,373</b>	<b>29,503,586</b>

Nga kontrollat e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2021, e paraqitur në këtë pasqyrë rezulton në shumën 41,194,373 lekë dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" e cila paraqitet në shumën 41,194,373 lekë.

Nga kontrollat e kryera rezultoi se totali i Aktiveve Neto/Fondeve neto të evidentuara në pasqyrën financiare të pozicionit financiare është e barabartë me totalin e Fondeve të veta të evidentuara në pasqyrën financiare të ndryshimeve në Aktivet neto/ Fonde neto e cila më datë 31.12.2021, rezulton në shumën 321,970,883 lekë.

Për vitin 2021, numri i punonjësve është miratuar me vendimi të Këshilli të Bashkisë në total 80 punonjës nga të cilët 3 drejtues, 28 specialistë dhe 59 teknik, nëpunës të thjeshtë dhe punëtorë, me fond page gjithsej 41,958,324 lekë.

*Për sa më sipër mbahet ky akt konstatimi me Z.N. me detyrë Përgjegjës i Financës, për periudhën objekt auditimi.*

#### **2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlerë të lartë dhe të vogël, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021.**

Nga auditimi i procedurave të zhvilluara në Bashkinë Pustec për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, rezulton se fondi gjithsej i planifikuar për kryerjen e shpenzimeve për investime/shërbime dhe blerje nga të ardhurat e bashkisë, grandet pa kushtëzuar dhe grandet specifike në shumën 467,504 mijë lekë, nga e cila:

- a- Procedura me vlera të larta, gjithsej janë 3 procedura me fond prej 464,433 mijë lekë, ku vlera prej 460,933 mijë lekë janë grande specifike të alokuar nga MIE (Agjencia Kombëtare e Ujësjellës kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve) dhe vlera 3,499 mijë lekë janë të ardhurat e vetë bashkisë.
- b- Procedura me vlera të vogla, gjithsej 13 procedura me fond limit 3,071 mijë lekë, me të ardhurat e vetë bashkisë.

Grupi i auditimit të KLSH nisur nga vlera e materialitetit të llogaritur dhe numër i ulët i procedurave të zhvilluara, ku vetëm një procedurë me vlerë të lartë zë 98% të fondit të prokuruar auditoi të **3 procedura** ose 100% të fondeve, si dhe **5 procedura** me vlerë të ulët me fond limit 2,460 mijë lekë ose 80% të fondeve të prokuruar, nga ku rezulton se:

##### ▪ **Në auditimin e procedurave me vlerë të vogël.**

Për vitin 2021 nga Bashkia Pustec janë realizuar gjithsej 13 procedura me fond limit 3,071 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 2,574 mijë lekë me një diferencë nga fondi për vlerën 497 mijë lekë. Të gjitha procedurat janë miratuara në buxhetin e bashkisë për vitin 2021. (Të dhënat sipas Aneksit 4.1 bashkëlidhur Raport Auditimit).

Në totalin e procedurave, rezulton se 5 procedura me fond limit 2,460 mijë lekë ose 84% e fondit janë zhvilluar me mjete elektronikë. Ndërsa 5 procedura nuk janë zhvilluar pa mjete elektronike, pasi janë nën vlerën 100 mijë lekë.

Nga auditimi, u konstatua se:

- Në një procedurë, Komisioni i Prokurimit të blerje me Vlera të Vogla (këtu e vijim KBVV) kishte bërë gabim vlerësimin e OE Fitues, pasi OE nuk plotëson kriterin mbi pagesën e energjisë elektrike.
- Në asnjë rast të përdorimit të formës së prokurimit “Blerje me vlerë të vogël”, fondi limit nuk ka qenë mbi 1,000,000 lekë pa TVSH, pra mbi kufirin monetar të përcaktuar me vendimin e VKM nr. nr. 285, datë 19.5.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe udhëzimin e APP nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” të ndryshuar.
- Nga KPBBV është zbatuar limiti i përcaktuar për prokurimet me vlera të vogla i cili nuk është tejkaluar në asnjë rast.
- Miratimi i kërkesës për prokurim në të gjitha rastet janë miratuar nga Nëpunësi i Autorizuar i AK.
- Shpallja elektronike në sistem e procedurës, është realizuar në kohën e përcaktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi. Anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël në të gjitha rastet, pasi kanë krijuar në sistem dosjen e tenderit, u janë drejtuar nëpërmjet ftesës për ofertë (sipas formularit nr. 3), 5 (pesë) operatorëve ekonomikë për një periudhë 1-2 ditë nga nxjerrja e urdhrat të prokurimit.
- Në të gjitha rastet nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, është mbajtur procesverbal për shpalljen e OE fitues, mbi bazën e ofertës më të ulët të shpallur nga sistemi. (Në të gjitha rastet ishin printuar ofertat e gjeneruara nga sistemi).
- Në të gjitha rastet OE fitues është njoftuar nëpërmjet sistemit elektronik. Në rastet e tërheqjes së ofertave të vendeve të para është dokumentuar me shkresat zyrtare nga operatorët ose printimit nga sistemi i emali-ve të kryera nga AK (njoftimi) dhe OE (përgjigja).
- Në dosjen e prokurimeve me vlera të vogla ndodheshin Faturat Tatimore Shitje, të njëjta me vlerën e ofertuar si dhe me urdhër shpenzimet përkatëse.
- Në të gjitha rastet AK ka bërë përlllogaritjen e fondit limit, duke u bazuar në ofertat e marra në treg dhe të pasqyruara në dokumentin e hartuar për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.
- Për gjithë periudhën objekt auditimi për procedurat me blerje të vogla, është bërë inventarizimi i dosjeve dhe arkivimi, sipas Udhëzimit nr. 3 datë 03.04.2014, “Për zhvillimin e Prokurimeve me vlerë të vogël në sistem të prokurimit elektronik për autoritetin kontraktor dhe operatorët ekonomik “.
- Për të gjitha rastet e blerjeve si për shërbimet dhe mallrat është kryer procesi i marrjes në dorëzim të mallit dhe shërbimit nga komisioni i ngritur për çdo rast nga Nëpunësi Autorizues.

► **Titulli i gjetjes 1:** *Mos vlerësim i saktë i OE fitues në procedurën me objekt “Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi të ndryshme”.*

**Situata:**

Me shkresën nr. 1316, datë 14.10.2021 të Specialistit të Shërbimeve z. V.M. është kërkuar zhvillimi i procedurës me objekt “Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi të ndryshme”, miratuar me vendim nr. 73, datë 24.12.2020.

Me urdhër nr. 166, datë 15.10.2021 (prot bashkia Pustec nr. 1316/1), të titullarit të AK është ngritur komisioni i blerjeve me vlera të vogla: V.S., L.M. dhe D.S..

Me PV nr. 1316/2, datë 21.10.2021, KBVV ka hartuar fondin limit duke testuar tregun me tre oferta dhe përcaktuar fondin prej 684,405 lekë pa TVSh. Nga ana e titullarit të AK është nxjerrë UP nr. 8, datë 01.11.2021 për zhvillimin e procedurës me fond limit 684,405 lekë pa TVSh.

Me PV nr. 1316/7, datë 05.11.2021 është bërë hapja e procedurës, ku është konstatuar se kanë marrë pjesë 10 OE. Nga ana e KBVV me PV nr. 1316/8, datë 05.11.2021 është bërë vlerësimi i dokumentacionit teknik e ligjore, duke kualifikuar në vend të parë subjektin L.S. shpk me ofertë 536,000 lekë me të leverdishme se OE e tjerë në garë.

Me PV datë 8.11.2021, nga KBVV është bërë kalimi nga OE i renditur i pari për OE e dytë, pasi shoqëri L.S. shpk nuk është paraqitur, duke bërë tërheqje edhe nga sistemi.

Me PV nr. 1316/9 datë 09.11.2021, KBVV ka shpallur fitues shoqërinë S.A. shpk me ofertë 599,600 lekë, i renditur i dyti në garë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të OE fitues, konstatohet se ky OE nuk plotëson kriterin mbi pagesën e energjisë elektrike, pasi sipas të dhënave të dosjes dhe sistemit SPE procedura do zhvillohet me datë 05.11.2021, ndërsa subjekti ka paraqitur vërtetim mbi pagesën e energjisë nr. 323, datë 7.10.2021 në të cilën thuhet se subjekti nuk ka detyrimi, **por pa përfshirë faturën e muajt shtator 2021**. Pra vërtetimi duhet të përfshinë dhe muaj shtator.

Vlerësimi i këtij OE si fitues është i parregullt dhe KBVV duhet të vijonte me OE i renditur i treti dhe nëse dhe ky do kish mangësi me OE në radhë.

#### **Kriteri:**

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me neni 76 pika 1 shkronja (b) dhe neni 56 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, Udhëzimi i APP nr. nr. 3, datë 08.01.2018 Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlera të vogla dhe zhvillimi me mjete elektronike”, pika 2 dhe me Udhëzimi e MF nr.57 datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

#### **Ndikimi/Efekti:**

Mos vlerësimi i drejtë i dokumentacionit të OE pjesëmarrës, çon në keqadministrim të fondeve të prokuruar.

#### **Shkaku:**

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë nga *anëtarët e KBVV: V.S. me detyrë Specialist i Procedurave, L.M. me detyrë Jurist në bashki dhe D.S. me detyrë specialist arkive.*

#### **Rëndësia: I mesëm**

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH në procedurën me objekt “*Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi të ndryshme*”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për vlerësim jo të drejtë të procedurës, si dhe të marrë masa që në të ardhmen të analizojë raportet e komisionit të vlerësimit të OE fitues që të jenë në përputhje me kuadrin ligjorë dhe në plotësim të kriteve të DST të miratuara nga AK.

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 884/8, datë 6.01.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:*

#### **Pretendim i subjektit:**

Lidhur me gjetjet e cilësuar gabim mënyra e vlerësimit nga ana e KVO-së bazuar në kriterin e pagesës së energjisë elektrike, ju informojmë se nga ana e KVVBB është proceduar në mënyrën e tillë duke ju referuar vërtetimit të lëshuar nga institucioni përgjegjës OSHE për pasqyrimin e të dhënave individuale të OE nëse rezulton debitor

me OSHE-në. Nisur nga të dhënat e vërtetimit faktohet se në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit OE rezulton me detyrime të shlyera (zero), në muajin Tetor fakt ky që vërteton likuidimin e muajit Shtator.

**Qëndrimi i grupit të KLSH:**

Nga subjekti audituar nuk është paraqitur asnjë agrumet shtesë nga ato të paraqitura në fazën e akt-konstatimeve, për të cilat grupi i KLSH ka argumentuar se nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë.

▪ **Në auditimin e procedurave me vlerë të lartë:**

*-Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.*

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/ shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, sipas Aneks 4.2 bashkëlidhur Projektraporti Auditimit.

*-Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetuara.*

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 – 31.12.2021 nga subjekti Bashkia Pustec, janë zhvilluar gjithsej **3 procedura** prokurime me vlera të larta me fond limit 464,433 mijë lekë, të dhënat e të cilit paraqiten në pasqyrën si vijon:

Në 000/lekë

EMËRTIMI	Periudha 01.01.2021 - 31.12.2021	
	Vlerë kont lidhura 000/lekë	Në % ndaj fondit
<b>Fondet prokuruar gjithsej</b>	<b>1,160,771</b>	
<i>Nga të cilat</i>		
- Në fushën e ndërtimit	456,525	98%
-Në fushën e shërbimeve/ blerjeve	7,907	2%

Nga të dhënat e marra nga Sektori i Financës Bashkia Pustec, nga vlera gjithsej e kontratave të lidhura prej 464,433 mijë lekë, janë me financim me grande specifike 460,933 mijë lekë ose 98%, me të ardhurat e Bashkisë Pustec në vlerën 3,499 mijë lekë ose 2%.

Grupi i auditimit të KLSH, nisur nga numri i ulët i procedurave të zhvilluara, gjithsej 3 procedura, i auditoi ato të plota nga ku rezultojn se:

1- **Në procedurën me objekt:** “Mbikëqyrje furnizim me ujë për Bashkinë Pustec”.

Procedura me objekt “Mbikëqyrje furnizim me ujë për Bashkinë Pustec”		
1. Urdhër Prokurimi nr. nr. 2, datë 26.01.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 2, datë 26.01.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Oferta Urdhër nr. 11, dt. 26.01.2021
2. Lloji i Procedurës	S.M.	V.A.

Procedura me objekt "Mbikëqyrje furnizim me ujë për Bashkinë Pustec"		
"Kërkese propozim"	I.M. F.S.	P.D. P.A.
<b>5. Fondi Limit (pa TVSH)</b> 4,408,426 lekë <b>REF -84304-01-19-2021</b>	<b>6. Oferta fituese (pa TVSH)</b> EO Z&K.ShPK me ofertë pa TVSh në shumën 3,603,617.	<b>7. Diferenca me fondin limit(pa TVSH me vlerë 805 mijë lekë ose 18.2 %</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 15.02.2021	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit (MIE)	<b>10. OE</b> Pjesëmarrës në tender <b>4</b> OE/BOE a) Skualifikuar 1 OE/BOE b) Kualifikuar 3 OE

Me PV datë 3.02.2021 nga AK Bashkia Pustec janë ftuar të marrin pjesë 5 OE, konkretisht Z.&C., Z.K., I.M. dhe D. si dhe janë vendosur kriteret kualifikuese. Me PV datë 15.02.2021 është bërë hapja e procedurës, ku evidentohet se kanë marrë pjesë 4 OE, konkretisht:

Nr.	OE pjesëmarrjes	Nipti	Oferta ekonomik	Kualifikuar/ Skualifikuar
1	E.	KK	3,973,442	Kualifikuar
2	I.D.	KA	3,688,307	Kualifikuar
3.	M., S.& L.	L/LB	3,688,307	Skualifikuar
4.	Z.&C.	KD	3,603,617	Kualifikuar

KVO pas vlerësimit të dokumentacionit teknik/ligjorë dhe vlerësimit të ofertave nga 4 OE pjesëmarrës ka skualifikuar 1 OE dhe kualifikuar 3 OE.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OEZ.&C.shpk, se oferta e paraqitur me një vlerë **3,603,617 leke pa TVSh**, është identifikuar si oferta e suksesshme në krahasim me OE të mbetur në garë.

Formularë njoftim fituesi, datë 3.3.2021.

Me shkresën nr. 112/7, datë 4.3.2021 është kërkuar OE depozitim i dokumentacionit.

Shpallur në buletin e APP nr. 34, datë 8.4.2021.

Formulari i publikimit m shkresën nr. 112/9, datë 6.4.2021.

Formulari i njoftimit të kontratës nr. 112/10, datë 6.4.2021, adresuar APP.

Ankesa: JO

Raporti përmbledhës është mbajtur me date 3.3.2021 (nr.prot 112/5), raport i cili është konfirmuar dhe nga Titullari i AK.

Midis bashkimit të OE Z.&C.ShPK dhe AK është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 112/8, datë 2.4.2021 për "Mbikëqyrjen e punimeve me objekt furnizim me ujë i Bashkisë Prrenjas" me vlerën **3,603,617** lekë pa TVSh. me afat punimesh 18 muaj nga datë e nënshkrimit të kontratës.

Referuar kundërshtive të subjektit të bërë në fazën e akt konstatimeve, procedura është në përputhje me dispozitat e LPP, ku hollësisht trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit.

## 2- Procedura me objekt: "Blerje karburant per mjetet + ngrohje shkolle, viti 2021".

Procedura me objekt "Blerje karburant per mjetet + ngrohje shkolle, viti 2021"		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. nr. 22/1, datë 24.2.2021	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve</b> nr. 22/1, datë 24.2.2021	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 22/2, dt. 2.3.2021

Procedura me objekt "Blerje karburant per mjetet + ngrohje shkolle, viti 2021"		
2. Lloji i Procedurës "Kërkese propozim (MK)"	V.S. I.M. L.M.	Q.TH J.N. A.J.
5. Fondi Limit (pa TVSH) 2,766,221 lekë REF -89950-03-12-2021	6. Oferta fituese (pa TVSH) OE M. ShPK me marzhë fitimi 2% me kontratë nr. 1656/5 dt. 29.6.2020, me afat 12 muaj nga data e lidhjes	7. Diferenca me fondin limit(pa TVSH)
8. Data e hapjes së tenderit Datë 29.3.2021	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. OE Pjesëmarrës në tender 1OE/BOE a) Skualifikuar 0 OE/BOE b) Kualifikuar 1 OE

► **Titulli i gjetjes 2:** *Mos argumenti i fondit limit për blerje karburanti.*

**Situata:**

Me urdhër nr. 22, datë 19.2.2021 Kryetari i Bashkisë Pustec ka urdhëruar përcaktimin e limimit të karburantit për mjetet e bashkisë për vitin 2021, ku thuhet se:

- a- Mjeti me targë AA800CM ka limit 350 litra/muaj.
- b- Mjeti me targë AB 188 AC me limit 320 litra/muaj.
- c- Dy mjete pastrim ime targë (AA 5859 A dhe AA229GR) me limit 300 litra/muaj.
- d- Mjeti kompaktor për transport mbetjesh në venddepozitimit në Maliq me limit 2500 litra/viti.
- e- Mjet gjermimi Eskavator me limit 6000 litra/viti.
- f- Mjet zjarfikëse me limit 2000 litra/viti.
- g- Karburanti për kaldajën e shkollës së mesme për sasinë 4256 litra/viti.

Gjithsej sasia vjetore e parashikuar është 26396 litra/viti.

Me PV nr. 235/4, datë 01.3.2021 NJP ka bërë përlllogaritjen e fontit limit referuar çmimit të kontratave të mëparshme (nr. 349, datë 23.11.2020), me çmim 104.797 lekë/litri.

Kështu vlera e fondit limit të përcaktuar referuar sa sipër është 2,766,221 lekë pa TVSh (104.797 lekë/litri \* 26396 litra).

Nga krahasimi i të dhënave me regjistrin e mjeteve sipas pasqyrave të bilancit si dhe informacionit të marrë nga specialistja e mjedisit znj. A.J. me detyrë specialiste, rezulton se në bashki nuk ka mjet kompaktor për transport mbetjesh në venddepozitimit sanitar në Maliq për të cilën është planifikuar një sasi vjetore karburanti prej 2500 litra/viti.

Nga dokumentacioni shoqërues, konstatohet se bashkia nuk e disponon mjetin tip kompaktor. Në këto kushte kjo sasi karburanti është planifikuar padrejtësisht për vlerën 261,750 lekë/viti, veprime me mos efektivitet të fondeve publike, për të cilën bashkia nuk duhet të beje lëvrimin e tyre sipas kontratës fillestare.

Gjithashtu, vlera e karburantit e përlllogaritur dhe programuar për tu prokuruar nuk është e argumentuar me analizë të hollësishme referuar sasisë së karburantit gazoil/benzinë, gjendje në magazinë, me analizë mbi numrin e mjeteve apo agregateve (motogenerator, kaldaja, etj.) në qarkullim e gjendje pune inventar i bashkisë Pustec, apo gjendje inventar në njësitë shpenzuese vartësi e bashkisë, mbi sasinë e kilometrave të përshkruara nga mjetet në qarkullim dhe orë/pune të kryera nga agregatet për periudhën raportuese paraardhës, mbi normativën e konsumit litra/100 km për mjetet dhe orë/pune për agregatet e miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë, mbi gjendjen teknike të çdo tip mjeti e agregati, mbi viti prodhimit të mjetit e agregatit.

**Kriteri:**

Në kundërshtim me nenin 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, geramat (a); (b) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe janë në mospërputhje me dispozitën e parashikuar nga VKM nr. 914, datë 27.12.2014 "Për miratimin e

*rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu II “Rregullat e Përgjithshme të prokurimit” neni 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës”.*

**Ndikimi/Efektiviteti:**

Mos përcaktimi i saktë i sasisë së karburantit sipas nevojave të Bashkisë Pustec, janë veprime në keq menaxhim të fondeve për blerjen e këtij malli, pasi kërkohet sasi të paargumentuara.

**Shkaku:**

Mos zbatimi i legjislacionit nga strukturat përgjegjëse *NJP, respektivisht: V.M.me detyrë Specialit Sektori Shërbimeve.*

**Rëndësia: E mesme**

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa për ngritjen e një strukturë të veçantë për planifikimin vjetor të nevojave për karburant, bazuar në numrin e mjeteve, gjendjet teknike të tyre, normativave të harxhimit sipas katalogut ose me procesverbal argumentimi, volumit të punës që kryhen në vitin paraardhës, sasi e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak.

- **Zhvillimi i procedurës:**

Me PV nr. 235/11, datë 29.3.2021 është bërë hapja dhe vlerësimi i procedurës. Sipas këtij PV në këtë procedurë ka marrë pjesë vetëm një shoqëria M. shpk.

Me shkresën nr. 235/13, datë 7.4.2021 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga titullari i AK mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve, si më poshtë:

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara **shoqëria M. shpk me marzhë fitim 2%**;

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqëria M. shpk, se oferta me marzhë fitimi të shprehur në përqindje: 2% është kualifikuar si oferta me e suksesshme.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **30.3.2021**

Ankesa: ka ose jo: **JO**

Midis shoqërisë M.shpk dhe AK është hartuar dhe firmosur draft marrëveshje kuadër nr. 235/15, datë 23.4.2021 për “*blerje karburanti viti 2021 (naftë)*” me marzhë fitimi 2% me afat 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 884/8, datë 6.01.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:*

**Pretendim i subjektit:**

Lidhur me gjetjet, ju informojmë se nga ana e KVO është proceduar në mënyrën të tillë duke ju referuar vërtetimit të lëshuar nga institucioni përgjegjës OSHE për pasqyrimin e të dhënave individuale të Operatorit Ekonomik nëse rezulton debitor me OSHE-në. Nisur nga të dhënat e vërtetimit nr. 34 datë:01.02.2021 faktehet se në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit OE rezulton me detyrime të shlyera (zero), në muajin Shkurt fakt ky që vërteton likuidimin e muajit Janar (bashkëlidhur fatura e muajit Janar 2021).

Referuar pikës (b) në vlerësimi i procedurës konkretisht kriteri i vendosur në DST në pika 2.3.3 , ku shoqëria duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë vërtetuar me formën e disponimit sipas Kodit Civil, sqarojmë se nga shoqëria është deklaruar dokumentacioni sipas kërkesave të DST, i cili është bashkëlidhur kundërshtive.



**Qëndrimi i grupit të KLSH:**

Merret në konsideratë shpjegimet e subjektit, kjo referuar dhe dokumentacionit bashkëlidhur.

**3- Në procedurën me objekt: “Furnizimi me ujë për Bashkinë Pustec”.**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec”.</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 14, datë 30.12.2020	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Nr. 14, datë 30.12.2020	<b>4. Komisioni Vlerësimit të Ofertave nr. 1579/3, datë 30.12.2020</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> <b>T. Hapur”,</b>	F.S. V.A. L.M. i ndryshuar me S.M. Janë shtuar dy specialist L.C. H.G.	J.N. V.S. N.K. E.B. I.M.
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 456,525,537 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> G.SH ShPK me vlerën e ofertës 456,410,511 lekë pa TVSh, me afat deri 18muaj nga data e fillimit të punimeve.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 115lekë pa TVSh OSE 0.025%.
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 01.02.2021 REF -83440-12-30-2020	<b>9. Burimi Financimit</b> MIE	<b>10. Operatorë Ekonomike 2:</b> a-Skualifikuar 1 OE A. b- Kualifikuar 1OE G.SH
<b>11. Ankimime</b>	12. Përgjigje Ankesës nga AK	<b>13. Përgjigje KPP</b>
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 149/4, Datë 6.4.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b> <b>456,410,511</b> lekë	

Me shkresën nr. 3127, datë 9.12.2020 të MIE (Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve) është miratuar fondi në vlerën 540,995,988 lekë me TVSh, ku vlera 109,257,220 lekë do financohet në vitin 2021, nga e cila supervizim në shumën 1,058,022 lekë. Ndërsa pjesa tjetër do financohet deri në fund të vitit 2024.

Me shkresën nr. 1579, datë 29.12.2020 të Zyrës së PZHT z. S.Q. është paraqitur kërkesa për zhvillimin e procedurës së prokurimit me fond limit 540,995,988 lekë me TVSh me objekt “Furnizimi me ujë për Bashkinë Pustec”.

Projektpreventivi është hartuar nga studio e projektimit Z.C. shpk me përfaqësues ligjorë z. A.P. me licensë nr. 0433/18.

Oponenca teknike është miratuar nga Instituti i Ndërtimit (Drejt z. A.SH.) me shkresën nr. 2841/2, datë 20.01.2021, sipas kërkesë së bashkisë nr. 1457, datë 9.12.2020 është dërguar e miratuar oponenca teknike nga grupi i punës A.J. me profil ing. Higroteknik, V.P. me profil ing. Konstruktor dhe B.GJ. me profil ing. Mjedisi.

Vlera e projektit të hartuar paraqitet në vlerën 540,995,988 lekë me TVSh.

► **Titulli i gjetjes 3:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në emërimin e anëtarëve të NJP dhe KVO.

**Situata:**

*Urdhër prokurimi dhe anëtarët e NJP*

Nga ana e titullarit të AK Bashkia Pustec, janë hartuar dy urdhra prokurimi me të njëjtin numër protokoll (nr. 14, datë 30.12.2020), por me shkresa të ndryshme, si vijon:

- a- Urdhri i prokurimi me shkresën nr. 1579/1, datë 30.12.2020, ku është emëruar si anëtarë të NJP: F.S. me detyrë juriste (e jashtme me aktmarrëveshje datë 30.12.2020) dhe përgjegjëse procedurës, z. L.M. me detyrë Jurist bashkia Pustec dhe V.A. me detyrë inxhinier Bashkia Pustec.
- b- Urdhri i prokurimi me shkresën nr. 1579/2, datë 30.12.2020 ku kemi ndryshim të anëtarëve të NJP, respektivisht: F.S. me detyrë juriste (e jashtme me aktmarrëveshje) dhe përgjegjëse procedurës, znj. S.M me detyrë Specialiste e Burimeve Njerëzore e cila ka zëvendësuar z. L.M. **pa asnjë argument shtesë**, z. V.A. me detyrë inxhinier Bashkia Pustec, është shtuar zj. L.C. me profesion inxhinier Gjeodet (specialiste e jashtme sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020 të lidhur midis Bashkisë Pustec dhe zj. L.C.) dhe zj. H.G. me profesion inxhinier Mjedisi me profil trajtim të ujërave (specialiste e jashtme sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020 të lidhur midis bashkisë Pustec.

*Nga auditimi konstatohet se:*

Mos argumentimi specialist i jashtëm me profil jurist (i panevojshëm), **pasi vetë institucioni ka jurist.**

Është bërë zëvendësimi i specialistit L.M. me S.M., **pa asnjë agrumet ligjor për zëvendësimin e tij.**

Në sistemin e SEP të APP nga katër e të NJP, rezulton se janë tre anëtarë (F.S., L.M. dhe V.A.), duke mos **bërë ndryshimet si të anëtarit të ndryshuar po ashtu dhe të shtesa me anëtarë të rijnë.**

*-Në anëtarët e KVO, u konstatua se:*

Me urdhër nr. 1579/3, datë 30.12.2020 në të cilën janë emëruar anëtarët e KVO, respektivisht: z. J.N. me detyrë Zv/Kryetar (jurist), z. V.S. me detyrë specialist prokurimesh (ekonomist), z. I.M. me detyrë ish- ekonomist sektori Financës, zj. N.K. specialiste e jashtme me arsim të lartë (shkenca politike), sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020 dhe z. E.B. specialist i jashtëm me profil ing. Elektrik, sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020.

Nga auditimi konstatohet se specialistët e jashtëm nuk janë emëruar punonjës të profilit dhe të nevojshëm për llojin e procedurës që zhvillohet, pasi njëri është më profil inxhinier elektrik dhe tjetri shkenca politike, ndërkohë që duheshin minimumi inxhinier ndërtime dhe hidroteknik, kjo referuar tipologjisë së procedurës së zhvilluar, rëndësisë dhe vlerës së prokuruar.

**Kriteri:**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pika 3.3 të Udhëzimit nr. 7, datë 30.7.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, si dhe nenet 56-*Titullari i AK ose zyrtari i autorizuar* dhe 57- *Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit* të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor të anëtarëve të NJP/KVO me profil (arsim) sipas tipologjisë së procedurës dhe emërimi i anëtarëve të panevojshëm kur vetë institucioni ka punonjës sipas profilit të cilat janë marrë, çojnë në mangësi në zhvillimin e procedurës, si në aplikimin e kriterëve po ashtu dhe vlerësimin e OE fitues dhe përdorim me efektivitet të fondeve.

**Shkaku:**

Veprime në kundërshtim me dispozitat e LPP, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: ***Titullarin e AK z. P.K.dhe znj. F.S. si përgjegjëse e dosjes së prokurimit.***

**Rëndësia: E lartë**

**Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari i Bashkisë Pustec, në cilësinë e titullarit të AK të marrë masa që në të ardhmen në mungesë të personelit të kualifikuar të argumentojë marrjen në komision si anëtarë të NJP/KVO të specialistëve të jashtëm me profil sipas tipologjisë së procedurës që zhvillohet dhe jo të çfarëdolloj. Gjithashtu në rastet e largimit të anëtarëve të komisionet e NJP/KVO të argumentohet arsyeja dhe të kryhet sipas afateve ligjore pa filluar procedura e aplikimit të kriteve ose vlerësimit të dokumentacionit të OE pjesëmarrës.

Nga subjekti nuk është paraqitur kundërshti në fazën e Projekt Raport Auditimit.

► **Titulli i gjetjes 4:** *Mos aplikimi i lejes së ndërtimit të zbatimit e kontratave të investimeve dhe lejeve nga zonat e mbrojtura.*

#### **Situata:**

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës, konstatohet se lidhja dhe zbatimi i kontratës është bërë pa marrë miratim nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, pasi zona e Bashkisë Pustec në të cilën do shtrihet investimi hyn në zonat e mbrojtura si PK “Prespë”, shpallur me VKM nr. 80, datë 18.2.199, kategori e II e zonave të mbrojtura, sipas IUCN-së dhe se punimet kanë vijuar pa marrë lejen e ndërtimit nga Bashkia Pustec, duke u mjaftuar vetëm me lejen e zhvillimit nr. 5, datë 26.5.2021.

Sipas dokumentacionit për dhënien e lejes së zhvillimit me nr.AN210420210102, Bashkia Pustec i është drejtuar me shkresën nr. 536, datë 21.4.2021 Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, për tu pajisur me leje për shfrytëzimi e burimeve ujore në zbatim të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” i ndryshuar dhe VKM nr. 550, datë 15.7.2020 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin në parim për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujorë, e lejes/autorizimit për përdorimin e burimit ujor, veprimtari ndërtimore në brigjet, veprimtari në shtratin e burimit ujorë, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura të ndotura të dokumenteve shoqërues të procedurës së shqyrtimit të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”.

Në përgjigje të shkresës së bashkisë, rezulton se AMBU i kthen përgjigje se Bashkia Pustec duhet të aplikohet në sistemin e-Albania për marrjen e lejes së burimeve ujore, **gjë e cila nuk rezulton të jetë i dokumentuar.**

Nga sistemi e-Albania, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (Agjencia Kombëtare e Mjedisit), në përgjigje të Bashkisë Pustec mbi aplikimin AN210420210102, në sistemin e-leje, informon se në zbatim të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar (shtojca I dhe II), **duhet t’i nënshtrohet procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis.**

Me vendim të komisionit nr. 43, datë 14.9.2021 të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (Agjencia e Vlerësimit të Impaktit dhe Licensimit), në faqen 3 të tij thuhet se duke qenë se zona është në zonat e mbrojtura, duhet që Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të pajisë me leje përkatëse bashkinë për zbatimin e projektit, **leje e cila nuk është lëshuar si gjatë fazës së zhvillimit të procedurës po ashtu dhe në fazën e zbatimit të projektit.**

#### **Kriteri:**

Veprimet e mësipërm janë në kundërshtim me nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe neneve 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, ligjin nr. 81/2017, datë 4.5.2017 “Për zonat e mbrojtura” i ndryshuar, ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në

mjedis” i ndryshuar (shtojca I dhe II), ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” i ndryshuar dhe VKM nr. 550, datë 15.7.2020 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin në parim për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujorë, e lejes/autorizimit për përdorimin e burimit ujor, veprimtari ndërtimore në brigjet, veprimtari në shtratin e burimit ujorë, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura të ndotura të dokumenteve shoqërues të procedurës së shqyrtimit të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”.

**Ndikimi/Efekti:**

Zhvillimi i procedurave pa leje ndërtimi infrastrukturore dhe leje përkatëse nga zonat e mbrojtura, bën që projekti të jetë në kundërshtim me dispozitat ligjore të planifikim zhvillim territorit dhe mjedisit, duke mos marrë në konsideratë pasojat që mund të vijnë nga zbatimi në praktik i sajë.

**Shkaku:**

Neglizhencë nga ana e drejtuesve të Bashkisë Pustec në zbatimin e dispozitave ligjore, **duke ngarkuar me përgjegjësi: Titullarin e AK z. P.K.dhe z. S.Q.me detyrë ish specialist PZHT.**

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec të mos lidhë kontrata me subjektet sipërmarrëse dhe fituese të procedurave të prokurimit për investime pa marrë më parë lejen e ndërtimit të infrastrukturës nga Sektori i Planifikim Zhvillim Territorit, si dhe pa u pajisur me Nipt sekondarë.

Gjithashtu duke qenë se Bashkia Pustec bën pjesë në zonat e mbrojtura, përpara hapjes së ndonjë procedure prokurimi në investime e cila prek këto zona të merret paraprakisht miratimi nga instancat përkatëse për zhvillimin ose jo të zonës ku do shtrohet projekti.

► **Titulli i gjetjes 5:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kriterëve të pjesëmarrjes kundrejt operatorëve ekonomikë, duke përdorur kriterë jo sipas tipologjisë së procedurës dhe në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP, kriterë të ekzagjeruar, të panevojshme për realizimin e objektivit të prokurimit dhe të pa-argumentuara.

**Situata:**

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar **kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, konkretisht:**

a- **Në pikën 2.4 të DST** janë kërkuar kategori licencash jo të argumentuara me procedurën e zhvilluar dhe zërat e preventivit, konkretisht: NP 1 – D (punime gërmimi në tokë); NP 4 - E; (Rrugë autostrada, ura, mbikalime); NS 9-D; (Punime strukturore speciale); NS 18 D; (Punime topogjeodezike); NS - 19 D;(sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë) dhe N.S 20 D; (Shpime gjeologo –inxhinierike, puse shpimi për ujë sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI).

Gjithashtu niveli i kategori (E,D) sipas kategorive të licensave nuk janë të argumentuara dhe volumi i punimeve që përfaqësojnë këto zëra nuk përputhet me volumin e punimeve të këtyre kategorive, jo në përputhje me VKM nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar.

b- **Nuk argumentohet kërkesa ku sipas pikës 2.5 të DST** është kërkuar linecës me kod III.2.B;I.2.A;III.2.A (1+2), pasi në referim të pikës (a) të nenit 1 të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin në mjedis”, ku qëllimi është të sigurojë nivel të lartë të ndikimit në mjedis. Këto janë ezauruar gjatë fazës së hartimit të projektit dhe specifikimeve dhe relacioneve teknike.

Licensimit tipi C me kod III.I.A për Stacion transferimi mbetje jo të rrezikshme nuk është mirëargumentuar, pasi shumë OE do penalizoheshin vetëm për këtë kriter dhe mund të disponojë kontrata me subjektet e tjera që zotërojnë këtë lloj licensë, në referencë të ligjit nr. 52/2020 “për disa ndryshime në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejen mjedisore” i ndryshuar.

c- **Në pikën 2.8 të DST** është kërkuar stafi teknik; Inxhinier Ndërtimi 2 (dy); Inxhinier Ndërtimi 1 (nje) (profili transport); Inxhinier Ndërtimi 1 (nje) (profili strukturist); Inxhinier Mjedisi 1 (nje). Numër i lartë i inxhinierëve të kërkuar nuk është mirëargumentuar nisur kjo dhe nga tipologjia e punimeve.

**Kërkesa për inxhinier mjedisi si drejtues teknik në licensën e shoqërisë nuk është argumentuar, pasi në pikën 2.9 të DST** është kërkuar inxhinier mjedisi si staf mbështetës. Gjithashtu nuk është argumentuar dhe fakti që këto duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë për një periudhë 12 mujorë. AK i intereson fakti që këto të jenë në listpagesë dhe të jenë aktiv gjatë fazës së zbatimit të kontratës dhe jo në periudhat e kaluara.

d- **Në pikën 2.10 të DST** është kërkuar që për punonjësit e automakinistët dhe ekskavatoristët duhet të paraqesin kontrata pune të vlefshme, dëshmi drejtimi lëshuar nga institucioni përkatëse si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit. Kërkesa që këto punonjës të jenë në listëpagesat nuk është mirëargumentuar, pasi në rast se mjetet janë me kontratë qiraje vijnë me gjithë drejtues.

e- **Në pikën 1.9 të DST** është kërkuar që OE duhet të ketë në stafin e tij të punësuar (staf mbështetës) poshtë 1 inxhinier topograf, ky është një kriter paargumentuar, pasi janë kërkuar ing. gjeodet 2 nuk është nevojshme.

f- **Në pikën 2.12 të DST** OE duhet të disponojë pjesë të stafit ekspert zjarrfikës të certifikuar (1 person) në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, dëshmuar me kontratën e punës dhe certifikata përkatëse .

#### **Kriteri:**

Me **nenin 46**, të LPP, “kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”, si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 5 përcaktohet: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”..

#### **Ndikimi/Efekti:**

Aplikimi i kriterëve jo mirëargumentuar çojnë në mospjesëmarrjen e OE në garë, uljen e konkurrencës dhe përdorim jo me efikasitet të fondit të prokuruar.

#### **Shkaku:**

Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me **përgjegjësi: F.S., V.A., S.M., L.C. dhe H.G.(Njësia e Prokurimit).**

#### **Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:** Bashkia Pustec (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, duke hartuar kërkesat për kualifikim në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitetit, bazuar në kriteret të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të

barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore. Gjithashtu, kriteret që lidhen me nivelin apo kategorinë e licencave profesionale, disponueshmërinë e numrit të punonjësve, makinerive, mjeteve apo pajisjeve, duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si dhe në çdo rast, ato, duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjrisht dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Nga subjekti nuk është paraqitur kundërshti në fazën e Projekt Raport Auditimit

- **Zhvillimi procedurës.**

Me PV datë 15.2.2021 në prani të anëtarëve të KVO është bërë vlerësimi i procedurës sipas dokumentacionit të OE pjesëmarrës. Hapja e procedurës është bërë me datë 01.02.2021 sipas afateve të përcaktuara në njoftim kontratë.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i OE **G. & SH.** N. JV & N. KN me vlerë oferte **456,410,511 lekë pa TVSh.**
2. Oferta e paraqitur nga **OE A. shpk N.-JN** me ofertë *pa TVSH = 456,508,703 lekë.*

Pas vlerësimit të dokumentacionit teknik/ligjor, KVO ka skualifikuar **OE A. shpk**, për arsyt e mëposhtme.

*OE A. shpk nuk plotëson pikën 2.7 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të DST: “Një punësim mesatar i të paktën 300 personave, për periudhën Janar 2020- Dhjetor 2020 të vërtetuar me....”, pasi referuar vërtetimit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik Nr. T03486051, datë 29.01.2021, për periudhën Janar 2020-Dhjetor 2020 rezulton një punësim mesatar prej 200 (dyqind) punonjësish, pra një numër i pamjaftueshëm.*

*OE A. shpk, nuk plotëson pikën 2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar të DST: “OE duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitet (2019, 2020) sipas....”, KVO konstaton se në vërtetimet e paraqitura nga bashkitë në të cilat ushtron aktivitet ky operator ekonomik nuk përfshihet shlyerja e taksave vendore për vitin 2019, konkretisht për Bashkitë Tiranë, Lezhë dhe Durrës.*

*Shtojca 5 “ Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe realizimin e objektivit sipas grafikut të punimeve”, nuk është paraqitur e plotë sipas formatit të përcaktuar në DST.*

*OE A. shpk nuk plotëson pikën 2.8 të kapacitetit teknik të DST: “OE duhet te ketë ne stafin e tij te punësuar (staf mbështetës).../ I inxhinier mjedisi profil “Trajtim i ujërave”, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar inxhinieri i mjedisit rezulton me profilin energjitike dhe jo trajtim i ujërave.*

*OE A. shpk nuk plotëson pikën 2.8 të kapacitetit teknik të DST: “Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës .../ I NS 16 E; (Ndërtimi i impianteve te ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij)”, pasi në liçensën e paraqitur NZ 3189/16, pika NS 16 E (Ndërtimi i impianteve te ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij) rezulton në kategorinë “B” dhe jo “E”.*

*OE A. shpk, nuk plotëson, asnjë nga kërkesat e përcaktuara në pikët 2.16-2.18 të kapacitetit teknik të kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi nuk është paraqitur asnjë dokumentacion për:*

1. Kontrate furnizimi për pllaka që do të vendosen në objekt sipas preventivit të kontratës.
2. Autorizim/kontrate bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë: Hekur; Pajisje Hidroizoluese; Pompa.
3. Autorizim/kontrate bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë: Matëse uji.
4. Katalogje për mallrat matëse uji OE, referuar Shtojcës 10, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Nga vlerësimi i dokumentacionit ne sistem mbi skualifikimin e shoqërisë A. shpk, **konstatohet se KVO ka vepruar drejt**, pasi nuk plotëson kriteret e mësipërme dhe duhej skualifikuar.

Nga KVO është kualifikuar si ofertë e suksesshme OE i vetëm i mbetur në garë bashkimi i **OE G. & SH.** me ofertë **456,410,511 lekë pa TVSh.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë G. & SH., **me nr. N. JV & N. KN**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa TVSH = **456,410,511 lekë**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 15.02.2021.

**Ankesa:** Nuk ka patur ankesa.

Njoftim fituesi me shkresën nr. 149/2, datë 25.2.2021.

Shpallur në buletin e APP me nr. 29, datë 01.3.2021.

Me datë 24.2.2021 nr. 149/1prot nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës në të cilën është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur në përputhje me kuadrin ligjorë. Ky raport është nënshkruar dhe nga titullari i AK z. P.K..

Midis JV G. & SH. me ofertë 456,410,511 lekë dhe AK është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 149/4, datë 6.4.2021 për *“Furnizimit me ujë për Bashkinë Pustec”*, me afat punimesh 18 muaj për vlerën pa TVSh 456,410,511 lekë dhe vlera me TVSh prej 547,692,613 lekë.

Me shkresën nr. 149/3, datë 01.3.2021 nga AK i është kërkuara JV G. & SH. depozitim e dokumentacionit e tenderit si dhe sigurimin e kontratës 10% të vlerës së ofertës, kjo në zbatim të kreut III, seksioni 1, neni 21 pika 3 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.

Me shkresë përcjellëse datë 3.3.2021 JV G. & SH., ka përcjellë dokumentacionin e tenderit të inventarizuar.

Me PV datë 5.3.2021 anëtarët e KVO ka bërë verifikimin e dokumentacionit të tenderit nga JV G. & SH..

► **Titulli i gjetjes 6:** *Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave, duke kualifikuar operatorë me mangësi në plotësimin e kriterëve si dhe duke mos anuluar procedurën në mungesë të një OE që plotëson kërkesat e DST.*

### **Situata:**

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemin SEP, u konstatua se bashkimi OE **G. & SH.**, nuk plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, *konkretisht:*

Sipas kriterëve të DST, është kërkuar që për fabrikën e betonit, asfaltit, bitumit dhe nyjen e inerteve ne rast se është ne pronësi duhet te paraqiten dokumente qe vërtetojnë pronësinë e saj, *Leja mjedisore lëshuar nga QKL planimetri dhe dokumentacion qe vërteton pronësinë.*

*Ne rast se fabrikën e betonit, asfaltit, bitumit dhe nyjen e inerteve është me qera duhet te paraqitet kontrata e qerave e shoqëruar me dokumente qe vërtetojnë pronësinë e saj, Lejen mjedisore lëshuar nga QKL. Planimetri dhe dokumentacion qe vërteton pronësinë.*

- Kontrata e qirasë nr. 455 Rep, datë 04.04.2020 “Për furnizimin me bitum”, e paraqitur nga shoqëria G. shpk me shoqërinë E. shpk specifikon furnizimin me bitum **dhe jo marrjen me qira të fabrikës së bitumit sipas kërkesave të DST.**
- Kontrata e qirasë nr. 1928Rep ,date30.08.2018 “Për furnizimin me bitum”, e paraqitur nga shoqëria SH. shpk, me shoqërinë A. shpk, specifikon furnizimin me bitum **dhe jo marrjen me qira të fabrikës së bitumit si dhe nuk ka paraqitur dokumentacionin e pronësi sipas kërkesave të DST.**
- Nga shoqëria SH. shpk **nuk është paraqitur kontrata e qirasë** për fabrikën e betonit e cila është në pronësi të shoqërisë V. shpk, **si dhe nuk është paraqitur dokumentacioni i pronësisë së kësaj fabrike.**
- Nga shoqëria SH. shpk, është paraqitur Autobetonieria me targë AA, **por që i ka përfunduar fati i vlefshmërisë së certifikatës së kontrollit teknik datë 23.12.2020.**
- Nga shoqëria SH. shpk, është paraqitur mjeti kamion me vinç me Targë GJ, **por që i ka përfunduar afati i vlefshmërisë së certifikatës së kontrollit teknik datë 22.12.2020.**
- Nga shoqëria SH. shpk, është paraqitur mjeti kamionçinë me targë A.U, **nuk është paraqitur certifikata e lëshuar nga njësia e qeverisjes vendore për transport malli brenda vendit per llogarit e vete.**
- Nga shoqëria SH. shpk, është paraqitur për mjetin e marrë me kontratë qiraje nr. 116rep, datë 22.01.2021 me targë A.F është paraqitur Certifikata për transport mallrash brenda vendit për llogarit e vete, kur në rastin e mjeteve të marra me qira duhet të përcaktohet dhe për të tretë, **kjo në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DST ku për mjetet me qira duhet të jetë për të tretë.**
- Nga shoqëria SH. shpk, është paraqitur për mjetin me targë A.T paraqitur Certifikata për transport mallrash brenda vendit për llogarit e vete, kur në rastin e mjeteve të marra me qira duhet të përcaktohet edhe për të tretë, **kjo në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DST ku për mjetet me qira duhet të jetë për të tretë.**
- Nga shoqëria SH. është paraqitur Teknik gjeometër është kërkuar 1 (një), **por nga ndarja e punimeve në bashkëpunim duhet të paraqitej nga operatori G. shpk.**
- Sipas DST janë kërkuar 5 teknikë ndërtimi nga të cilat 4 janë nga shoqëria G.shpk dhe 1 (një) nga shoqëria SH. shpk, **i cili është topograf dhe jo teknik ndërtimi.**
- Sipas DST janë kërkuar Hidroizoluese 2 punonjës, nga të cilët 2 janë paraqitur dokumentacion nga shoqëria G. shpk, **por sipas ndarjes së punimeve duhej të paraqitej punonjës nga shoqëria SH. shpk.**
- Sipas DST janë kërkuar 2 punonjës karpentier, nga të cilët 2 janë paraqitur dokumentacion nga shoqëria G., **por sipas ndarjes së punimeve duhej të paraqitej punonjës nga shoqëria SH. shpk.**
- Sipas DST janë kërkuar 2 specialistë ndërtimi nga të cilët ka paraqitur dokumentacion shoqëria G., **por sipas ndarjes së punimeve duhej të paraqitej punonjës nga shoqëria SH. shpk.**
- Sipas DST janë kërkuar 5 montues tubosh nga të cilët ka paraqitur dokumentacion shoqëria G.shpk, **por sipas ndarjes së punimeve duhej të paraqitej punonjës nga shoqëria SH. shpk.**
- Nga të dy shoqëritë së bashku G.+ SH. shpk, nuk plotësohet kriteri sipas pikës 2.14 të DST për mjete e paisje teknike, pasi nga shoqëritë nuk është paraqitur kamionë vetëshkarkues me kapacitet min 16 ton. Nga 10 mjete që duhet të paraqiten nga shoqëritë janë paraqitur 7 mjete, pasi tre mjete nuk janë sipas kërkesave të DST, konkretisht:  
a- *Mjeti me targë A.F nuk është mjet kamion vetëshkarkues, por është mjet për transportimin e makinerive.*



b- Mjeti me targë A.R, sipas lejes së qarkullimit ka kapacitet 7.5 ton dhe jo minimum 16 ton.

c- Mjeti me targë A.9, nuk është kamion vetëshkarkues mbajtës, por është mjet transporti të makinerive.

• Nga shoqëria SH. shpk, nuk plotësohet pika 2.4 e DST, në paraqitjen e liçensave profesionale për disa nga kategoritë e punimeve, konkretisht:

a- Nuk disponon kategorinë e liçensës NS-9/D, pasi nga shoqëria është kategoria NS-9/B.

b- Nuk disponon kategorinë e liçensës NS-16/E, pasi nga shoqëria është kategoria NS-16/B.

c- Nuk disponon kategorinë e liçensës NS-18/D, pasi nga shoqëria është kategoria NS-18/C.

d- Nuk disponon kategorinë e liçensës NS-20/D, pasi nga shoqëria është kategoria NS-20/A.

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur midis 2 OE (78/22%) dhe ndarjes së punimeve, evidentohet fakti se të dyja shoqëritë kanë për të kryer punimeve në të gjithë zërat e punimeve sipas preventivit. Gjë e cila do të thotë duhet që secili nga bashkimi i OE duhet të kenë kategoritë e liçensës së kërkuara në DST, sipas pikës 2.4 të DST.

• Autofshesa e paraqitur **nuk ka bashkëlidhur dokumentacionin e mjetit, si leje qarkullimi, vërtetim pronësie, SGS dhe siguracionin mjeti.**

• Nga shoqëria G. shpk, nuk plotësohet kriteri sipas pikës 2.5 të DST, pasi nuk është paraqitur liçensë profesionale të lëshuar nga QKL për kategoritë III.2.B; 1.2.A; III.2.A (1+2), ku referuar marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur midis OE (78/22 %) dhe ndarjes së punimeve, evidentohet fakti se të dyja shoqëritë kanë për të kryer punimeve në të gjithë zërat e punimeve sipas preventivit. Gjë e cila do të thotë duhet që secili nga bashkimi i OE duhet të kenë kategoritë e liçensës së kërkuara në DST sipas pikës 2.5.

#### **Kriteri:**

Në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 28, “Anulimi i një procedure”, neni 76, “S’kualifikimi i ofertuesve”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, neni 97, “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”, pika 1, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 5, Neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 69, “Njoftimi i fituesit” .

#### **Ndikimi/Efekti:**

KVO, ka kryer vlerësimin dhe kualifikimin e BOE në paligjshmëri. Në kushtet kur në garë nuk ka OE të tjerë, KVO në bashkëpunim me Titullarin e AK duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë të re, duke analizuar shkaqet dhe përmisuar/ndryshuar kriteret e aplikuar, ku sipas auditmit nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, gjë e cila do të çonte në rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë dhe rritjen e konkurrencës për një menaxhim më të mirë të fondit të prokuruar në vlerën 456,410 mijë lekë.

#### **Shkaku:**

Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse në vlerësimin e procedurës, duke kualifikuar padrejtësisht OE me kriteret e paplotësuar, duke **ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KVO, respektivisht: J.N., me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë Pustec, z. V.S., me detyrë Specialist në Sektorin e Procedurave, zj. N.K., z. E.B. specialist të jashtëm dhe z. I.M. me detyrë ish- specialist Sektori i Financës.**

#### **Rëndësia:**

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Nga subjekti nuk është paraqitur kundërshti në fazën e Projekt Raport Auditimit

#### **2.4.4. Mbi zbatimin e kontratave të investimeve për punimet e ndërtimit, për periudhën 01.07.2022 – 31.12.2021.**

Në zbatim të pikës 4.4 të Programit të Auditimit nr. 884/1, datë 03.10.2022, i ndryshuar, në Bashkinë Pustec, nga ana e audituesve të KLSH-së, është përzgjedhur për auditim objekti si më poshtë:

Nr	Objekti	Kontraktori	Vlera e kontratës (me TVSH)	Shënime
1	Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, Bashkia Pustec	G.SH.	540,799,533	Audituar

#### **I. “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, Bashkia Pustec**

##### Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pustec, të përfaqësuar nga Titullari z. P.K. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë G.SHPK, me përfaqësues ligjor z. P.B., me licencë profesionale NZ 2309/15 dhe SH. SHPK, me përfaqësues ligjor z. Y.B., me licencë profesionale NZ 3580/17. Vlera e kontratës është 540,799,533 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 18 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve, data 08.04.2021.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr. 112/8 prot, datë 02.04.2021, është caktuar nga AK shoqëria Z.SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1208/13 dhe me vlerë të kontratës 4,324,340.4 lekë me tvsh.

Ky objekt në afatin e auditimit, rezulton të jetë i papërfunduar dhe nuk është bërë kolaudimi i punimeve.

##### Projektpreventivi

- Për këtë objekt, nuk rezulton të jetë dhënë nga Bashkia Pustec leja e ndërtimit/ leja infrastrukture. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” Neni 39, “Leja e ndërtimit” sipas të cilit “1.Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.

2.Dokumenti i lejes së ndërtimit përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqëruar të aplikimit dhe normave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

3.Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat “e” dhe “ë”, të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e

*planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit.” dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Bashkisë Pustec z. P.K., mbikëqyrësin e punimeve dhe kontraktorin e punimeve.*

- Nga verifikimi i bërë në Bashkinë Pustec, rezulton se nuk ka një dosje teknike të mirëfilltë, përveç dy situacioneve të paguara (i dyti pjesërisht), të pashoqëruara me librezë masash pjesore. Sa sipër ngarkohet me përgjegjësi Sipërmarrësi, Mbikëqyrësi i punimeve dhe përgjegjësi i financës z. Z.N..

- Nga auditimi, rezulton se projekti i administruar i nxjerrë nga sistemi elektronik, është hartuar nga shoqëria Z.C. SHPK në vitin 2020.

#### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 08.04.2021 dhe nuk kanë përfunduar. Pas kërkesës së mbikëqyrësit të punimeve me nr. 195 prot, datë 07.10.2022, ndërmjet palëve është bërë Amendimi i kontratës me nr. 1364/1 prot, datë 08.10.2022, për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 60 ditë (2 muaj), sipas të cilës data e përfundimit të punimeve të jetë 08.12.2022. Shtyrja e afatit me 2 muaj, është kërkuar për shkak të moslirimit në kohë të sheshit të ndërtimit (e cila, nga verifikimi i aktit të dorëzimit të sheshit, nuk është e vërtetë), moslidhja e energjisë për furnizimin me energji të puseve të shpimit dhe vonesa në furnizimin me hekur, çimento, tubo, etj., për shkak të luftës në Ukrainë. Nga sa më sipër argumenti i paraqitur për shtyrjen e afatit të punimeve nuk është i plotë dhe i saktë.

Nga verifikimi në sistemi i fiskalizimit, ka rezultuar se sipërmarrësi ka dorëzuar 5 fatura me vlerë totale prej 502,594,500 lekë, ose 92.9% të vlerës totale të kontratës. Në Bashkinë Pustec, janë shoqëruar me situacion punimesh dhe librezë masash (ardhur për auditim nëpërmjet emailit nga mbikëqyrësi i punimeve) vetëm 3 faturat e para, në vlerë totale 363,745,300 lekë. Ky veprim është në kundërshtim me UKM Nr .2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, “Dokumentacioni teknik i punimeve të ndërtimit”, pika 4, sipas të cilës “4. *Libri i masave mbahet për çdo objekt e nënobjekt, që ka preventiv dhe është dokument bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve. Në të pasqyrohen vëllimet metrike të punimeve, gradualisht me zhvillimin e tyre*”.

Është bërë projekti i azhurnuar nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi, i cili është miratuar nga titullari i Bashkisë z. P.K.. Në këtë projekt është bërë zëvendësimi i tubacionit të çelikut me D ~200 mm me tubacion PE100RC, pa asnjë argument teknik. Sa sipër ngarkohet me përgjegjësi Mbikëqyrësi i Punimeve.

Nga auditimi i analizave të reja të çmimeve dhe të faturave të blerjes së tubave nga shoqëria T.ShPK (e cila ka deklaruar që tubat janë brenda specifikimeve teknike), të dërguara nëpërmjet emailit nga mbikëqyrësi i punimeve, rezulton se zëri “material” në analizën e çmimeve për zërin e punës “FV tuba PE100RC me Dj 90 mm Pn16”, është marrë 2551 lekë/ml nga 519.3 lekë që është çmimi i shitjes nga shoqëria T.ShPK, ose 2031 lekë/ml më pak se çmimi i vendosur në analizë. Nga rillogaritja, çmimi i këtij zëri pune duhet të ishte 805 lekë/ml (519.3 + vlerat e elementëve të tjerë të kostos + shpenzimet plotësuese dhe fitimin), ose 2115 lekë më pak se çmimi i situacionuar (2920 – 805). Nisur nga fakti që ky tubacion është përdorur në linjat e dërgimit në sasinë 4161 ml, vlera e rritur padrejtësisht është 8,800,515 lekë pa TVSh. Për tubacionin PE100RC me Dj 110 mm Pn16, grupi i auditimit nuk administron faturat në lidhje me çmimet e blerjes dhe për pasojë nuk mund të shprehet. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UKM Nr .2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, “Zbatimi i punimeve të ndërtimit”, pika 8.3, sipas të cilës “Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë”. Përsa sipër,

do të rekomandojmë që Komisioni i Marrjes në Dorëzim të objektit, në bashkëpunim me mbikëqyrësin, të hartojnë analizën korrekte të çmimit, referuar faturave të blerjes dhe manualit të çmimeve në fuqi.

Në faturat e paraqitura nga mbikëqyrësi i punimeve për tubat, rezulton se tubat nuk janë blerë nga shoqëria me të cilën është lidhur kontratë furnizimi në fazën e prokurimit (E. SHPK). Gjithashtu tubacioni i vendosur në vepër (i evidentuar në depot e ujit) nuk është me vulat e prodhimit, ku të evidentohet presioni i punës të tubave (PN 10, PN 16). Sa sipër ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projektprventivi i azhurnuar, Situacion përfundimtar, libri i masave, kontrata për punë civile.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, Bashkia Pustec		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 540,779,533 lekë <b>B. fitues G. &amp; SH. SHPK</b>	<b>16.Likuiduar -----</b>
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> <b>-Vlera me tvsh</b>	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 18 muaj, Fillimi punimeve: 08.04.2021 Përfundimi punimeve : pa përfunduar	<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Amendament nr. 1364/1 prot, datë 08.10.2022. Shtyrje 60 ditë, deri në datën 08.12.2022.
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> Zenit-06	Licenca Nr: MK 1208/8	Kontrata nr. 112/8 prot, datë 02.04.2021
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> Nuk ka	Licenca Nr:	
<b>22.Akt Kolaudimi</b> Nuk aka	<b>23.Akt i marrjes së përkohshme në dorëzim</b> nuk ka	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 6,450,180 lekë pa tvsh.

**Titulli i Gjetjes:** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, Bashkia Pustec, nga zbatuesi i punimeve BOE G.SH., për zërat e punimeve II.22, IV.b (1.1, 1.2, 1.3, 2.1, 2.2, 2.3, 2.4) dhe V.b (2.1, 2.2, 2.3).

**Situata:** Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me eskavator me zinxhir”, Shtresë betoni C 12/15”, “Pllakë themeli C 30/37”, “Mure b/a për rezervuarin C 30/37”, “Mbushje me zhavor në rrugë”, etj, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:** Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektprventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 112/8 prot, datë 02.04.2021.

**Ndikimi:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Pustec.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga Bashkia Pustec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 847,620 lekë pa tvsh nga BOE G.SH., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021 me objekt “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, Bashkia Pustec, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Rekomandime:** Bashkia Pustec të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të vlerësojnë e të analizojnë zërin e punimeve “Mbushje me zhavorr në rrugë”, i cili nuk është i situacionuar sipas librezës së masave në vlerën 5,602,560 lekë nga sipërmarrësi i punimeve, për të përcaktuar volumet sipas punimeve të kryera në fakt dhe në rast diferencash, të merren masa për arkëtimin e kësaj vlere nga BOE G.SH., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021, me objekt “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

1. Z. A.P. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën 291, datë 16.12.2021, e protokolluar në KLSH me nr. 884/7 prot, datë 06.01.2023.2021, është observuar nga mbikëqyrësi i punimeve z. A. P.

**Pretendimi i subjektit:**

1. Ju bëjmë me dije se nga mbikëqyrësi i punimeve vërtet ju janë dërguar në nxitim e sipër librezat e masave dhe çmimet përkatëse me e-mail, por ju kemi njoftuar më pas që këto librezat dhe çmime janë nisur librezat pjesore të mëparshme dhe jo të situacionit përkatës dhe si rrjedhim, nga një lapsus i joni, keni vendosur dëm ekonomik për sipërmarrësin e punimeve.

Në analizën e dërguar nga ana jonë, ju mund të verifikoni saktësisht që nuk është parashikuar transporti dhe themeli prej betoni për vendosjen e këtyre bandierave

Përsa i përket zërit 1, çmimi i bandierës së betonit në analizën e dërguar me email nuk është parashikuar çmimi i transportit të materialit dhe themeli prej betoni M-200. (Bashkangjitur analiza e punimit me çmim 5,864 leke).

Nr.	EMERTIMI	Njesia	PUNTORI			TRANSPORT			MAKINERI			MATERIAL			Shuma	Shp pl 8%	Fitim 10%	TOTALI
			op	çmimi	Vlefte	Tfkm	çmimi	Vlefte	o.p	çmimi	Vlefte	Sasia	çmimi	Vlefte				
An	Bandiera betoni	cope																
	Sp.P.	op	0.2	185	1517													
	Sigurime shpërore 16.7%	leke	1517	0.167	253.338													
	Transport	ton				6	20	120										
	Autovëno 5 ton	op							0.25	3100	775							
	Bandiera betoni	op										1.005	1200	1206				
	Te ndryshme	leke										0.125	8625	1103.125				
	<b>Shuma:</b>				<b>1770.34</b>			<b>120</b>		<b>175</b>			<b>2309</b>	<b>4374</b>	<b>398</b>	<b>437</b>	<b>5870</b>	
	Zbritja e vlerës në tender 0.0364%																	8
	<b>Shuma:</b>																	5864

**Opinion i grupit të auditimit:**

Grupi i auditimit, pas shqyrtimit të obsevacionit dhe dokumentacionit shoqërues, këtë argument e merr në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

**2 Zeri 2. Germim shkëmbi mesatar me çekiç me eskavator me zinxhir.**

- Në librezën që ju kemi dërguar me observacion ju kemi sqaruar zë për zë ,rrugë për rrugë për çdo gjatësi linje, volumet përkatëse të gërmimit për këtë zë punimi dhe për këtë jemi në dispozicion të kontrollojmë në terren volumet dhe sasi të dhe ne pretendojmë që janë kryer volume dhe më tepër se sa kemi paraqitur në librezën e masave dhe jo të kemi kryer më pak. Edhe këtu në të vërtetë nuk e dimë se nga kanë dalë arsyetimet tuaja për përfitim të padrejtë, prandaj ju lutemi merrni për bazë librezën e masave bashkangjitur, pasi kjo është e saktë dhe përputhet me volumin e punimeve në terren.
- Persa i perket zerit 2, **Germim shkëmbi mesatar me çekiç me eskavator me zinxhir**, sasia në librezën e masave të printuar rezulton të jetë 8734.73 meter kub dhe jo 8434.6 meter kub sic pretendohet nga ana juaj (bashkangjitur librezë).

2	3.124/1a	<i>Germim shkëmbi mesatar me çekiç me eskavator me zinxhir</i>	m <sup>3</sup>									
		Pusi Nr.7- depo grumbulluese Lajthize (SP)		118	0.60	1.20	84.96		84.96			
		Pusi Nr.4- depo grumbulluese Lajthize (SP)		81	0.60	1.20	58.32		58.32			
		Pusi Nr.5- depo grumbulluese Lajthize (SP)		24	0.60	1.20	17.28		17.28			
		Pusi Nr.6- depo grumbulluese Lajthize (SP)		135	0.60	1.20	97.20		97.20			
		Depo grumbulluese Lajthize (SP) - pika 61 (linje per ne pustec depo 200m <sup>3</sup> )		1553	0.70	1.20	1,304.52		1,304.52			
		pika 61 (linje per ne pustec depo 200m <sup>3</sup> ) - pika 193 (linje per ne pustec depo 200m <sup>3</sup> )		768	0.60	1.20	552.96		552.96			
		pika 4 (linje per ne pustec depo 200m <sup>3</sup> ) - pika 378 (linje per ne pustec depo 200m <sup>3</sup> )		1836	0.60	1.20	1,321.92		1,321.92			
		pika 378 (linje per ne pustec depo 200m <sup>3</sup> ) - DEPO pustec 200m <sup>3</sup>		248	0.70	1.20	208.32		208.32			
		Burimi Nr 2 - depo 200 m <sup>3</sup>		1089	0.60	1.20	784.08		784.08			
		pika 61 (linje per ne Zaroshke 100m <sup>3</sup> ) - pika 726 (linje per ne Zaroshke 100m <sup>3</sup> )		48	0.60	1.20	34.56		34.56			
		pika 710 (linje per ne Zaroshke 100m <sup>3</sup> ) - pika 707 (linje per ne Zaroshke 100m <sup>3</sup> )		5.7	0.60	1.20	4.10		4.10			
		pika 696 (linje per ne Zaroshke 100m <sup>3</sup> ) - pika 694 (linje per ne Zaroshke 100m <sup>3</sup> )		21.5	0.60	1.20	15.48		15.48			
		Depo 100m <sup>3</sup> Pustec - pika 419 (linje per ne lajthize 50m <sup>3</sup> )		1618	0.60	1.20	1,164.96		1,164.96			
		pika 821 (linje per ne lajthize 50m <sup>3</sup> ) - pika 844 (linje per ne lajthize 50m <sup>3</sup> )		117	0.60	1.20	84.24		84.24			
		Depo 200m <sup>3</sup> Pustec piketa 378 - pika 3156 (linje per ne Diellas 100m <sup>3</sup> )		1431	0.60	1.20	1,030.32		1,030.32			
		piketa 3156 - Depo Diellas 100m <sup>3</sup> E MARRE ME RRJETIN SHPERNDARES DIELLAS		357								
		Pusi Globocen - pika 2344 (linje per ne Globocen 100m <sup>3</sup> )		828	0.60	1.20	596.16		596.16			
		pika 2344 (linje per ne Globocen 100m <sup>3</sup> ) - depo Globocen 100m <sup>3</sup>		536	0.60	1.20	385.92		385.92			
		Pusi Gorice e Vogel - pika 3446 (linje per ne Gorice e Vogel 100m <sup>3</sup> )		64	0.60	1.20	46.08		46.08			
		Pusi Gorice e Madhe - pika 2144 (linje per ne Gorice e Madhe 200m <sup>3</sup> )		701	0.60	1.20	504.72		504.72			
		Burimi 1-Burimi 2 DEPO 200M <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	203	0.60	1.20	146.16		146.16			
		Burimi 1 - Depo 100 m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	29.8	0.60	1.20	21.46		21.46			
		Burimi 2 - Depo 100 m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	206.4	0.60	1.20	148.61		148.61			
		Burimi 1 Pa Mare - Burimi 2	ml	170.00	0.60	1.20	122.40		122.40			
							<i>Shuma</i>		<b>8,734.73</b>		m <sup>3</sup>	

Opinioni i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e cituar, pasi ka bërë verifikimin e librezës së masave të situacionit nr. 3, të ardhura nëpërmjet emailit. Është detyra e sipërmarrësit dhe e mbikëqyrësit që të hartoni librezat e masave të sakta dhe që të përputhen me situacionet përkatës. Pas verifikimit të librit të masave të sjellë nëpërmjet observacionit, argumenti juaj merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

3. Zëri. 2 Germim shkëmbi mesatar me çekiç me eskavator me zinxhir. Arsyetimi juaj bazohet në shikimin vizual të gjurmës në terren dhe jo një analizë të terrenit në këto që ju i referoheni.

Ju vemë në dijeni se prerjet gjeologjike në të gjitha terrenet në këto bashki janë shkëmbore dhe për ato që ju i referoheni dhe klasifikimi si tokë e kategorisë tretë s'jane

të tilla por në dukje vizuale vetëm në një trashësi 10-15 cm në sipërfaqe, ndërsa në thellësi janë shkëmbinj të nivelit mesatar dhe të fortë. Vetë ju e keni venë re që të gjitha zonave që ju i referoheni, janë djerrë të pa mbjella pasi janë të papunueshme për shkak të shkëmbit. Nëse këto toka do të ishin sipas kategorisë që ju i keni klasifikuar si tokë bujqesore e kategorisë së tretë, që ka kjo zonë, nuk do të ishte lenë e pashfrytëzuar dhe e pa mbjellë. Për të justifikuar pretendimin tonë bashkangjitur foto në këtë zonë dhe punime në keto segmente dhe jemi të hapur për kontrolle të mëtejshme për të verifikuar dhe marrë për bazë pretendimin tonë.

- Përsa i përket zërit 2 Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me eskavator me zinxhir, që nga ana juaj pretendohet se nuk është shkëmb mesatar, rezulton se vetëm një pjesë sipërfaqes është dhe i kategorisë III-të ndërsa në thellësi është shkëmb i nivelit mesatar dhe i fortë, dhe në tërësi ashtu sic edhe është preventivuar është shkëmb mesatar.



Opinion i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e cituar, pasi ka bërë verifikimin në terren, ku ka rezultuar që ato pjesë që janë cituar në aktkonstatimi, të jenë dhe i kategorisë së III-të. Nisur nga fakti i pranuar edhe nga ju që 15 cm janë tokë e katgorië së tretë, atëhere ky volum gërimi duhet të ishte marrë më çmimin e tokës së kategorisë së tretë. Nga rillogaritja, sasia prej  $207 \text{ m}^3$  (2300 ml gjatësi x 0.6 m gjerësi x 0.15 m thellësi), duhet të librezohet dhe situacionohet si “Gërmim dheu kat. III”, me çmim të ofertës 750 lekë/ $\text{m}^3$ . Diferenca prej 1250 lekë/ $\text{m}^3$ , për volumin prej  $207 \text{ m}^3$ , është përfituar padrejtësisht nga

sipërmarrësi i punimeve. Sa sipër, pretendimi juaj merret pjesërisht në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

4. Zëri 5. “Transport dheu deri ne 5 km”, edhe për këtë rast janë nisur librezat pjesore të mëparshme dhe jo te situacionit përkatës dhe për këtë ju kemi dërguar librezën reale dhe është pasqyruar sasia per 4647 m<sup>3</sup> dhe kjo librezë duhet te merret parasysh dhe do te ktheni pretendimin e mëparshëm per përfitim të padrejtë. Bashkangjitur pretendimit tonë po ju dergojme dhe fotot e shkarkimit te mbeturinave.



- Përsa i përket zërit 5. **Transport dheu deri ne 5 km**, sasia në librezën e masave të printuar rezulton të jetë 4646 metër kub dhe jo 3846 metër kub, sic pretendohet nga ana juaj.

5	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3									
1		Sipas Gërmive	m3	4646.87					4,646.87		4,646.87	
2			m3									
3			m3									
4			m3									
5			m3									
<i>Shuma</i>										4,646.87	m3	

Opinionimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e cituar, pasi ka bërë verifikimin e librezës së masave të situacionit nr. 3, të ardhura nëpërmjet emailit. Është detyra e sipërmarrësit dhe e mbikëqyrësit që të hartoni librezat e masave të sakta dhe që të përputhen me situacionet përkatës. Pas verifikimit të librit të masave të sjellë nëpërmjet observacionit, argumenti juaj merret në konsideratë.



Pretendimi i subjektit:


5. “Mbushje me zhavor në rrugë”. Përsa i përket pretendimit tuaj Ju vetë jeni shprehur se verifikimi nga ana juaj është bërë me zgjedhje dhe si rrjedhim pretendimi se kanali nuk është mbushur me zhavor por me material të gërmuar është i pasaktë. Edhe në zonat që ju keni kontrolluar materiali ishte zhavor rrugor por për shkak të punimeve në rrugë dhe për të mos penguar qarkullimin e mjeteve bujqësore dhe kafshëve blegtorale cakulli është përzier me dhera, por që absolutisht është përdorur cakell në mbushjen dhe për këtë kërkojme të kryeni kontrole më të detajuara në terren dhe jo pjesore e rastesore për të arritur në një konkluzion të tillë si dëm ekonomik i këtij zëri punimi. Rishikojeni pasi janë zbatuar të gjitha KTZ e zbatimit dhe projektimit në mënyrë rigoroze. Nje rast i veçuar kontrolli, kursesi nuk mund të behet përgjithësim për gjithë punën e kryer në terren. Bashkangjitur fotot e karrierave të shfrytëzuara nga ana jonë si dhe fotot e mbushjes së kanalit me material të gërmuar.

- Përsa i përket pikës 5.Mbushje me zhavor në rrugë, sipas librezës masave të printuar është 4689 metër kub. Përsa i përket mbushjes së kanaleve është realizuar me mbushje me zhavorr në rrugë, por në disa segmente të shkurtra mund të ketë ndodhur edhe perzierja e zhavorit me dheun për shkak të shirave dhe levizjes së mjeteve menjëherë pas zhavorrimit të rrugëve dhe jo siç pretendohet nga ana juaj.

Megjithatë nga ana e kontraktorit do të merren masa për riparimin e atyre pjeseve te të cilat ka ndodhur ky fenomen.







**Opinion i grupit të auditimit:**

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e cituar, pasi ka bërë verifikimin në terren, ku ka rezultuar që shtresa e zhavorrit nuk rezulton të jetë hedhur konform projektit të azhurnuar, të miratuar nga Investitori. Megjithëse në rrugët brenda fshatrave, ku kaluar tubacioni i ujit (të paraqitura edhe në foto), është bërë shtresë zhavorri, në dokumentacionin e administruar në dosje, nuk ndodhet asnjë dokument që të ketë miratuar ndryshimin në preventiv për përdorimin e zhavorrit si shtresë rrugore. Nga ana e investitorit, mbikëqyrësit dhe sipërmarrësit, duhet të procedohet me shkrim mbi këtë ndryshim. Sa sipër, pretendimi juaj merret pjesërisht në konsideratë.

**IV. Punime per rezervuarin 100 m<sup>3</sup> dhe 200 m<sup>3</sup>, Pustec**  
**B. Punime ne rezervuarin 200 m<sup>3</sup>**

**Pretendimi i subjektit:**

6. Persa i përket pikës 5. 1.1 Germim shkambi i forte me çekiç me eskavator me zinxhir, sasia në librezën e masave të printuar rezulton të jetë 614 meter kub dhe jo 414.2 meter kub sic pretendohet nga ana juaj. Edhe ne këtë zë librezat e dërguara nga ana jonë janë lapsus, e për pasojë duhet të merret parasysh librezat bashkangjitur. Theksojmë që objekti nuk ka përfunduar dhe është në punë e sipër dhe librezat përfundimtare me plus minuset përkatëse nuk është hartuar ende në të cilat do të bëhen korrigjimet e nevojshme sipas punimeve faktike.

1	2.48/an	Germim shkambi i forte me çekiç me eskavator me zinxhir	m <sup>3</sup>									
1		Germime per rezervuarin	m <sup>3</sup>	1	10.90			56.40	614.76		614.76	
<i>Shuma</i>											614.76	m <sup>3</sup>

**Opinion i grupit të auditimit:**

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e cituar, pasi ka bërë verifikimin e librezës së masave të situacionit nr. 3, të ardhura nëpërmjet emailit. Është detyra e sipërmarrësit dhe e mbikëqyrësit që të hartoni librezat e masave të sakta dhe që të përputhen me situacionet përkatës. Pas verifikimit të librit të masave të sjellë nëpërmjet observacionit, argumenti juaj merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

7. Përsa i përket zerit 5. “Transport dheu deri ne 5 km”, sasia në librezën e masave të printuar rezulton të jetë 446 metër kub dhe jo 329 meter kub sic pretendohet nga ana juaj.

2	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m <sup>3</sup>									
1		Transport	m <sup>3</sup>	1				446.68			446.68	
<i>Shuma</i>											446.68	m <sup>3</sup>

Opinionimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e cituar, pasi ka bërë verifikimin e librezës së masave të situacionit nr. 3, të ardhura nëpërmjet emailit. Është detyra e sipërmarrësit dhe e mbikëqyrësit që të hartojnë librezat e masave të sakta dhe që të përputhen me situacionet përkatës. Pas verifikimit të librit të masave të sjellë nëpërmjet observacionit, argumenti juaj merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

8. Përsa i përket zërit 1.3 “Hedhje, rrafshim e ngjeshje dheu”, sasia në librezën e masave të printuar rezulton të jetë 168 metër kub dhe jo 85 metër kub sic pretendohet nga ana juaj.

3	2.19/a	Hedhje, rrafshim, mbushje dhe u me krah, kategoria IV (mbushje rreth rezervuarit)	m <sup>3</sup>									
1		Mbushje	m <sup>3</sup>	1	10.90			15.50	168.95		168.95	
<i>Shuma</i>											168.95	m <sup>3</sup>

Opinionimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e cituar, pasi ka bërë verifikimin e librezës së masave të situacionit nr. 3, të ardhura nëpërmjet emailit. Është detyra e sipërmarrësit dhe e mbikëqyrësit që të hartojnë librezat e masave të sakta dhe që të përputhen me situacionet përkatës. Pas verifikimit të librit të masave të sjellë nëpërmjet observacionit, argumenti juaj merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

9. Përsa i përket zërave **2.1, 2.2, 2.3, 2.4**, për këto zëra punimesh projekti i azhornuar është paraqitur sipas faktit por llogaritja e volumeve ka një diferencë sic është konstatuar edhe nga ana juaj, ky gabim në llogaritje ka ardhur si rezultat i mbledhjes gabim të qelizave në excel por që këto volume do të zbriten në situacionin pasardhës duke pasqyruar volume sipas projektit të azhornuar faktik.

Opinionimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit i qëndron gjetjes së evidentuar në aktkonstatimi dhe të pranuar nga observuesi.

**V. Punime per rezervuarin 50 m<sup>3</sup>, Lajthize**

Pretendimi i subjektit:

10. Përsa i përket zërit 1.1 **Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me eskavator me zinxhir**, sasia në librezën e masave të printuar rezulton të jetë 306 metër kub dhe jo 124 metër kub sic pretendohet nga ana juaj.

V. PUNIME PER REZERVUARIN 100m3 (LAJTHIZE) DHE RRJETIN SHPERNDARËS											
a. PUNIME PER REZERVUARIN 100m3											
1.Punime Dheu											
1	2.47/an	Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me eskavator me zinxhir	m3								
1		Gërmim shkëmbi mesatar	m3	1	7.60		40.30	306.28		306.28	
									Shuma	306.28	m3

Opinion i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e cituar, pasi ka bërë verifikimin e librezës së masave të situacionit nr. 3, të ardhura nëpërmjet emailit. Është detyra e sipërmarrësit dhe e mbikëqyrësit që të hartojnë librezat e masave të sakta dhe që të përputhen me situacionet përkatës. Pas verifikimit të librit të masave të sjellë nëpërmjet observacionit, argumenti juaj merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

11. Përsa i përket zërave **2.1, 2.2, 2.3**, për këto zëra punimesh projekti i azhornuar është paraqitur sipas faktit por llogaritja e volumeve ka një diferencë sic është konstatuar edhe nga ana juaj, ky gabim në llogaritje ka ardhur si rezultat i mbledhjes gabim të qelizave në excel por që këto volume do të zbriten në situacionin pasardhës duke pasqyruar volume sipas projektit të azhornuar faktik.

Opinion i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit i qëndron gjetjes së evidentuar në aktkonstatimi dhe të pranuar nga observuesi.

12. Për zërin e punës “Mure b/a për rezervuarin C 30/37”, nuk është paraqitur observacion.

**C. Punime në rrjetin shpërndarës Lajthizë**

13. Përsa i përket zërit 1.1 **Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me eskavator me zinxhir**, volumet janë të realizuara sipas librezës së masave me sasi 2054 m<sup>3</sup> dhe jo 948 m<sup>3</sup> siç pretendohet nga ana juaj. Edhe për këtë zë punimet faktike të kryera janë sipas librezës së masave bashkangjitur. Kjo ka ardhur si rezultat që inxhinieri ka dërguar librezën e masave të punimeve pjesore dhe jo librezën e situacionit përkatës të kontrolluar nga ana juaj.

2	3.124/1a	German shikëmbi mesatar me çelëç me ekskavator me çukëhir	m3									
1		419-821	m3		81.1	1.00	1.20		97.32		97.32	
2		821-844	m3		185	0.80	1.20		177.60		177.60	
3		821-844	m3		117.86	0.60	1.20		84.86		84.86	
4		844-439	m3		73.2	1.00	1.20		87.84		87.84	
5		439-441.1	m3		26.6	0.80	1.20		25.54		25.54	
6		441.1-997	m3		173.86	0.70	1.20		146.04		146.04	
7		439-888	m3		0	0.60	1.20		-		-	
8		888-918	m3		71.898	0.60	1.20		51.77		51.77	
9		889-898	m3		52.086	0.60	1.20		37.51		37.51	
10		835-839	m3		35.89	0.60	1.20		25.84		25.84	
11		898-906	m3		70.285	0.60	1.20		50.61		50.61	
12		918-922	m3		19.033	0.60	1.20		13.70		13.70	
13		918-929	m3		18.325	0.60	1.20		13.19		13.19	
14		849-867	m3		74.55	0.60	1.20		53.68		53.68	
15		943-961	m3		0	0.60	1.20		-		-	
16		933-935	m3		0	0.60	1.20		-		-	
17		976-988	m3		48.068	0.60	1.20		34.61		34.61	
18		870-874	m3		21.86	0.60	1.20		15.74		15.74	
19		Linja 75 Depo 30 m3 - Pk 907	m3		76.67	0.60	1.20		55.20		55.20	
20		Pikat e lidhjeve me banoret	m3		284	0.60	1.20		204.48		204.48	
21		German per rruge akses	m3		396			2.23			883.08	
										<b>Shuma</b>	<b>2,058.60</b>	<b>m3</b>

### Opinion i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e cituar, pasi ka bërë verifikimin e librezës së masave të situacionit nr. 3, të ardhura nëpërmjet emailit. Është detyra e sipërmarrësit dhe e mbikëqyrësit që të hartojnë librezat e masave të sakta dhe që të përputhen me situacionet përkatës. Pas verifikimit të librit të masave të sjellë nëpërmjet observacionit, argumenti juaj merret në konsideratë.

### **2.5: Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.**

#### **Situata:**

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Bashkia Pustec, mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi e mëparshme paraqitur me shkresën nr. 870/9,prot, datë 23.12.2021, konstatohet se:

Ndërsa nga Bashkia Pustec për zbatimin e rekomandimeve të KLSH **nuk është** kthyer përgjigje, **duke mos respektuar afatin brenda afatit 20 ditor**.

Bashkisë Pustec, nuk ka raportuar në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 23.06.2022.

Bashkia Pustec ka hartuar “Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve” me shkresën nr. 90, datë 18.01.2022, në të cilën janë përcaktuar strukturat dhe personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete, **por nuk ka raportuar në këshillin e njësisë** (këshillin bashkiak), bazuar në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm.

Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

**a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 10 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat është zbatuar 1 (një) masë, në proces zbatimi 2 masa dhe pa zbatuar akoma 7 masa.**

**b. Për masa shpërblim dëmi, është rekomanduar 1 (një) masë me vlerë 300,000 lekë, e cila është pranuar dhe zbatuar.**

**c. Për masa mungesë të ardhurash është rekomanduar 1 (një) masë me vlerë 15,039 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi, ku nga**

vlera e rekomanduar prej 15,039 mijë lekë është arkëtuar vlera 1,414 mijë lekë, duke mbetur për arkëtim vlera **13,625 mijë lekë**.

**d. Për masa disiplinore**, janë rekomanduar gjithsej **7 masa** të cilat janë pranuar dhe zbatuar nga subjekti (sipas aneksit 5 bashkëlidhur Raport Auditimit).

**Kriteri:**

Nenet 15 dhe 30 të Ligji nr. 154/2021, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, si dhe neni 50-Auditimi i jashtëm, të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

**Ndikimi/Efekti:**

Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën **15,039 mijë lekë**.

**Shkaku:**

Neglizhencë dhe papërgjegjshmëri e personave përgjegjës në zbatimin e rekomandimeve sipas planveprimet nr. 90, datë 18.01.2022.

**Rëndësia: E mesme**

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa për përsheptimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve në proces zbatimi, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 870/9,prot, datë 23.12.2021 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Pustec”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 884/8, datë 6.01.2023 “Mbi Projektraporti e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:**

*Në lidhje me shpërblimin e dëmit për vlerën 300,000 lekë, kjo shumë është arkëtuar sipas futurës për arkëtim datë 12.7.2021 për vlerën 335,125 lekë së bashku me kamatëvonesat, bashkëlidhur dokumentacioni.*

**Qëndrimi i grupit të KLSH:**

Merret në konsideratë shpjegimet e subjektit, kjo referuar dhe dokumentacionit bashkëlidhur.

**Statusi i rekomandimeve nga auditimi, paraqiten si vijon:**

**A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Pasqyrat financiare të viteve 2019 dhe 2020 (bilanci), janë mbyllur jashtë afatit ligjorë, konfirmuar me shkresën përcjellëse nr. 788 prot., datë 27.07.2020, për vitin ushtrimor 2019 dhe shkresën nr. .777 datë 11.06.2021 për vitin 2020, të konfirmuar nga Dega e Thesarit Korçë, përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të viteve 2019-2020 me anekset përkatëse, pra me 3 muaj vonesë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me shkronjën (d) e pikës 4 e nenit 9, dhe shkronjës (b) e pikës 2 të nenit 12, të ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”; UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësinë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 118. (Më hollësisht trajtuar në pika 2, faqet 37-58. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi** Kryetari i Bashkisë, të analizojë shkaqet e mos mbylljes në afat të pasqyrave financiare për vitet 2019 dhe 2020, si dhe të përskruhet qartë baza mbi të cilën janë paraqitur, duke referuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për klasifikimin

dhe raportimin e pasqyrave financiare. Përgjegjësia për raportim në çdo kohë të jetë e dokumentuar jo nëpërmjet shkresës përcjellëse të dërgimit të pasqyrave, por evidentohet në përgjegjësi të plotë në kapakun e pasqyrave financiare, se kush janë hartuesit dhe drejtuesit.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Ne baze të rekomandimit pika 1.1 mbi mbylljen e pasqyrave financiare është evidentuar në mënyrë shkresore dhe në kapakun e bilancit hartuesi dhe drejtuesi i pasqyrave financiare.*

*-Vete organizimi i strukturës të bashkisë në nivel sektori ka ndikuar edhe në ndarjen e detyrave brenda sektorit të financës, ku në rastin konkret përgjegjësi i financës paraqitet si përgjegjës financë/p. Buxheti dhe p/kontabiliteti, funksion i cili jep ndikim jo i pa rëndësishëm kur në të njëjtën kohë përpilohet plani i buxhetit për vitin pasardhës dhe mbyllja e shpenzimeve dhe të ardhurave të vitit paraardhës të cilat çelen për vitin ushtrimor. Paralel me këtë kërkohet raportimi i pasqyrave financiare në afatin e caktuar.*

*-Një ndikim negativ dhe shqetësues ka sjelle edhe ndryshimet e shpeshta brenda sistemit, kjo si në pranim dhe në largimin e punonjësve të cilat vonojnë në azhornimin e dokumenteve pjese e mbylljes së pasqyrave financiare.*

**Statusi: Pa zbatuar**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në fund të vitit 2020 llogaria **468 “Debitorë të ndryshëm”** paraqitet në vlerën **129,768** lekë për 33 raste, të cilat përfaqësojnë detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë. Konstatohet së vlera **129,768** lekë janë detyrime përpara vitit 2015 të trashëguara nga ish komunat, i cili është detyrim i pa definuar, pa dokumentacionin përkatës për t’u paraqitur si detyrim ndaj furnitorëve për mallra shërbime dhe punime të kryera, i mbartur, të cilat konsistojnë me kontrata pa vlerë, pa faturë të thjeshtë tatimore apo faturë tatimore me TVSH apo dhe pa procedurë të mbyllur, në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6.

Sipas akt rakordimit të mbajtura nga sektori i të ardhurave me degën e thesarit, debitorët e subjekteve taksapagues privat dhe familjar, janë në vlerën prej **15,039 mijë** lekë gjendje 31.12.2020. Nga analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, konstatohet se vlera prej **15,039 mijë** lekë nuk është pasqyruar në kontabilitet. Pra kemi një nënvlerësim të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, aneksi 1, pika 3.3. (Më hollësisht trajtuar në pika 2, faqet 37-58. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës në bashkëpunim me Sektorin e të Ardhurave të merren masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore në fund të vitit ushtrimor 2020 në vlerën **15,039 mijë lekë**, sipas evidencave të Sektorin të të Ardhurave Vendore.

**2.2. Rekomandimi:** Sektori i Financës, në bashkëpunim me Sektorin Juridike të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Sipas përgjegjësit të financës, detyrimet e pashlyera nga të ardhurat vendore në fund të vitit 2020 ndiqen me analizat përkatëse nga Sektori i të Ardhurave për shumën 15,039,000 lekë e cila n.q.s. kontabilizohet në bilanc do të ndikojë si në planin e te*



*ardhurave dhe shpenzimeve e cila do sjelle probleme ne hartimin e buxhetit ku ne rastin konkret zë 1/3 e buxhetit fillestar te bashkisë per te cilën jemi ne proces qartësimi problem i cili do te ngelet per vitin 2022.*

*Vlera debitore per vlerën 129,768 lek per 33 raste jane debitore para vitit 2015, si te tilla jane pa shprese arkëtimi dhe per kohen e raportimit nuk kemi ndryshim ne llog 468 Debitore te ndryshëm .*

**Statusi: Pa zbatuar**

**3. Gjetje nga auditimi:** Llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, më 31.12.2019 paraqitet në vlerën 6,393,315 lekë, kurse më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 1,437,029 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrimet e prapambetura të pa likuiduara ndaj të tretëve. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se pozicionimi i kësaj llogarie është bërë në mënyrë të gabuar pasi llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” përfaqëson vlerën kundër parti të disa llogarive të detyrimeve kreditore të pasivit të bilancit. Vlera debitorë e kësaj llogarie, nuk është e kuadruar me shumën e llogarive kreditore të pasivit të bilancit, vlera e të cilave është në shumën totale 2,033,221 lekë sipas llogarive dhe as është e analizuar sipas llojeve të detyrimeve të pa paguara si më poshtë vijon:

-Llogaritë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën kontabël për 435,624 lekë dhe llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vlerën kontabël 1,597,597 lekë.

Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap. III, pika 42 dhe Aneksi –1, Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik. (Më hollësisht trajtuar në pika 2, faqet 37-58. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Pustec, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundër partisë së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm”

**3.2. Rekomandimi:** Nga sektori i financës në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 të kryhen veprimet e sistemimit në kontabilitet të llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, duke pasqyruar në gjendjen kreditore të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasiv të bilancit, detyrimet ndaj të tretëve të lindura nga vendimet gjyqësore, si dhe nga detyrimet kontraktore të cilave i ka kaluar afati 60 ditor në vlerën **435,624 lekë**. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021, konstatohet se nuk është bërë sistemimi i llogarive të mësipërme sipas rekomandimit tonë.*

**Statusi: Pa zbatuar**

**4. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, më 31.12.2019 paraqitet në vlerën 2,558,433 lekë, ndërsa më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 18,399,892 lekë, me diferencë në rritje në vlerën 15,841,459 lekë e cila përfaqëson shtimin e tre projekteve për vitin 2020, (Për 2 Blerje projekti studim Uji i Pijshëm dhe Oponence teknike KUZ, Bashkia Pustec).

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se vlera **2,558,433 lekë**, i përkasin 20 projekteve për investimet e kryera, për objekte të cilat kanë përfunduar punimet dhe janë marrë në dorëzim nga Bashkia, vlerë e cila duhet të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit. Në këtë rast, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve e analizuar sipas aneksit nr.4, pika 3, për projektet, studimet e kërkime dhe vlerat përkatëse, gjendje më

31.12.2020 bashkëlidhur projekt raportit. Veprime dhe mos veprimet janë në kundërshtim të UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b”. *(Më hollësisht trajtuar në pika 2, faqet 37-58. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës në Bashkinë Pustec të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “*Studime dhe Kërkime*” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*N lidhje me sistemimin e llog 202 studime dhe kërkime gjendje e vitit 2020 per shumen 2,558,433 lekë per 20 projektet nuk është shpërndarë sipas investimeve përkatëse per faktin se nje pjese e mire e tyre (studimeve ) zënë investimet e aseteteve tek ujësjellësi Sh.a Pustec me te cilin akoma jemi ne mbyllje përfundimtarë te problemit te aseteteve per faktin 100% e aksioneve jane prone e Bashkise. Ndërsa pjesa tjetër e studimit ka te beje me investimin Furnizim me ujë Bashkia Pustec i cili është ne proces realizimi.*

**Statuasi: Zbatuar**

**5. Gjetje nga auditimi:** Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën neto) për vitin 2020 është në vlerën **156,289,659** lekë dhe për vitin 2019 është në vlerën **164,540,191** lekë nuk është paraqitur i plotë. Sipas inventarit kontabël të aktiveve afatgjata materiale gjendja e llogarive: **210 “Toka, Troje, Terrene”** është në vlerën 0 lekë; llogaria **211 “Pyje, Plantacione”** në vlerën 1,793,836 lekë, llogaria **212 “Ndërtesa Konstrukione”** në vlerën 44,101,936 lekë; llogaria **213 “Rrugë, rryte, vepra ujore”** në vlerën 96,980,075 lekë; llogaria **214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në vlerën 5,764,200 lekë. Sa me sipër pasqyrimi i gjendjes kontabël i aktiveve **nuk është i qartë në përcaktimet e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull**, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktivi, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve të secilit aktiv. Në këto inventarë janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.

Nga Dega e Thesarit Korçë nuk është kërkuar regjistri aktiveve për regjistrimin në sistemin informatikë financiar të qeverisë (SIFQ). Pra nuk ka një data bazë me të dhënat aktiv për aktiv vetëm për Bashkinë Pustec, pra duke mos u kryer procesi i informatizimit të tyre, veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pika 2, faqet 37-58. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** Sektori Ekonomike në Bashkinë Pustec të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një **regjistri analitik aktivesh sipas formatit**, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Sipas informacionit të paraqitur nga Bashkia Pustec, konstatohet se lëvizjet e shpeshta ne sektorin e financës midis problemeve te tjera ka ndikuar dhe ne hartimin e regjistrit analitik aktivesh sipas formatit te kërkuar per te cilin gjate vitit 2022 është punuar per krijimin e tij sipas viteve te hyrjes dhe pasqyrimin te konsumit te mjeteve kryesore (asetet).*

**Statusi: Pa zbatuar**

**6. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 26 “*Aktive afatgjata Financiare*”, sipas pasqyrës financiare paraqitet me vlerë zero lekë për periudhën objekt auditimi. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Bashkia Pustec, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 13/09/2021 paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime Pustec SHA me N. “LB” e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre”. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 58,800 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 58,800,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Pustec në “Ujësjetllës Kanalizime Pustec SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2019-2020, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në kundërshtim me Urdhrin e Ministrisë nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo materialë” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.

*(Më hollësisht trajtuar në pika 2, faqet 37-58. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1. Rekomandimi:** Bashkia Pustec, nëpërmjet Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjetllës Kanalizime Pustec Sh.a me vlerë 58,800,000 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Mos ndarja e asetëve ose kalimi i tyre pranë Sh.a Pustec Ujësjetllës kanalizime dhe problemeve të tjera që solli ndarja ose kalimi i tyre si kapital i sha ku ne rastin konkret siç e përmendim dhe llog e investimeve( 202 Studime dhe kërkime )na imponoi saktësimin e vlerës të kapitalit aksioner që do pasqyrohet në llog 26 (Pjesëmarrje në kapitalin e vet) e cila ngelet për tu sistemuar brenda v 2022.*

**Statusi: Pa zbatuar**

**7. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*”, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 2,098,102 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh, për objekte të përfunduara dhe në proces. Nga analiza e kësaj llogarie, **konstatohet se:**

a) Në pasqyrat e pozicionit financiar llogaria 466, kreditorë për mjete në ruajtje paraqitet në vlerën 2,098,102 lekë, ndërsa në mënyrë analitike paraqitet në vlerën 2,043,102 lekë për 19 subjekte, me diferencë më pak në vlerën 55,000 lekë e i korrespondon taksës së pullës në fund të periudhës 2020.

b) Për 19 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, në vlerën 2,043,102 lekë, sipas aneksit nr.11, pika 3, nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për zhblllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së

mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse. Veprimet e mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50. *(Më hollësisht trajtuar në pika 2, faqet 37-58. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Llogaria 466 (Kreditorë për mjete në ruajtje) pasqyron 5% (garanci punimi) për investime të kryera pranë bashkisë ku vlerën me të madhe e përfaqëson investimi Furnizim me ujë Bashkia Pustec i cili është në proces.*

*Per të kryer pagesën e Garancisë për subjektet që investojnë pranë institucionit duhet të paraqitet kërkesa nga ana e tyre dhe procesverbali përfundimtar i marrjes në dorëzim dokumente të cilat kërkohen nga dega e financës për kryerjen e veprimeve të cilat nuk janë sjelle nga ana e subjekteve investitorë .*

**Statusi: Në proces zbatimi**

**8. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Pustec nuk ka krijuar sektorin e Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve dhe për rrjedhojë procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Kjo strukturë duhet të realizonte **marrjen në dorëzim të asetëve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV**, vënien në efikasitet të ndërtesave dhe tokës bujqësore produktive dhe jo produktive me sipërfaqe gjithsej 706 ha, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira. Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistër kontabël, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Bashkia Pustec ka vazhduar punën sipas Urdhrit të Kryetarit të bashkisë nr. 166 datë 31.10.2019 mbi ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e objekteve prioritete të bashkisë sipas listës përfundimtare për transferimin e pronave të paluajtshme në juridiksionin territorial të bashkisë Pustec dhe me Urdhrit nr. 149 prot, datë 27.09.2021 është bërë zëvendësimi i një anëtari të larguar. Deri në momentin e auditimit grupi i punës nuk ka përfunduar punën për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e asetëve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.) dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin **8, të ligjit nr. 8743**, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore”, transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, Udhëzimin nr.3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publike”. *(Më hollësisht trajtuar në pika 2, faqet 37-58. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1. Rekomandimi:** Bashkia Pustec, të marrë masa për krijimin e strukturës së menaxhimit të asetëve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP. Të krijohet

regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Pustec dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të ndërtesave, tokës bujqësore etj, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Nga ana e kryetarit të Bashkisë Pustec, nuk është ngritur si strukturë më vete sektor i menaxhimit të aseteve, por kjo detyrë është ngarkuar dy grupeve.*

***1 Grupi i ngritur me Urdhrit të Kryetarit të bashkisë nr. 166 datë 31.10.2019 mbi ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e objekteve prioritete të bashkisë sipas listës përfundimtare për transferimin e pronave të paluajtshme në juridiksionin territorial të bashkisë Pustec ndryshuar me Urdhrit nr. 149 prot, datë 27.09.2021 (zëvendësimi i një anëtarit të larguar) ndryshuar me Urdhër Nr 147.dt 17.08.2022( per zëvendësim te nje anëtarit ).***

*Ndërsa sektori i finance ( Nje punonjëse është ngarkuar per kontabilizimin e tyre)*

*Grupi i pare ka bërë evidentimin e pronave të paregjistruara në listën e pronave të miratuar mbi baze të VKM-se nr. 103 dt 03.02.2008 “Per miratimin e listës të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Liqenas), të cilat kalojnë me Vendim të Këshillit të Bashkisë), procedurat e transferimit të pasurive sipas listës të inventarit, aplikimet për certifikatat pronësie të pronave që kanë kaluar me VKM Nr 48 dt 26.02.2022.*

*Grupi është në procedure pune për transferimin e të gjitha pronave në pronësi ose përdorim të bashkisë.*

*Është në përpunim procedura për aplikim pranë ASHK, për miratim të listës të 14 pronave emergjente ( kalim në pronësi të bashkisë Pustec )*

*\*\*Prona të kaluara në pronësi të bashkisë me VKM Nr 48 Dt 26.01.2022 ; tre pasuri një në fushën arsimit, një në fushën e shëndetësisë dhe një në fushën e kulturës .*

*1-NR -358/7( ish vatër kulture Gollomboc )Kulture*

*2- Nr 278 (qendra shëndetësore Pustec ) Shëndetësi*

*3- Nr 357/1;(shkolla fillore S,S. Gollomboc ) Arsim*

*\*\*\*Është hapur*

*1-Regjistri i pronave sipas procedurave që ndiqen deri në regjistrim pranë hipotekës i cili azhurohet gjithmonë kur bëhen aplikimet ( e-Albania ) (shtojca 2)*

*2-Regjistri i inventarizimit të pronave të bashkisë . përmbledhëse (shtojca 2/1)*

**Statusi: Në proces zbatimi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Pustec, nuk ka kryer procedurat për inventarizimin e të gjitha aktiveve afat gjata jo materiale dhe materiale të investuara në vite nga Bashkia Pustec dhe ato që me miratim të Këshillit të Ministrave, kanë kaluar në pronësi të kësaj bashkie, konkretisht për llogaritë (me kostot historike):

Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” për vlerën 18,399,892 lekë

Llogaria 211 “Pyje kullota plantacione” për 1,793,836 lekë.

Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione” për 50,082,499 lekë.

Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” për 123,401,363 lekë.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” për vlerën 8,527,462 lekë

Llogaria 215 “Mjete transporti” për 36,425,797 lekë.

Llogaria 218 “Inventar ekonomik” për vlerën 5,241,702 lekë

**-Nuk është përgatitur regjistri i pronave.**

**-Nuk është bërë regjistrimi i aktiveve në pronësi të Bashkisë.**

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 - Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë; Kap. VII, neni 23, pika 14 –Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj , UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. Kap III. *(Më hollësisht trajtuar në pika 2, faqet 37-58. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, regjistrimin e pronave në pronësi të vet të kaluara me VKM-të përkatëse, si dhe për krijimin e regjistrimit të pronave, në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

**Statusi: Pa zbatuar**

**10. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Pustec për periudhën objekt auditimi 01.01.2018 – 31.12.2020, janë realizuar gjithsej **8** procedura me fond limit 39,831 mijë lekë. Grupi i KLSH-së, referuar të dhënave të riskut nga **8** procedura me fond limit 39,831 mijë lekë ka vlerësuar për auditim **3** procedura me fond limit 32,331 mijë lekë ose 81.7 % të fondit të prokuruar. Nga auditimi i 3 procedura me fond limit 32,331 mijë lekë, u konstatua se në **2** procedura mos zbatimit të kërkesave ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, si në hartimin dhe vendosjen e kriterëve dhe në shpalljen fitues të operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë disa nga kriteret e veçanta për kualifikim, të përcaktuara në DT, duke përdorur fonde publike në kundërshtim me kërkesat ligjore, në vlerën **28,497 mijë lekë** ose 71.5 % e fondit limit të audituar respektivisht:

-në procedurën e prokurimit me objekt Sistemim asfaltim rruge fshati Dollna Gorica, me fond limit 5,916,666 lekë të realizuara në vitin 2018.

-në procedurën e prokurimit me objekt Rikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar Pustec, me fond limit 22,581,165 lekë të realizuara në vitin 2019.

Veprimet janë në kundërshtim me ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përkatësisht: neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 24, “Anulimi i një procedure”, neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 47, “S`kualifikimi i ofertuesve”, neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës”, neni 58, “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”, pika 1; VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet: 26, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 5, neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 69, “Njoftimi i fituesit”, neni 70 “Lidhja e kontratës”, neni 78 “Ankesat në autoritetin kontraktor. *(Më hollësisht trajtuar në pika 3, faqet 59-71. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1. Rekomandimi:** Nga ana e Bashkisë Pustec, të merren masa për eliminimin e praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Nga auditimi i procedurave të zhvilluara gjatë vitit 2021, konstatohet se nga bashkia Pustec vijohet me fenomenin e shpalljes fitues të OE me kritere të paplotësuara.*

**Statusi: Pa zbatuar**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Pustec ka lidhur Kontratë Qiraje nr. 29108 datë 09.04.2008, me Subjekti “T. A.” SHA, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor publik në pronësi të ish-Komunës Liqenas (sot Bashkia Pustec) për 300 m<sup>2</sup> për ndërtim të stacionit të antenave, me afat 10 vjeçar (09.04.2008 deri 09.09.2017), me të drejtë rinovimi çdo vit, me vlerë 300,000 lekë/vit, Kontratë Qeraje nr. 28/17, datë 09.04.2017, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor publik për 205 m<sup>2</sup> për ndërtim të stacionit të antenave, me afat 10 vjeçar (09.04.2017 deri 09.04.2026), me të drejtë rinovimi çdo vit, me vlerë 191,500 lekë/vit dhe Kontratë Qeraje nr. 66/08, datë 12.11.2009, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor publik për 150 m<sup>2</sup> për ndërtim të stacionit të antenave, me afat 10 vjeçar (12.11.2009 deri 12.11.2018), me të drejtë rinovimi çdo vit, me vlerë 150,000 lekë/vit, vlerat e kontratës janë llogaritur sipas VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave”, lidhjes 2, pika 6 “Për vendosje antene” .

Nga të dhënat e marrë në zyrën e financës, rezulton se subjekti “A. T.” SHA nuk ka likuiduar për kontratën nr. 1005, datë 15.06.2011, për kontratën nr. 66/08, datë 12.11.2009, detyrimin e viti 2020-2021 për vlerën **300,000 lekë**, detyrim gjithsej i palikujduara në vlerën **300,000 lekë** , është shkelje e disiplinës financiare me **dëm për buxhetin të Bashkisë Pustec**, veprime dhe mosveprime në papajtueshmëri me kushtet e kontratave Kontratës së Qirasë me nr. 29108, datë 09.04.2008, me Subjekti “T. A. ” SHA, nenin 12, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin” si dhe ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil”, neni 801 e vijues, referuar nenit 815, citohet “Qiramarrësi që është në vonesë për të kthyer sendin, detyrohet t’i japë qiradhënësit pagesën e caktuar deri në dorëzim, përveç detyrimit për të shpërblyer dëmin përkatës”. (Më hollësisht trajtuar në pika 1, faqet 33-37. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Pustec të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **300,000 lekë** nga subjekti “T. A.” SHA duke llogaritur edhe penalitetet përkatëse.

### **Nga verifikimi rezulton se:**

*Sipas informacionit të paraqitur nga bashkia Pustec (Sektori i Financës dhe Sektori i të Ardhurave), vlera është paguar sipas faturës datë 12.07.2021, kjo referuar observacionit të paraqitur nga subjekti datë 6.01.2023 shoqëruar me dokumentacion bashkëlidhur.*

**Statusi: Zbatuar**

## **C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Si rezultat i punës së pa mjaftueshme të zyrës së taksave dhe tarifave vendore, në fund të vitit 2020, rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore në **vlerën totale 15,039,140 lekë**, e cila përbëhet nga detyrimet e 10 subjekteve privat në shumën **225,921 lekë** dhe vlera **14,813,219 lekë** detyrime për taksat dhe tarifave vendore nga taksapaguesit familjar.

Sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e debitorëve, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin

e taksave vendore” i ndryshuar, nenet 90 dhe 91, të ligjit nr. 9920, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe pika 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve”. (Më hollësisht trajtuar në pika 1, faqet 33-37. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandim:** Nga Sektori i Financës dhe Sektori i Taksave në Bashkinë Pustec, të merren masa për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore, për 10 subjekte debitorë të biznesit të vogël dhe të biznesit të madh si dhe 1355 debitorë në shumën **15,039,140 lekë**, për taksat dhe tarifatat vendore nga taksapaguesit familjar, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

**a.** Tu dërgohen bankave urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**b.** Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**c.** Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamata vonesa (gjohë në masën 0,06 % kamata vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Në bazë të plan-veprimtimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së me nr. 1743 prot., datë 28.12.2021, Sektori i Tatimit Taksave për të arkëtuar detyrimet tatimore të prapambetura ka marrë masat si më poshtë vijon:*

*1-Janë dërguar njoftime subjekteve për shumën e debisë prej 225 921 leke dhe familjarëve për shumën 14,813,219 leke.*

*2- Janë bërë urdhër bllokime të llogarive bankare për subjektet me urdhër bllokimi nr. 306 prot datë 23.02.2022.*

*3- I është dërguar Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor Korçë kërkesë për vendosjen e barrës së sigurorese për mjetet me nr. 305 prot datë 23.02.2022.*

*Nga shuma e debitorëve në fund të vitit 2020 prej 15,039,140 lekë si rezultat i masave të marra është arkëtuar vlera 1,413,593 lekë, duke mbetur për arkëtim vlera 13,625,547 lekë.*

**Statusi: Në proces zbatimi**

## **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME**

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.Gjetje nga auditimi:** Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konstatohet se nga Bashkia Pustec, nuk ka njohje dhe nuk është zbatuar ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, konkretisht:



- Nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, gjë e cila është reflektuar në mangësinë e plotë të rregullave të shkruara për funksionimin e institucionit.

- Nga ana e titullarit nuk është hartuar një strategji e menaxhimit të riskut për vitin 2021, gjurma e auditimit e cila duhet të përfshinte të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë.

- Konstatohet se: Për vitin 2022 Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkinë Pustec nuk është hartuar plani vjetor i trajnimeve në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

-Mungojnë procesverbalet lidhur me punonjësit të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen dhe transmetimin informacionit dhe bazës së të dhënave të krijuara në institucion, por ndërprerje të saj dhe rrjedhimisht ndikojnë në performancën e institucionit. Punonjësit e rinj të marrë rishtas në punë, përballen me vështirësinë e mungesës së informacionit të duhur, duke mos e njohur si duhet situatën e periudhës së paraardhësve të tyre.

-Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme.

- Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.- Nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit - Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 27-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Nga Kryetari i Bashkisë Pustec, me atributet e Kryetarit të GMS, të merren masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.

Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët të programeve realizimit e objektivave mbi bazë produkti dhe Ndikimi/Efektiviteti. Vendosijen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

## **Menjëherë dhe vijimësi**

**1.2 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Pustec në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa për përmirësimin e rregullores së brendshme në drejtim të dorëzimit të detyrës nga personat e larguar, duke përcaktuar detyrimin që ka punonjësi për dorëzimin e aktiveve që ka në inventar dhe të gjithë punës së kryer, dosjeve shkresore, dokumentacionit elektronik, e gjithçka të krijuar nga punonjësi gjatë qëndrimit të tij

në detyrë, e cila duhet të konsiderohet “pronë e institucionit”. Gjithashtu të përcaktohen edhe detyrimet e strukturave përkatëse të institucionit për këtë qëllim: sektori i shërbimeve, burimeve njerëzore, financës, etj.

**Brenda datës 30.03.2023**

**1.3 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa për hartimin e rregullave për ruajtjen e aktiveve, duke përfshirë edhe ruajtjen dhe sigurinë e informacionit elektronik, për shpeshhtësinë e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, llojet e raporteve që i përgatiten etj. Në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni të hartohet regjistri i riskut, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

**Brenda datës 30.03.2023**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Pustec u konstatua se për vitet 2021” Bashkia Pustec nuk ka Njësi të Auditit të Brendshëm dhe nuk ka lidhur kontratë me institucion tjetër për realizimin e këtij shërbimi në kundërshtim me nenin 49 të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 1 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të brendshëm në sektorin publik”, ku përcaktohet se në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore krijohet Njësia e Auditimit të Brendshëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.1, faqe 27-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Pustec, të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Pustec, Njësine e Auditit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësimit të kësaj strukturë me personel të kualifikuar, të shikohet mundësi e lidhjes së aktmarrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, si Bashkisë Korçë, Maliq ose Devoll.

**Brenda datës 30.03.2023**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Sektori i Financës, Bashkia Pustec deri më datë 31.12.2021, nuk ka likuiduar detyrime për fatura të mbërritura dhe vendime gjykate, që ju ka kaluar afati 60 ditorë për likuidim në 15 raste në vlerën gjithsej 2,339,662 lekë, detyrime që i përkasin llogarive (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe (467) “Kreditorë të ndryshëm”. Veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253,354, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 40, 48 dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat Standard të zbatimit të buxhetit" neni 101, sipas të dhënave të Aneksit nr. 8, bashkëlidhur Raport Auditimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës, për gjendjen e faturave të pa likuiduara, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave për vlerën 2,339,662 lekë, sipas nivelit të realizimit të të ardhurave.

**Brenda datës 30.03.2023**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se për vitin 2021, shpenzimet buxhetore sipas aktrakordimit me thesarin të planifikuara në vlerën 218,317 mijë lekë

janë realizuar në vlerën 188,096 mijë lekë ose në masën 86 %, u konstatua se ka diferenca të dukshme midis planit dhe realizimit të shpenzimeve korrente të cilat nga 25,801 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në fakt në vlerën 12,298 mijë lekë ose 48 %, me mosrealizim në vlerën 13,503 mijë lekë, kryesisht në mos kryerjen e shpenzimeve për disa shërbime të planifikuara. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë, sipas zërave Aneksin nr. 7, bashkëlidhur Raport Auditimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1.Rekomandimi:** Bashkia Pustec të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit.

#### **Menjëherë dhe vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 129,768 lekë. Nga verifikimi i kryer rezultoi që në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk janë përfshirë debitorët për taksat dhe tarifave vendore në vlerën gjithsej në vlerën 17,853,280 lekë (për 11 subjekte në vlerën 261,452 lekë dhe 1336 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë truall dhe tarifa vendore, në vlerën prej 17,591,828 lekë), në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës, të marrë masa për kontabilizimin në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, të debitorëve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën 17,853,280 lekë.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022**

**6. Gjetje nga auditimi:** Në pasqyrat financiare të vitit 2021, konstatohet se llogaria 202 “Studime dhe projekte”, është mbajtur në bilanc si llogari më vete e analizuar për 22 projekte në vlerën 18,399,892 lekë, pavarësisht faktit që 20 prej këtyre projekteve në vlerën 2,865,892 lekë i përkasin investimeve për objekte të përfunduara. Vlera e këtyre projekteve, duhej të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit që i përket, kjo ka sjellë paraqitjen e Aktiveve Afatgjata Materiale më pak për vlerën 2,865,892 lekë për vitin 2021, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Aneksi 1 Pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë kreditimin e saj në debi të Aktiveve Afatgjata Materiale si pjesë e kostos së tyre, në vlerën 2,865,892 lekë.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se për llogarinë 212 “Ndërtesa konstruksione” e analizuar në kontabilitet për 45 objekte (aktive) në vlerën 50,552,353 lekë, nga verifikimi i analitikëve të kësaj llogarie rezulton se për 25 raste, shtesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të aktivitetit por janë trajtuar si aktive më vete. Trajtimi i tyre si aktive më vete ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30, sipas Aneksit nr. 12, bashkëlidhur Raport Auditimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksione”, të vlerave të këtyre objekteve duke shtuar shpenzime për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se për llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” e analizuar në kontabilitet për 44 objekte (aktive) në vlerën 231,600,561 lekë, nga verifikimi i analitikëve të kësaj llogarie rezulton se për 30 raste, shtesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të aktivitetit por janë trajtuar si aktive më vete. Trajtimi i tyre si aktive më vete ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30, sipas Aneksit nr. 12, bashkëlidhur Raport Auditimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, të vlerave të këtyre objekteve duke shtuar shpenzime për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022**

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se gjendja kontabël (kosto historike) për vitin 2021 e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, është e analizuar për 17 objekte inventari në vlerën 8,715,343 lekë. Nga verifikimi i analitikëve të kësaj llogarie rezulton se nuk është zbritur vlera e investimeve të kryera në ujësjellës që duhej të transferohej tek Ujësjellës Kanalizime SHA Pustec, për

objektin në vlerën 1,750,944 lekë (*objekti "Furnizim, vendosje sahat uji" në vlerën 1,709,906 lekë dhe "Mbikëqyrje punimesh për vendosje sahat uji" në vlerën 41,038 lekë*), me ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme", Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1 .Rekomandimi:** Sektori i Financë të kryej transferimin e asetëve që i përkasin Ujësullës Kanalizime SHA Pustec me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët dhe të kryhen veprimet kontabël duke zbritur nga llogaria 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" vlerën për investimet e kryera në shumën 1,750,944 lekë.

**Brenda datës 30.03.2023**

**10.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se gjendja e llogarisë 4342 "*Të tjera operacione me shtetin (të drejta)*" e aktivitetit të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,980,524 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar të cilat janë raportuar për vlerën 6,124,305 lekë dhe nuk kuadron me këto llogari për vlerën 1,143,781 lekë, veprim në kundërshtim me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme", Kreu III. "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 32. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarive të Klasës së 4 të Pasivit të bilancit për diferencën në vlerën 1,143,781 lekë.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022**

**11.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se nga 90 objekte inventari të analizuar në kontabilitet të pasurive të paluajtshme me kosto historike që i përkasin llogarisë 211 "*Pyje plantacione*", 212 "*Ndërtesa e konstruksione*" dhe llogarinë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*", në vlerën 283,946,750 lekë, Bashkia Pustec nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu VI "Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme", pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Drejtoria Korçë dhe nëpërmjet Sektorit të Financës të përllogaritë

kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

**Brenda datës 30.03.2023**

**12.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2021, rezulton se llogaria 231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*” në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se, për vitin 2021 ka kontratë që nuk ka përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilën është kryer pagesë, për vlerën 108,199,198 lekë, që i përket llogarisë 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*” për kontratën me objekt “*Furnizim me ujë Bashkia Pustec*” me vlerë 547,692,661 lekë me afat shlyerje deri në vitin 2024. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0, kur ka investime në proces, pra vlera e kësaj llogarie duhej pasqyruar në vlerën 108,199,198 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Klasa 23. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**12.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës në Bashkinë Pustec, në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*”, deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

**Menjëherë dhe vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2021, rezulton se llogaria 466 “*Kreditorë për mjetet në ruajtje*” në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 6,328,772 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesari, kjo llogari për vitin 2021 është kredituar për 1 objekt për vlerën 5,409,960 lekë dhe është debituar në 1 rast për vlerën 1,124,245 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde për vlerën 918,857 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e para, të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Pustec nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për ç’bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për interes publik. Veprime në kundërshtim me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 34-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës në Bashkinë Pustec, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e më parë (vlera 918,857 lekë), për të cilat ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Korçë, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

## Menjëherë dhe vijimësi

**14. Gjete nga auditimi:** Në auditimin e procedurave me vlerë të vogël, nga Bashkia Pustec janë realizuar gjithsej 13 procedura me fond limit 3,071 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 2,574 mijë lekë me një diferencë nga fondi për vlerën 497 mijë lekë.

Në totalin e procedurave, rezulton se 5 procedura me fond limit 2,460 mijë lekë ose 84% e fondit janë zhvilluar me mjete elektronike, ndërsa 5 procedura nuk janë zhvilluar me mjete elektronike, pasi janë nën vlerën 100 mijë lekë.

Me shkresën nr. 1316, datë 14.10.2021 është kërkuar zhvillimi i procedurës me objekt “*Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi të ndryshme*”, miratuar me vendim nr. 73, datë 24.12.2020.

Me PV nr. 1316/9 datë 09.11.2021, KBVV ka shpallur fitues shoqërinë “S.A.” shpk me ofertë 599,600 lekë, i renditur i dyti në garë, pasi OE i renditur i pari nuk është paraqitur për lidhje kontrate.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE fitues, rezulton se ky OE nuk plotëson kriterin mbi pagesën e energjisë elektrike, pasi sipas të dhënave të dosjes dhe sistemit SPE, pasi procedura është zhvilluar me datë 05.11.2021, ndërsa subjekti ka paraqitur vërtetim mbi pagesën e energjisë nr. 323, datë 7.10.2021 në të cilën thuhet se subjekti nuk ka detyrimi, **por pa përfshirë faturën e muajt shtator 2021**. Pra vërtetimi duhet të përfshinë dhe muajt shtator.

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me neni 76 pika 1 shkronja (b) dhe neni 56 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, Udhëzimi i APP nr. nr. 3, datë 08.01.2018 Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlera të vogla dhe zhvillimi me mjete elektronike”, pika 2 dhe me Udhëzimi e MF nr.57 datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec, të analizojë mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH në procedurën me objekt “*Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi të ndryshme*”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për vlerësim jo të drejtë të procedurës, si dhe të marrë masa që në të ardhmen të analizojë raportet e komisionit të vlerësimit të OE fitues që të jenë në përputhje me kuadrin ligjorë dhe në plotësim të kriterëve të DST të miratuara nga AK.

**Brenda datës 30.03.2023**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës me objekt “*Furnizimi me ujë Bashkia Pustec*”, mbi zbatimin e dispozitave në emërimin e anëtarëve të Njësisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHD) dhe Komisioni të Vlerësimit të Ofertave (KVO), rezulton se:

Nga ana e titullarit të AK Bashkia Pustec, janë hartuar dy urdhra prokurimi me të njëjtin numër protokolli (nr. 14, datë 30.12.2020), por me shkresa dhe përmbajtje të ndryshme për ngritjen e NJHDT, si vijon:

Me urdhër prokurimi me shkresën nr. 1579/1, datë 30.12.2020, ku si anëtare e NJHDT është emëruar: znj. F.S. me detyrë përgjegjëse procedurës, specialiste e jashtme sipas aktmarrëveshje datë 30.12.2020 me profil juridik, z. L.M. me detyrë Jurist bashkia Pustec dhe V.A. me detyrë inxhinier Bashkia Pustec.

Me urdhri i prokurimi me shkresën nr. 1579/2, datë 30.12.2020 është bërë ndryshimi i anëtarëve të NJHDT, respektivisht: znj. F.S. me detyrë përgjegjëse procedurës (*specialiste e jashtme sipas aktmarrëveshje datë 30.12.2020 dhe profil juridik*), znj. S.M me detyrë Specialiste e Burimeve Njerëzore e cila ka zëvendësuar z. L.M. **pa asnjë argument shtesë**, z. V.A. me detyrë inxhinier Bashkia Pustec, si dhe është shtuar zj. L.C. me profesion inxhinier Gjeodet (*specialiste e jashtme sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020 të lidhur midis Bashkisë Pustec*) dhe zj. H.G. me profesion inxhinier Mjedisi me profil trajtim të ujërave (*specialiste e jashtme sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020 të lidhur midis bashkisë Pustec*).

Nga AK Bashkia Pustec nuk është argumentuar emërimi i një specialisti të jashtëm në pozicioni e përgjegjësit të kësaj procedurë dhe me profil jurist, pasi vetë bashkia ka në strukturë jurist me funksion përgjegjës për Sektorin e Prokurimeve, si dhe zëvendësimi i specialistit z. L.M. me zj. S.M., pa asnjë agrumet ligjorë për zëvendësimin e tij.

Gjithashtu, konstatohet se në sistemin e SPE të APP nga katër anëtarë që ka NJHDT sipas urdhër prokurimit, rezulton se janë tre anëtarë (F.S., L.M. dhe V.A.), si dhe nuk janë bërë ndryshimet si të anëtarit të ndryshuar po ashtu dhe të shtesa me anëtarë të rinjë.

Me urdhër nr. 1579/3, datë 30.12.2020 janë emëruar anëtarët e KVO, *respektivisht: z. J.N. me detyrë Zv/Kryetar (jurist), z. V.S. me detyrë specialist prokurimesh (ekonomist), z. I.M. me detyrë ish- ekonomist Sektori Financës, zj. N.K. specialiste e jashtme me arsim të lartë (shkenca politike, sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020)* dhe z. E.B. specialist i jashtëm me profil ing. Elektrik (*sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020*).

Nga auditimi rezulton se specialistët e jashtëm nuk janë emëruar punonjës të profilit dhe të nevojshëm për llojin e procedurës që zhvillohet, pasi njëri është më profil ing., Elektrik dhe tjetri shkenca politike, ndërkohë që duheshin minimumi ing, ndërtimi dhe hidroteknik, kjo referuar tipologjisë së procedurës së zhvilluar, rëndësisë dhe vlerës së prokuruar.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pika 3.3 të Udhëzimit nr. 7, datë 30.7.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, si dhe nenet 56-Titullari i AK ose zyrtari i autorizuar dhe 57- Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**15.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec, në cilësinë e titullarit të AK të marrë masa që në të ardhmen në mungesë të personelit të kualifikuar të argumentojë marrjen në komision si anëtarë të NJHDT/KVO të specialistëve të jashtëm me profil sipas tipologjisë së procedurës që zhvillohet dhe jo të çfarëdolloj.

Gjithashtu në rastet e largimit të anëtarëve të komisionet e NJP/KVO të argumentohet arsyetja dhe të kryhet sipas afateve ligjore pa filluar procedura e aplikimit të kritereve ose vlerësimit të dokumentacionit të OE pjesëmarrës.

**Në vijimësi**

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës me objekt “*Furnizimi me ujë Bashkia Pustec*”, konstatohet se lidhja dhe zbatimi i kontratës është bërë pa marrë miratim nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, pasi zona e Bashkisë Pustec në të cilën do shtrihet investimi hyn në zonat e



mbrojtura si PK “Prespë”, shpallur me VKM nr. 80, datë 18.2.199, kategori e II e zonave të mbrojtura, sipas IUCN-së, si dhe pa miratim të lejes së ndërtimit të lëshuar nga Sektori i Planifikim Territorit dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Pustec, duke u mjaftuar vetëm me lejen e zhvillimit nr. 5, datë 26.5.2021.

Veprimet e mësipërm janë në kundërshtim me nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe neneve 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, ligjin nr. 81/2017, datë 4.5.2017 “Për zonat e mbrojtura” i ndryshuar, ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar (shtojca I dhe II), ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” i ndryshuar dhe VKM nr. 550, datë 15.7.2020 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin në parim për dhënie me koncesion të përdorimit të burimit ujorë, e lejes/autorizimit për përdorimin e burimit ujor, veprimtari ndërtimore në brigjet, veprimtari në shtratin e burimit ujorë, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura të ndotura të dokumenteve shoqërues të procedurës së shqyrtimit të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**16.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec të mos lidhë kontrata me subjektet sipërmarrëse dhe fituese të procedurave të prokurimit për investime pa marrë më parë lejen e ndërtimit të infrastrukturës nga Sektori i Planifikim Zhvillim Territorit, si dhe pa u pajisur me Nipt sekondarë.

Gjithashtu duke qenë se Bashkia Pustec bën pjesë në zonat e mbrojtura, përpara hapjes së ndonjë procedure prokurimi në investime e cilat prekin zonat e mbrojtura të merret paraprakisht miratimi nga instancat përkatëse për zhvillimin ose jo të zonës ku do shtrihet projekti.

**Në vijimësi**

**17. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurës me objekt “Furnizimi me ujë i Bashkisë Pustec”, rezulton se disa nga kriteret nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, konkretisht:

Në pikën 2.4 të DST janë kërkuar kategori licencash jo të argumentuara me procedurën e zhvilluar dhe zërat e preventivit, konkretisht: NP 1 – D (punime gërmimi në tokë); NP 4 - E; (Rrugë autostrada, ura, mbikalime...); NS 9-D; (Punime strukturore speciale); NS 18 D; (Punime topogjeodezike); NS - 19 D;(sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë) dhe N.S 20 D; (Shpime gjeologo – inxhinierike, puse shpimi për ujë sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI).

Nuk argumentohet kërkesa ku sipas pikës 2.5 të DST është kërkuar licencës me kod III.2.B;I.2.A;III.2.A (1+2), pasi në referim të pikës (a) të nenit 1 të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin në mjedis”, ku qëllimi është të sigurojë nivel të lartë të ndikimit në mjedis.

Në pikën 2.8 të DST është kërkuar stafi teknik; Inxhinier Ndërtimi 2 (dy); Inxhinier Ndërtimi 1 (një) (profili transport); Inxhinier Ndërtimi 1 (një) (profili Strukturist); Inxhinier Mjedisi 1 (një)..

Në pikën 1.9 të DST është kërkuar që OE duhet te ketë ne stafin e tij te punësuar (staf mbështetës) poshtë 1 inxhinier topograf.

Në pikën 2.12 të DST, është kërkuar ekspert zjarrfikës te certifikuar (1 person) ne fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpëtimin, dëshmuar me kontratën e punës dhe

certifikata përkatëse. Aplikimi i kriterëve jo në përputhje me tipologjinë e procedurës kanë çuar në uljen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë (gjithsej 2 OE), duke ulur konkurrencën dhe krijimin e kushteve për një përdorim jo me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, duke përfituar kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me **nenin 46**, të LPP, “kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”, si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 5 përcaktohet: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**17.1. Rekomandimi:** Bashkia Pustec (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të parashikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, bazuar në kriterë të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

## Në vijimësi

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Pustec, mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm paraqitur me shkresën nr. 870/9,prot, datë 23.12.2021, rezulton se:

Bashkia Pustec për zbatimin e rekomandimeve të KLSH **nuk ka** kthyer përgjigje, **brenda afatit 20 ditore**, si dhe nuk ka raportuar në KLSH **brenda 6 muajve** për masat e marra në zbatimin e rekomandimeve.

Bashkia Pustec ka hartuar “Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve” me shkresën nr. 90, datë 18.01.2022, në të cilën janë përcaktuar strukturat dhe personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete, **por nuk ka raportuar në këshillin e njësisë bashkiake.**

Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmblendhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

**a.** Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar **10 masa organizative**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat është zbatuar 1 (një) masë, në proces zbatimi 2 masa dhe pa zbatuar akoma 7 masa.

**b.** Për masa shpërblim dëmi, është rekomanduar 1 (një) masë me vlerë 300,000 lekë, e cila është pranuar dhe zbatuar.

**c.** Për masa mungesë të ardhurash është rekomanduar 1 (një) masë me vlerë 15,039 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi, ku nga

*vlera e rekomanduar prej 15,039 mijë lekë është arkëtuar vlera 1,414 mijë lekë, duke mbetur për arkëtim vlera 13,625 mijë lekë.*

**d. Për masa disiplinore, janë rekomanduar gjithsej 7 masa të cilat janë pranuar dhe zbatuar nga subjekti.**

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 15 dhe 30 të Ligji nr. 154/2021, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, si dhe neni 50-Auditimi i jashtëm, të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 77-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**18.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa për përshpejtimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve në proces zbatimi, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 870/9, prot, datë 23.12.2021 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Pustec”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre.

**Brenda datës 31.03.2023**

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021, me objekt “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, Bashkia Pustec, rezulton se situacionet pjesore nuk janë shoqëruar me librezat e masave, në kundërshtim me UKM Nr .2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, “Dokumentacioni teknik i punimeve të ndërtimit”, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 65-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**19.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Pustec të merren masa, duke ngritur grupe pune me përbërje inxhinierë të fushës, që para likuidimit të situacioneve pjesore dhe përfundimtare, të bëhet kontrolli sipas librezave të masave të paraqitur nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve, të cilat duhet të shoqërojnë situacionet përkatëse në çdo fazë punimesh.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i analizave të reja të çmimeve dhe të faturave të blerjes së tubave nga shoqëria T. ShPK (e cila ka deklaruar që tubat janë brenda specifikimeve teknike), të dërguara nëpërmjet emailit nga mbikëqyrësi i punimeve, rezulton se zëri “material” në analizën e çmimeve për zërin e punës “FV tuba PE100RC me Dj 90 mm Pn16”, është marrë 2551 lekë/ml nga 519.3 lekë që është çmimi i shitjes nga shoqëria T. ShPK, ose 2031 lekë/ml më pak se çmimi i vendosur në analizë. Nga rillogaritja, çmimi i këtij zëri pune duhet të ishte 805 lekë/ml (519.3 + vlerat e elementëve të tjerë të kostos + shpenzimet plotësuese dhe fitimin), ose 2115 lekë më pak se çmimi i situacionuar (2920 – 805). Nisur nga fakti që ky tubacion është përdorur në linjat e dërgimit në sasinë 4161 ml, vlera e rritur padrejtësisht është 8,800,515 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UKM Nr .2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, “Zbatimi i punimeve të ndërtimit”, pika 8.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 65-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**20.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Pustec të merren masa, që për zërin e ri të punës “FV tubacion PE100RC me Dj 110 mm Pn16”, për të cilin nuk administrohen faturat në lidhje me çmimet e blerjes, Komisioni i Marrjes në Dorëzim të objektit, në

bashkëpunim me mbikëqyrësin, të hartojnë analizën korrekte të çmimit, referuar faturave të blerjes dhe analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI.**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, **Titullari i Njësisë Publike** në bashkëpunim me **Nëpunësin Zbatues**, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **6,450,180 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “**Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec**”, fituar nga BOE G.SH., rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt, por të likujduara, në vlerën 847,620 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pika I.17, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 8.2 dhe 8.3, si dhe kushtet e kontratës së sipërmarrjes së punimeve nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pustec dhe BOE G. & SH. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 65-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Pustec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **847,620 lekë pa TVSh** nga BOE G.SH., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021, me objekt “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera, për arkëtimin e vlerës prej **847,620 lekë pa TVSh** nga BOE G.SH., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021, me objekt “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i dokumentacionit të objektit “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, Bashkia Pustec, rezultoi se në situacionin e fundit pjesor, zëri i punimeve “Mbushje me zhavorr në rrugë” me vlerë të situacionuar 5,602,560 lekë, është librezuar si volum i kryer si shtresë për mbushjen e kanaleve pas shtrimit të tubacioneve, me sipërfaqe mesatare të shtresës 0.36-0.42 m<sup>2</sup>. Në fakt, nga verifikimi me zgjedhje në terren, ky zë pune, i cili sipas observacionit pretendohet të jetë kryer në shtresa rrugore, nuk është realizuar në mbushjen e kanaleve, pasi mbushja e kanalit është bërë me materialin e gërmuar. Në dosjen teknike nuk administrohet librezja e punimeve që të vërtetojë punimin e kryer sipas faktit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Pustec të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të vlerësojnë e të analizojnë zërin e punimeve “Mbushje me zhavorr në rrugë”, i cili nuk është i situacionuar sipas librezës së masave në vlerën **5,602,560 lekë** nga sipërmarrësi i punimeve, për të përcaktuar volumet sipas punimeve të kryera në fakt, duke bërë rakordimin në situacionin përfundimtar dhe në rast difference në volume, të merren masa për arkëtimin e kësaj vlere nga BOE G.SH., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021, me objekt “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”.

**Menjëherë**

### **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pustec, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë 11 subjekte në vlerën 261,452 lekë dhe 1336 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 17,591,828 lekë edhe pse vazhdojnë procedurat mbledhjes me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 11 subjekte debitorë në vlerën 261,452 lekë, janë aktiv 2 subjekte ose 18 % e totalit të cilët nuk paguajnë detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore.

-Nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtitimit të debitorëve, në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 32-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Pustec, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të periudhës në vlerën **17,853,280 lekë**.

**Brenda datës 31.03.2023**

**2. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër nr. 22, datë 19.2.2021, Kryetari i Bashkisë Pustec ka urdhëruar përcaktimin e limitit të karburantit për mjetet e bashkisë për vitin 2021, ku sasia vjetore e parashikuar është 26396 litra/viti.

Me PV nr. 235/4, datë 01.3.2021 NJP ka bërë përllogaritjen e fontit limit referuar çmimit të kontratave të mëparshme (nr. 349, datë 23.11.2020), me çmim 104.797 lekë/litri, duke përcaktuar fondin limit në vlerën 2,766,221 lekë pa TVSh (104.797 lekë/litri \* 26396 litra).

Nga krahasimi i të dhënave me regjistrin e mjeteve sipas pasqyrave të bilancit si dhe informacionit të marrë nga specialistja e mjedisit znj. A.J., rezulton se në bashki nuk ka mjet kompaktor për transport mbetjesh në venddepozitimit sanitar në Maliq për të cilën është planifikuar një sasi vjetore karburanti prej 2500 litra/viti.

Në këto kushte kjo sasi karburanti është planifikuar padrejtësisht për vlerën 261,750 lekë/viti, veprime me mos efektivitet të fondeve publike, për të cilën bashkia nuk duhet të beje lëvrimin e tyre sipas kontratës fillestare.

Gjithashtu, vlera e karburantit e përlogaritur dhe programuar për tu prokuruar nuk është e argumentuar me analizë të hollësishme referuar sasisë së karburantit gazoil/benzinë , gjendje në magazinë, me analizë mbi numrin e mjeteve apo agregateve (*motogjenerator, kaldaja, etj.*) në qarkullim e gjendje pune inventar i bashkisë Pustec, apo gjendje inventar në njësitë shpenzuese vartësi e bashkisë, mbi sasinë e kilometrave të përshkruara nga mjetet në qarkullim dhe orë/pune të kryera nga agregatet për periudhën raportuese paraardhës, mbi normativën e konsumit litra/100 km për mjetet dhe orë/pune për agregatet e miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë, mbi gjendjen teknike të çdo tip mjeti e agregati, mbi viti prodhimit të mjetit e agregatit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “*Objekti dhe qëllimi*” pika 2, gerrat (a); (b) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe janë në mospërputhje me dispozitën e parashikuar nga VKM nr. 914, datë 27.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu II “Rregullat e Përgjithshme të prokurimit” neni 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa për ngritjen e një strukturë të veçantë për planifikimin vjetor të nevojave për karburant, bazuar në numrin e mjeteve, gjendjet teknike të tyre, normativave të harxhimit sipas katalogut ose me procesverbal argumentimi, volumit të punës që kryhen në vitin paraardhës, sasi e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak.

## **Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën me objekt “*Furnizimi me ujë i Bashkisë Pustec*” me fond limit 456,525,537 lekë dhe ku fitues është shpallur bashkimi i OE G.C. shpk & “SH.” shpk me vlerë oferte 456,410,511 lekë ose 0.025% e fondit limit, rezulton se:

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, bashkimi OE G. & SH., i shpallur fitues nga KVO nuk plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK. Në kushtet kur në garë nuk ka OE të tjerë, KVO duhet t'i propozonte titullarit të AK anulimin e procedurës, analizimin e shkaqeve dhe marrjen në analizë për ndryshimin e kushteve të procedurës (kriteret) me qëllim rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë, duke rritur konkurrencën për një përdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondit të prokuruar prej 456,525 mijë lekë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 2, “*Parimet e përzgjedhjeve*”, neni 28, “*Anulimi i një procedure*”, neni 76, “*S`kualifikimi i ofertuesve*”, neni 92, “*Shqyrtimi i ofertave*”, neni 97, “*Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës*”, pika 1, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, pika 5, Neni 66, “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, neni 67, “*Klasifikimi i ofertave*”, neni 69, “*Njoftimi i fituesit*”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pustec në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertës ekonomike e cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondit të prokuruar.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

#### **D. MASA DISIPLINORE.**

##### **D/1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:**

Mbështetur në nenin 15 “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, nenin 58 “*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Pustec**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse.

#### **E. MASA ADMINISTRATIVE.**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar në pikën 2.4 faqe 50-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe mbështetur në nenin 15 shkronja (c, ç) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Pustec** që në zbatim të nenit 132, të ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, **t’i kërkojë Agjencisë së Prokurimit Publik (APP)**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave **administrative ose disiplinore** në raport me shkeljet e konstatuara, për **10 (dhjetë)** punonjësve/ dhe ish-punonjësve, si më poshtë:

1. **Zj. F.S.**, në cilësinë e Përgjegjës të Procedurës, specialiste e jashtëm sipas aktmarrëveshje datë 30.12.2020, me profil Jurist.
2. **Z. V.A.**, me detyrë me detyrë inxhinier Bashkia Pustec.
3. **Zj. S.M.**, me detyrë Specialiste në Sektorin e Burimeve Njerëzore.
4. **Zj. L.C.**, me profesion inxhinier Gjeodet, specialiste e jashtme sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020 të lidhur midis Bashkisë Pustec.
5. **Zj. H.G.**, me profesion inxhinier Mjedisi me profil trajtim të ujërave, specialiste e jashtme sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020 të lidhur midis bashkisë Pustec.

##### **Për shkeljet e mëposhtme:**

Në cilësinë e anëtarit të NJHDT, në aplikimin e kriterëve jo të mirë argumentuara në procedurën me objekt “*Furnizimi me ujë i Bashkisë Pustec*” me fond limit 456,525,537 lekë, në shkelje të nenit 77, ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, si dhe neni 39 dhe 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” dhe jo në përshtatje me objektin e

procedurës së prokurimit, duke çuar në mospjesëmarrjen e OE apo në skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme.

6. **Z. J.N.**, me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë Pustec.
7. **Z. V.S.**, me detyrë Specialist në Sektorin e Procedurave.
8. **Zj. N.K.**, specialiste e jashtme me arsim të lartë “shkenca politike”, sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020.
9. **Zj. E.B.**, specialist i jashtëm me profil ing. Elektrik, sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020.
10. **Z. I.M.** me detyrë ish- specialist Sektori i Financës.

**Për shkeljet e mëposhtme:**

Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën me objekt “*Furnizimi me ujë i Bashkisë Pustec*” me fond limit 456,525,537 lekë, ku bashkimi i OE “*G.*” *shpk* & “*SH.*” *shpk*, i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST nga AK NSHP Baskia Korçë, veprime në kundërshtim me nenin 82 të ligjit 162/2020 “Për procedurat e prokurimit” dhe nenit 26- *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit të VKM nr. 285, datë 19.5.2021* “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**F. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL.**

Për punonjësit për të cilët do merret masë disiplinore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.
2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

**Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.**

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**